REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1128/ 4 prot. Datë 25/06/2026

V E N D I M
Nr. 866/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25/06/2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Idealdevs Corporation*" SHPK, për procedurën e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*KREATX*" SHPK, për procedurën e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa

TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*DATA LOG*" SHPK, për procedurën e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Ankimues:

Operatori ekonomik "*Idealdevs Corporation*" SHPK me NIPT: M38106801F dhe me adresë: *BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1, Malalkastër*.

Operatori ekonomik "*Smart ICT Services*" SHPK me NIPT: L71324056C dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr.7, Rruga "Komuna e Parisit", Ndërtesa 1, Shkalla 5 Kati 4, nr. 26, Kodi postar 1001, Tiranë.*

	Operatori ekonomik "*KREATX*" SHPK me NIPT: L12121023B, dhe me adresë: *Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Sami Frashëri", Nr.39, Kati i dytë, Tiranë.* Operatori ekonomik "*DATA LOG*" SHPK me NIPT: L32402003S dhe me adresë: *Njësia Bashkiake nr. 5 Rruga "Dëshmorët e Kombit", Kulla 2, Kati 4, Tiranë.*
Autoriteti Kontraktor:	Bashkia Himarë *Adresa: Rr. "25 Marsi", nr.2; Spile, Himarë.*
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë ankimuar në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm

I.5. Operatori ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Operatori ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.7. Operatori ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.8. Operatori ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2. Në datën 10.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026 e operatorit ekonomik "***Idealdevs Corporation***" SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në shkresën nr. 1329/26 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1128/1 prot, datë 19.05.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik ndër të tjera, shkresën nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*", ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

"...***Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 1***

(Kriteri 2.3.2 — numri i punonjësve dhe listëpagesat)

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.2 të Dokumenteve të Tenderit, ***për disponimin e minimalisht 10 (dhjetë) punonjësve për tre muajt e fundit****, e vërtetuar me dokumentacionin përkatës, është e panevojshme, joproporcionale dhe kufizuese për konkurrencën, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim është i pabazuar.*
Autoriteti Kontraktor thekson se ***kriteri në fjalë është vendosur në përputhje të plotë rne nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik",*** *i cili parashikon shprehimisht të drejtën e autoritetit kontraktor për të kërkuar prova mbi kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, përfshirë burimet njerëzore, në funksion të garantimit të realizimit të kontratës.*

Në mënyrë konkrete, kërkesa për një numër minimal prej 10 (dhjetë) punonjësish nuk lidhet me numrin e specialistëve teknikë që do të angazhohen drejtpërdrejt në realizimin e kontratës, por me ekzistencën e një strukture organizative minimale të qëndrueshme të operatorit ekonomik, e cila garanton funksionimin normal, kapacitetet bazë dhe seriozitetin e subjektit në treg*.*

Autoriteti Kontraktor sqaron se:
a) ky numër përfaqëson strukturën organizative të përgjithshme të operatorit ekonomik dhe nuk përbëhet ekskluzivisht nga specialistë IT;

b) një pjesë e këtij stafi mund të jetë staf teknik, ndërsa pjesa etër përfshin funksione mbështetëse si administrim, fmancë, menaxhim, etj.;
c) stafi teknik i specializuar për realizimin e kontratës mund të sigurohet edhe në mënyrë të ligjshme përmes kontratave të punës, pa qenë i detyrueshëm të përfshihet tërësisht në këtë strukturë,

Për rrjedhojë, kriteri nuk kufizon fleksibilitetin e operatorëve ekonomikë në organizimin e burimeve njerëzore, por vendos një prag minimal të arsyeshëm organizativ, i cili synon të shmangë pjesëmarrjen e subjekteve pa kapacitete reale funksionale.
Sa i përket kërkesës për provimin e këtij kriteri përmes listëpagesave për një periudhë 3-mujore, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo kërkesë nuk është e tepruar, por përbën një mjet të arsyeshëm verifikimi për të provuar që struktura organizative e deklaruar është e qëndrueshme dhe jo e krijuar në mënyrë formale vetëm për efekt pjesëmarrjeje në procedurë,

Ndryshueshmëria e stafit, e përmendur nga operatori ekonomik, nuk përjashton të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar prova mbi një periudhë minimale kohore, në mënyrë që të sigurohet që operatori ekonomik disponon kapacitete reale dhe të vazhdueshme.

Në këtë kuptim:
a) kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës;
b) është proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e saj;
c) nuk përbën pengesë artificiale për konkurrencën në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 162/2020.

Sa i përket referimeve të bëra nga operatori ekonomik ndaj praktikës së Komisionit të Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktor thekson se çdo vendim vlerësohet në raport me rrethanat konkrete të procedurës përkatëse dhe nuk mund të zbatohet automatikisht në pdo rast.
Në procedurën objekt shqyrtimi, duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, kompleksitetin e saj dhe nevojën për një strukturë të qëndrueshme organizative, Autoriteit Kontraktor vlerëson se kriteri është i justifikuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfundim
Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa nr. 1 nuk qëndron dhe rrëzohet në tërësi, duke mos u bërë asnjë ndryshim në kriterin 2.3.2 të Dokumenteve të Tenderit.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 2

(Kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4 — stafi teknik dhe ekspenenca profesionale)

Në lidhje me pretendimet e operatoril ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilave kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, lidhur me kërkesat për stafin teknik dhe vitet minimale të eksperiencës profesionale, janë të ekzagjeruara, joproporcionale dhe në tejkalim të natyrës së kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa qëndron pjesërisht.
Autoriteti Kontraktor, duke marrë në konsideratë nenin 2 dhe nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe parimin e proporcionalitetit në përcaktimin e kritereve të kualifikimit, vlerëson se kërkesat për stalin teknik duhet të jenë të lidhura ngushtësisht me objektin the kompleksitetin e kontratës, duke g antuar njëkohësisht pjesëme sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë.
Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor qmon se kërkesa për disponimin e stafit teknik të specializuar mbetet e nevojshme dhe e justifikuar, duke qenë se objekti i kontratës përfshin një zgjidhje të integruar informatike, e cila kërkon implementim, konfigurim, integrim me sisteme të tjera, si dhe mirëmbajtje dhe suport teknik gjatë zbatimit të saj.

Megjithatë, në lidhje me përcaktimin e niveleve të eksperiencës profesionale për secilin profil, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesat e vendosura fillimisht janë më të larta se sa është e nevojshme për garantimin e realizimit të kontratës dhe, në disa raste, krijojnë mbivendosje me kërkesat për certifikime profesionale.

Në këto kushte, dhe në reflektim të praktikës së Komisionit të Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktor vlerëson të rishikojë këto kërkesa, me qëllim shmangien e kufizimeve të panevojshme dhe rritjen e konkurrencës në procedurë.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor vendos të riformulojë pjesërisht kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4, si më poshtë:

- *Zhvillues softëare: minimumi 2 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale;*
- *Menaxher projekti IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist databazash: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë*
- *profesionale;*
- *Specialist infrastrukture IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist databazash enterprise/cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist platformash cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale;*
- *Analist bimesi/funksional: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale;*

- *Specialist testimi: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale;*

Sa i përket pretendimit se kontrata është e natyrës "mallrash", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky klasifikim nuk përjashton nevojën për kapacitete të avancuara teknike, duke qenë se objekti i kontratës përfshin elementë të rëndësishëm të implementimit dhe zhvillimit të një sistemi funksional.

Përfundim
Per sa me siper, ankesa ne. 2 pranohet pjesërisht dhe Dokumentat e Tenderit do të modifikohen sipas sa me siper, ndersa pjesa tjeter e pretendimeve rrezohetl si e pabazuar.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 3
(Kriteri 2.3.6 — përvoja e operatorit ekonomik)
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, që kërkon një përvojë minimale prej 5 (pesë) vitesh në fushën e teknologjisë së informacionit, është kufizues dhe joproporcional, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

Autoriteti Kontraktor thekson se kriteri në fjalë është vendosur në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i cili parashikon të drejlën e autoritetit kontraktor për të kërkuar nga operatorët ekonomikë një nivel të mjaftueshëm përvoje profesionale, të vërtetuar përmes veprimtarisë së tyre në treg.

Në këtë kuptim, kërkesa për një përvojë minimale prej 5 vitesh nuk përbën një kufizim të pajustifikuar, por synon të garantojë që operatori ekonomik pjesëmarrës disponon një nivel minimal stabiliteti, vazhdimësie dhe përvoje në treg, të nevojshme për realizimin e kontiatës.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se:
1- Ky kriter nuk përjashton operatorët ekonomikë në mënyrë arbitrare,nuk kërko n)ë të jashtëzakonshme apo të tepruar, përbën një standard minimal të arsyeshëm nj% kontratë me kompleksitet teknik.Sa i përket pretendimit se përvoja duhet të v&eto
vettirn permes kontratave te ngjashme, Autoriteti Kontraktor sqaron se ky element õs te trajtuar në mënyrë të ve$antë në kriteret e tjera të kualifikimit, ndërsa kriteri 2.3.6 synGÏl' të vlerësojë ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e aktivitetit të operatorit ekonomik në treg.
Në këtë kuptim, kërkesa për paraqitjen e ekstraktit historik të regjistrit tregtar dhe profilit të operatorit ekonomik përbën një mënyrë të ligjshme dhe proporcionale për verifikimin e këtij kriteri.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 4
(Kriteri 2.3.7 - demonstrimi "live" i sistemit)
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.7 të Dokumenteve Standarde te Tenderit, që parashikon zhvillimin e një demonstrimi "live" të sistemit të ofruar mbi një platformë ekzistuese dhe funksionale, është kufizues dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe rrëzohet në tërësi.
Autoriteti Kontraktor sqaron se parashikimi i këtij kriteri nuk përbën një kriter të ri kualifikimi, por një metodologji verifikimi objektiv gjatë fazës së vlerësimit teknik, e cila synon të konstatojë përputhshmërinë reale të zgjidhjes së ofruar me kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Në këtë kuadër, Autorteti Kontraktor është mbështetur në dispozitat e mëposhtme ligjore:

1. *Neni 1 i ligjit nr. 162/2020, i cili përcakton si qëllim kryesor të prokurimit publik përdorimin efikas të fondeve publike dhe maksimizimin e vlerës së përfituar. Në rastin konkret, kontraktimi i një sistemi financiar pa një verifikim praktik do të krijonte rrezik real për përzgiedhjen e një zgjidhjeje jofunksionale.*
2. *Neni 71 i ligjit nr. 162/2020, i cili i njeh Autoritetit Kontraktor të drejtën për të përcaktuar dhe verifikuar karakteristikat teknike të produktit të ofruar. Demonstrimi "live" shërben për të verifikuar përputhjen midis specifikimeve dhe funksionalitetit real.*
3. *Neni 77 i ligjit nr. 162/2020, i cili ngarkon Autoritetin Kontraktor me përgjegjësinë për përzjedhen e ofertës më të favorshme dhe të përgjegishme. Verifikimi praktik është mjeti me objektiv për të shmangur ofertat fiktive.*
4. *VKM nr. 285/2021, e cila parashikon kërkimin e mostrave. Për produktet digjitale, demonstrimi "live" përbën ekuivalentin e mostrës.*

Në këtë kuptim, kërkesa që demonstrimi të realizohet mbi një sistem ekzistues dhe funksional përbën një garanci minimale që operatori ekonomik disponon realisht një platformë të zhvilluar dhe jo vetëm një koncept teorik.

Autoriteti Kontraktor thekson se:
a) Nuk keërkohet zhvillimi i njeë sistemi të personalizuar për AK në fazën e demonstrimit;
b) Keërkohet vetëm platforma bazë që realizon funksionet kryesore;
c) Kriteri zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Sa i përket pretendimeve për cënim të konfidencialitetit, Autoriteti Kontraktor sqaron se demonstrimi realizohet pa përdorur të dhëna reale dhe në kushte te kontrolluara.

Gjithashtu, për transparencë, gjatë demonstrimit mbahet procesverbal i detajuar për funksionalitet të testuar.

Përfundim

Për sa më sipër, ankesa nr. 4 nuk qëndron dhe rrëzohet në tërësi, duke mos u bërë asnjë ndryshim në kriterin 2.3.7 të Dokumenteve të Tenderit.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 5

(Paqartësi mbi infrastrukturën cloud dhe integrimet)

Në lidhe me pretendimet e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, të cilat kanë të bëjnë me paqartësi të pretenduara në Termat e References lidhur me sigurimin e infrastrukturës cloud, si dhe mungesën e detajeve teknike për integrimin me sisteme të tjera, Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto pretendime nuk përbëjnë shkelje të legislacionit në fuqi, por kërkojnë sqarim në funksion të përgatitjes së ofertës.

Autoriteti Kontraktor thekson se Dokumentet e Tenderit janë hartuar në përputhje me nenin 36 dhe nenin 71 të ligit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", duke përcaktuar kërkesat funksionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontrateës.

Në funksion të qartësimit të mënyrës së ofertimit dhe zbatimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor sqaron se:

1. *Infrastruktura cloud do të sigurohet nga operatori ekonomik, i cili duhet të përfshijë në ofertë të giitha kostot dhe elementet teknike të nevojshëm për funksionimin e sistemit;*
2. *Në lidhje me ndërveprimeve me sisteme të palëve të treta (si AKSHI, e-Albania, Tatimet, etj.), Autoriteti Kontraktor sqaron se këto realizohen nëpërmjet ndërfaqeve te dedikuara dhe janë të kushtëzuara nga procedurat dhe miratimet e institucioneve përkatëse;*
3. *Për rrjedhojë, këto ndërveprime nuk varen drejtpërdrejt nga Autoriteti Kontraktor apo operatori ekonomik, por nga rregullat dhe akseset e përcaktuara nga palët e treta.*

Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto elementë nuk cënojnë parimin e barazisë në ofertim, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte dhe kanë të njëjtin nivel informacioni për përgatitjen e ofertave.

Në këtë kuptim, mungesa e detajeve të plota teknike në këtë fazë nuk përbën shkelje të legislacionit në fuqi, por lidhet me natyrën e kontratës dhe ndërvarësinë nga sisteme të tjera institucionale.

Përfundim

Për sa më sipër, pretendimet e ngritura në ankesën nr. 5 nuk përbëjnë shkelie të legjislacionit në fuqi dhe rrëzohen si të pabazuara, ndërkohë që Autoriteti Kontraktor jep sqarimet përkatëse në funksion të transparencës dhe përgatitjes së ofertave.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 6
(Analiza dhe migrimi i të dhënave)

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit Autoriteti Kontraktor nuk ka percaktuar në mënyrë të detajuar elementë teknikë si volumet e të dhënave, struktura, tipologjia dhe kriteret e verifikimit të migrimit "pa humbje informacioni", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim qëndron pjeserisht.

Autoriteti Kontraktor thekson se në Dokumentet e Tenderit, konkretisht në Shtojcën përkatëse të Ternave të Referencës, është parashikuar qartë detyrimi i operatorit ekonomik fitues për të kryer analizën e bazës ekzistuese të të dhënave dhe për të realizuar migrimin e tyre në sistemin e ri, duke garantuar integritetin dhe vazhdimësinë e informacionit. Ky detyrim përbën një element thelbësor të objektit të prokurimit dhe është në përputhje me nenin 36, pika 1 dhe nenin 71 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Autoriteti Kontraktor çmon se, për shkak të natyrës së kontratës dhe kompleksitetit të sistemeve ekzistuese, analiza e detajuar e strukturës, volumit dhe karakteristikave të të dhënave përbën pjesë integrale të fazës së implementimit dhe, si e tillë, i përket operatorit ekonomik fitues, i cili duhet të disponojë kapacitetin teknik dhe eksperiencën e nevojshme për të realizuar këtë proces.

Në këtë kuptim, operatorët ekonomike, bazuar në eksperiencën e ngjashme dhe në praktikat standarde të tregut, janë në gjendje të dimensionojnë ofertat e tyre teknike dhe financiare mbi bazën e kërkesave funksionale të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se mungesa e disa parametrave orientues mbi volumet e të dhënave, tipologjinë dhe strukturën e tyre, si dhe mbi mënyrën e verifikimit të përmbushjes se kërkesës për migrim "pa humbje informacioni", mund të krijojeë paqartësi në procesin e ofertimit dhe të ndikojë në krahasueshmërinë e ofertave.

Në këto kushte, pa vënë në dyshim ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e kërkesës për migrimin e të dhënave, Autoriteti Kontraktor çmon të arsyeshme të bëjë saktesime të mëtejshme në Dokumentet e Tenderit, duke përcaktuar elementë orientues teknike mbi:

a) Volumet e përaferta të të dhënave;
b) Tipologjinë dhe strukturën e tyre;
c) Mënyrën e verifikimit të realizimit të migrimit "pa humbje informacioni", pa ndryshuar natyrën dhe thelbin e kërkesës së përcaktuar.

Përfundim
Për sa më sipër, ankesa nr. 6 pranohet pjesërisht, vetëm në drejtim të nevojës për saktësimin e disa elementeve orientues teknikë, ndersa pjesa tjetër e pretendimeve rrëzohet si e pabazuar.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 7
(Kriteri 2.3.5 - certifikimi ISO/IEC 42001:2023 për inteligienceën artificiale)

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit kërkesa për certifikatën ISO/IEC 42001:2023 për inteligiencën artificiale është. joproporcionale dhe në tejkelim të natyrës së kontrateës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim është i pabazuar.

Autoriteti Kontraktor, në zbatim të nenit 2 dhe nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe në respektim të neneve 11 dhe 12 të Kodit të Procedurave Administrative, ka përcaktuar kriteret kualifikuese në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës.

Në kundërshtim me sa pretendohet nga operatori ekonomik, Autoriteti Kontraktor nuk ka vendosur një kërkesë detyruese dhe përjashtuese vetëm për zotërimin e certifikatës ISO/IEC 42001:2023.

Nga përmbajtja e Dokumenteve të Tenderit rezulton qarte se operatorët ekonomikë kanë mundësinë të përmbushin këtë kërkesë edhe përmes:

1. *standardeve ekuivalente;*
2. *si dhe dokumentacionit teknik dhe organizativ, i cili provon zbatimin real dhe operacional të masave përkatëse.*

Në këto kushte, kërkesa për ISO/IEC 42001:2023 nuk përbën një kriter përjashtues, por një standard referues, i cili mund të përmbushet edhe përmes mjeteve të tjera ekuivalente, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive.

Sa i përket pretendimit se kërkesa nuk lidhet me natyrën e kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky interpretim nuk qëndron, pasi edhe në rastet kur përdorimi i komponentëve të inteligjencës artificiale është i kufizuar, kërkohet gjithsesi garantimi i përdorimit të sigurt, të kontrolluar dhe në përputhje me praktikat e mira të menaxhimit të këtyre teknologjive.

Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur me objektin e kontratës, proporcional dhe i hapur ndaj konkurrencës.

Përfundim
Për sa më sipër, ankesa nr. 7 nuk qëndron dhe rrëzohet në tërësi, duke mos u bërë asnjë ndryshim në kriterin 2.3.5 të Dokumenteve të Tenderit*.*

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 8

(Përdorimi i inteligjenceës artificiale dhe kostot operative)
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit Dokumentet e Tenderit nuk përcaktojnë qartë mbulimin e kostove operative që lidhen me pqerdorimin e komponenteve të inteligjencqes artificiale (si tarifa API, konsum token-ësh apo infrastrukturqe e dedikuar), Autoriteti Kontraktor vlerqeson se ky pretendim nuk pqerbën shkelje tqe legislacionit nqe fuqi.

Autoriteti Kontraktor thekson se komponenti i inteligjenceës artificiale i parashikuar në Termat e Referencqes nuk përbën një modul të veçantë apo një sistem të pavarur, por një funksionalitet ndihmës në formën një asistenti virtual (chatbot), i cili ka për qëllim ofrimin e informacionit për përdoruesit në kohe reale.

Në këte kuptim, ky komponent nuk përfaqëson një sistem të plotë të inteligjencës artificiale me ndikim të drejtpërdrejtë në procese vendimmarrëse, por një element mbështetës të sistemit, me rol informues dhe orientues.

Sa i përket kostove operative të lidhura me këtë funksionalitet, Autoriteti Kontraktor sqaron se: çdo zgjidhje teknike e propozuar nga operatori ekonomik, përfshirë edhe përdorimin e shërbimeve të inteligjencës artificiale, përbën pjesë integrale të ofertës së tij, kostot që lidhen me implementimin dhe funksionimin e këtij komponenti (përfshire tarifa API apo shërbime të ngjashme) duhet të parashikohen nga operatori ekonomik në ofertën e tij financiare, Autoriteti Kontraktor nuk parashikon mbulim të veçantë për këto kosto jashtë kontrateës së përgjithshme.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo qasje është në përputhje me natyreën e kontratës si një zgjidhje e integruar dhe nuk cënon parimin e barazisë në konkurrim, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte dhe janë të lirë të propozojnë mënyrën e implementimit të këtij funksionaliteti.

Përfundim
Për sa më sipër, ankesa nr. 8 nuk qëndron dhe rrëzohet në tëreësi, duke mos u bërë asnjë ndryshim në Dokumentet e Tenderit.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 9
(Pagesat online dhe integrimi me sistemin e taksave)
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilave mungon qarteësia mbi mënyrën e realizimit të pagesave online, përfshirë llojin e "payment gateëay" që do të integrohet dhe funksionimin e tij në raport me sistemin e taksave dhe tarifave vendore, Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto pretendime nuk përbëjne shkelje të legjislacionit në fuqi, por kërkojnë sqarim në funksion të përgatitjes së ofertes.

Autoriteti Kontraktor sqaron se funksionaliteti i pagesave online ka për qëllim mundësimin e kryerjes së pagesave nga qytetarët në mënyrë elektronike, nëpërmjet integrimit të sistemit me njeë ose me shumë shërbime të pagesave të autorizuara.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor thekson se:
1- Nuk është parashikuar kufizim ndaj një "payment gateëay" të caktuar, por operatorët ekonomikë janë të lirë të propozojnë zgjidhje teknike të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fugi dhe standardet e sigurisë së pagesave.
2- Integrimi duhet të mundësojë lidhjen funksionale ndërmjet sistemit të taksave dhe tarifave vendore dhe platformës së pagesave, duke garantuar rregjistrimin automatic dhe të saktë të pagesave të kryera.
3- Sistemi duhet të sigurojeë gjurmueshmëri, saktësi dhe përditësim në kohe reale të të dhënave të pagesave në bazën përkatëse;
4- Mënyra konkrete e implementimit teknik, përfshirë zgjedhjen e ofruesit të shërbimit të pagesave, mbetet në diskrecionin e operatorit ekonomik, i cili duhet të garantojë përputhshmëri me kërkesat funksionale të përcaktuara në Termat e Referencës.

Sa i përket kërkesave për integrimin e VKB-ve dhe legjislacionit përkatës fiskal, Autoriteti Kontraktor sqaron se ky funksionalitet konsiston në mundësimin e përditësimit dhe reflektimit në sistem të ndryshimeve ligiore dhe nënligiore që lidhen me administrimin e taksave dhe tarifave vendore, përfshirë:

1. *Ndryshimet ne legjislacionin fiskal;*
2. *Vendimet e Këshillit të Ministrave;*
3. *Vendimet e Këshillit Bashkiak;*
4. *Paketën fiskale vendore.*

Ky funksionalitet synon të sigurojë që sistemi të jetë i përditësuar dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, pa imponuar një metodologji specifike teknike për realizimin e tij.
Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto elementë janë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave dhe nuk cënojnë parimin e barazisë në konkurrim, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte.

Përfundim
Për sa më sipër, ankesa nr. 9 nuk qëndron dhe rrëzohet si e pabazuar, ndeërkohë që Autoriteti Kontraktor jep sqarimet përkatëse në funksion të transparencës dhe përgatitjes së ofertave.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 10
(Specifikimet teknike dhe funksionale për modulin e financës - General Ledger)

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit mungojnë specifikimet teknike dhe funksionale të detajuara për modulin e financës (General Ledger), Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendimq pjesërisht, vetëm në drejtim të nevojës për saktësim të mëtejshëm.

Autoriteti Kontraktor sqaron se specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", duke përcaktuar funksionalitetet kryesore dhe objektin e kontratës, pa kufizuar mënyrën e implementimit të zgjidhjes nga operatorët ekonomikë.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor ka synuar që përmes këtij formulimi të, garantojë konkurrencë të hapur dhe efektive, të shmangë kufizime teknike të panevojshme, lejojë fleksibilitet në zgjidhjet teknologjike të propozuara nga operatorët ekonomikë.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se përshkrimi i përgjithshëm i modulit të financës mund të krijojë paqartësi në procesin e ofertimit, veçanërisht në lidhje me kuptimin e funksionaliteteve minimale të kërkuara dhe dimensionimin teknik të zgjidhjes.

Në këto kushte, në funksion të rritjes së qartësisë dhe krahasueshmërisë së ofertave, Autoriteti Kontraktor çmon të arsyeshme të bëjë një saktësim të mëtejshëm të kërkesave funksionale minimale për modulin e financës, pa ndryshuar thelbin e specifikimeve teknike dhe objektin e kontratës.
Ky saktësim, nuk përbën ndryshim thelbësor të Dokumenteve të Tenderit, nuk cënon parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës, shërben vetëm për të standardizuar kuptimin e kërkesave dhe për të mundësuar hartimin e ofertave të krahasueshme.

Përfundim
Për sa më sipër, ankesa nr. 10 pranohet pjesërisht vetëm në drejtim të nevojës për saktësimin e disa elementëve funksionale, ndërsa specifikimet teknike dhe kërkesat në thelb mbeten të vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

...

Përgiigje mbi ankesën e pikës Nr. 11
(Metodologjia e vlerësimit dhe kriteret për përcaktimin e ofertës fituese)

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation mbi metodologjinë e vlerësimit të ofertave dhe kriteret për përcaktimin e ofertës fituese, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa duhet trajtuar në mënyrë të diferencuar për secilin element të ngritur, pasi një pjesë e pretendimeve nukqë, ndërsa një pjesë tjetër kërkon saktësim për efekt transparence.

Sa i përket pretendimit se metoda e përzgjedhjes "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto" është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim nuk qëndron në thelb. Nga Dokumentet e Tenderit rezulton se janë përcaktuar qartë kriteret kryesore të vlerësimit, përkatësisht çmimi, eksperienca e ngiashme, metodologjia dhe stafi teknik, si dhe pesha përkatëse e tyre në total prej 100 pikësh, në përputhje me nenin 45 të VKM nr. 285/2021 dhe ligjin nr. 162/2020.

Po ashtu, për kriterin e çmimit është përdorur formula standarde për kriteret me trend zbritës, e cila përbën praktikë të konsoliduar në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kuptim, çdo ofertues që paraqet çmimin më të ulët përfiton pikët maksimale, ndërsa ofertat e tjera pikëzohen proporcionalisht.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se formulimi aktual mund të përmirësohet në drejtim të qartësimit të elementëve të formulës së çmimit, duke specifikuar se treguesi i ofertës për këtë kriter është vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH, me qëllim shmangien e çdo interpretimi të mundshëm.

Sa i përket referencave të përdorura në DST, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disa elementë kërkojnë harmonizim me natyrën e kontratës dhe për këtë arsye do të bëhen korrigjimet përkatëse për efekt qartësie.

Në lidhje me nënkriterin "Eksperienca e ngjashme", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është në përputhje me qëllimin për të diferencuar cilësinë e ofertave përtej minimumit kualifikues. Megjithatë, konstatohet se formulimi i tij kërkon saktësim neë drejtim të përcaktimit të treguesve dhe mënyrës së përllogaritjes së pikëve, si dhe neë dallimin midis kriterit kualifikues dhe atij vlerësues.

Sa i përket nënkriterit "Metodologjia e propozuar", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, por pranon se disa elementë të formulimit mund të krijojnë mbivendosje me kriterin e stafit teknik dhe hapësirë për interpretim.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor do të bëjë riformulimin përkatës të këtij nënkriteri, duke saktësuar elementët e vlerësimit dhe duke kufizuar diskrecionin në përputhje me parimet e transparencës dhe objektivitetit.

Në lidhje me nënkriterin "Eksperienca e stafit teknik", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është thelbësor për natyrën e kontratës, por konstatohet se terminologjia dhe struktura e tij kërkojnë harmonizim me kriteret kualifikuese dhe saktësim të mëtejshëm.

Tenderit, me qëllim qartësimin e plotë të këtij kriteri dhe garantimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Përfundim
Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se metodologjia e përzgjedhjes së ofertës fituese është në thelb në përputhje me legjislacionin në fuqi, por pranon se disa elementë të saj kërkojnë saktësim dhe përmirësim për efekt transparence dhe qartësie.
Për rrjedhojë, ankesa nr. 11 pranohet pjesërisht, duke u reflektuar përmes modifikimeve përkatëse në Dokumentet e Tenderit, pa cënuar thelbin e procedures.".

II.5. Në datën 13.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6521, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1132/2026 prot., datë 14.04.2026 e operatorit ekonomik "***Smart ICT Services***" SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.7. Në shkresën nr. 1329/24 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1132/1 prot, datë 19.05.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik ndër të tjera, shkresën nr. 1329/21 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Smart ICT Services" SHPK*", ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, në të cilin

konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon

"...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 1

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik, sipas të cilit Autoritit Kontraktor nuk ka përcaktuar në mënyrë të detajuar elementë teknike si volumet e të dhënave, struktura, tipologjia dhe kriteret e verifikimit të migrimit "pa humbje informacioni" Autoriteti Kontraktor vlerëëson si më poshtë:,

Në dokumentet e tenderit, konkretisht në Shtojcën 6, është parashikuar në mënyrë të qartë detyrimi i operatorit ekonomik fitues për të kryer analizën e bazës ekzistuese të të dhënave dhe migrimin e tyre në sistemin e ri, duke garantuar integritetin dhe vazhdimësinë e informacionit.

Kjo kërkesë përbën një element thelbësor të objektit të prokurimit dhe është në përputhje me nenin 36, pika 1 të ligiit nr. 162/2020, pasi lidhet drejtpërdrejt me karakteristikat funksionale të shërbimit që kërkohet të ofrohet.

Autoriteti Kontraktor çmon se, për shkak të natyrës së kontratës dhe komplekstetit të sistemeve ekzistuese, analiza e detajuar e strukturës dhe volumit të të dhënave përbën pjesë integrale të fazës së implementimit dhe, si e tillë, i përket në mënyrë të arsyeshme operatorit ekonomik fitues, i cili duhet të disponojë kapacitetin teknik dhe eksperiencën e nevojshme për të realizuar një vlerësim të plotë dhe të saktë të kësaj faze.

Në këtë kuptim, operatorët ekonomike, bazuar në eksperiencen e tyre në projekte te ngiashme dhe në praktikat standarde të tregut, janë në gjendje të vlerësojnë dhe të dimensionojnë ofertat e tyre financiare dhe teknike edhe në mungesë të një specifikimi të plotë të çdo elementi të detajuar teknik.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlereson se mungesa e disa parametrave orientues mbi volumet e të dhenave, tipologjine dhe strukturen e tyre, si dhe mbi mënyrën e verifikimit të përmbushjes së kërkesës për migrim "pa humbje informacioni", mund të krijoje paqartësi në procesin e ofertimit, veçanërisht në lidhje me dimensionimin teknik dhe ekonomik të ofertave, si dhe të ndikojë në krahasueshmërinë e tyre.

Për rrjedhojë, pa vënë në dyshim ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e kërkesës për migrimin e të dhënave, Autoriteti Kontraktor çmon të arsyeshme dhe në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës efektive, të bëjë saktësime të mëtejshme në dokumentet e tenderit, duke përcaktuar disa elemente orientues, pa ndryshuar natyrën dhe thelbin e kërkesës.

PËRFUNDIM

Për sa me sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se:

Pretendimi i operatorit ekonomik pranohet pjesërisht, vetem në drejtim të nevojës për saktësimin e disa elementeve orientues teknike, pa ndryshuar natyrën dhe thelbin e kërkesës për migrimin e të dhënave.

…

Përgiigje mbi ankesën e pikës Nr.2

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik, sipas të cilit: ".. autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar mënyrën e aksesit në sistemet e palëve të treta, dokumentacionin teknik të ndërfaqeve (API)) standardet e komunikimit, kërkesat për autentikim dhe autorizim, si dhe përgjegjësitë kontrete për realizimin e integrimeve..." Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshte:

Në dokumentet e tenderit, konkretisht në Shtojcën 6 - Specifikimet Teknike, është përcaktuar në mënyrë të qartë se sistemi që kërkohet të implementohet duhet të funksionojë në arkitekture Ëb-Cloud dhe të ndërveprojë me një sërë sistemesh dhe platformash shtetërore dhe financiare, përfshiëre:

a) *Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (ESB);*
b) *Sistemet e AKSHI-t;*
c) *Sistemin qëndror të Tatimeve;*
d) *Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);*
e) *Subjektet financiare (bankat);*
f) *Portalin e-Albania.*

Gjithashtu, në specifikimet teknike janë parashikuar elementë konkretë arkitekturore dhe teknike, si:

a) *Përdorimi i një gasjeje API-first;*
b) *Komunikimi përmes protokolleve të sigurta HTTPS/TLS;*
c) *Ndërveprimi neë kohë reale për shkëmbimin e të dhënave;*
d) *Integrimi nëpërmjet platformave të ndërveprimit të administruara në nivel qëndror.*

Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor çmon se kërkesa për realizimin e integrimeve nuk është një kërkesë e përgiithshme apo e papërcaktuar, por është e lidhur ngushtë me funksionalitetet bazë të sistemit.

Sa i takon pretendimit për mungesë të detajimit teknik, Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto elementë varen nga:

a) *Infrastruktura dhe politikat e institucioneve të treta;*
b) *Marrëveshjet ndërinstitucionale për shkëmbimin e të dhënave;*
c) *Procedurat e autorizimit për akses në këto sisteme.*

Megjithate, nẽ funksion të transparencës dhe krahasueshmërisë sẽ ofertave, Autoriteti Kontraktor vlerëson të arsyeshme saktësimin e:

Ndarjes së përgjegjësive ndeërmjet AK dhe OE;
Mënyrës së aksesit (API, ESB ose forma të tjera);
Kushtëzimit të integrimeve nga autorizimet e institucioneve perkatëse.

PËRFUNDIM
Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron në thelb.
Megjithatë, ankesa pranohet pjesërisht vetëm për saktësim teknik, pa ndryshuar natyrën dhe kërkesat thelbësore të kontratës.

…

Përgjigie mbi ankesën e pikës Nr.3

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik, sipas të cilit: ".autoriteti kontraktor ka listuar raportet, por nuk ka përcaktuar karakteristikat teknike, strukturën, mënyrën e implementimit dhe parametrat e performancës së tyre..." Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

1. Mbi përmbajtjen e specifikimeve teknike
Nga shqyrtimi i Shtojcës 6 rezulton se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar listën e funksionaliteteve analitike në seksionin SF-5.1 "Raportimi Analitik", ku përfshihen ndër të tjera:

a) Raport i pergjithshem mbi subjektet/pronat
b) Raporti per debitoret/kreditoret
c) Raporti mbi adresat/njesite e biznesit
ç) Raport i subjekteve te pezulluara
d) Ditari i Arkes/Bankes
dh) Ditari i pagesave te subjekteve
e) Historiku i subjekteve
ë) Historiku i veprimeve te perdoruesit (audit log)
f) Statistika mbii detyrimet dhe subjektet
g) Marreveshjet e borxhit

Sa më sipër, rezulton se janë përcaktuar qqartë funksionet analitike që duhet të përmbajë sistemi.

2. Mbi natyrën teknike të raportimeve
Raportimet janë të lidhura drejtpërdrejt me:

a) Strukturën e databazes;
b) Proceset e llogaritjes së detyrimeve;
c) Regjistrimet e pagesave;
ç) Historikun dhe auditimin e sistemit.

Në këtë kuptim, mënyra e implementimit:

a) Varet nga arkitektura teknike e propozuar nga OE;
b) Eshtë pjese e zgjidhjes teknologiike ge ofrohet në ofertë;
c) Nuk mund të standardizohet në nivel të detajuar nga AK pa kufizaar konkurrencën.

3. Mbi pretendimin për mungesë te parametrave teknikë
Autoriteti Kontraktor konstaton se ankuesi pretendon mungesë të:

a) Strukturës se detajuar te raporteve;
b) Burimeve të të dhënave;
c) Parametrave të performances;
ç) Menyres se gienerimit dhe formatit.

Në vlerësim të këtij pretendimi, Autoriteti Kontraktor çmon se:

a) Funksionalitetet janë te percaktuara garte;
b) Detajimi ne nivel fushash do te kufizonte zgjidhjet teknike;
c) Qasja funksionale eshte ne perputhje me ligjin.

Megjithatë, për të shmangur paqartësi në ofertim, është e arsyeshme saktësimin:

a) Formatit te daljes (PDF, Excel, dashboard);
b) Menyres se gjenerimit (on-demand, periodike).

4. Vleresimi juridik
Në kuptim të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020:

a) Specifikimet teknike mund te hartohen ne forme funksionale;
b) Nuk duhet te kufizone konkurrencen;
c) Duhet te lejone kuptimin e objektit te kontrates.

Në rastin konkret:

Kërkesat janë të qarta në funksion;
Janë të lidhura me objektin;
Nuk krijonë diskriminim.

PËRFUNDIM
Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron nqe thelb.
Megjithatë, ankesa pranohet pjesqerisht vetëm për saktësim teknik, pa ndryshuar kërkesat thelbësore të kontratës.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr.4

Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshte:

1. Mbi natyrën dhe funksionin e komponenteve të kërkuar

Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike (Shtojca 6, pika SF-6.1) rezulton se komponentët e kundershtuar janë pjesë integrale e sistemit, konkretisht:

a) "Bazë të dhënash për pagesat që replikon me bazën e sistemit të taksave" lidhet drejtpërdrejt me:
- *Modul SF-4.1 Arkëtime/Urdhërpagesa;*
- *Integrimin me subjektet financiare;*
- *Rakordimin automatik të pagesave;*

b) API-të e përcaktuara lidhen me:
- *Komunikimin me AKSHI (ESB);*
- *Shkëmbimin e të dhënave me DPT dhe RGJC;*
- *Dërgimin e njoftimeve përmes e-Albania;*
-

c) Gjenerimi masiv i dokumenteve lidhet me:
- *Funksionin SF-3.1 Njoftimi i detyrimeve;*
- *Gjenerimin e njoftimeve tatimore dhe dokumenteve ekzekutive.*

2. Mbi pretendimin për mungesë të parametrave teknike Autoriteti Kontraktor vlerëson se:

a) Sistemi është përcaktuar të funksionojë neë arkitekturë cloud dhe API-based;
b) Ndërveprimi kerkohet ne kohe reale ose afer kohës reale;
c) Arkitektura scalable presupozon dimensionim nga OE;
ç) Gjenerimi i dokumenteve êshtê konceptuar si proces masiv për fushatanj ofttmi.

3. Mbi arsyen e mungesës së parametrave të detajuar
Autoriteti Kontraktor çmon se:

a) Përcaktimi i parametrave të detajuar teknike do të kufizonte zgjidhjet alternative;
b) Sistemi është kërkuar në mënyrë funksionale dhe teknologjikisht neutrale;
c) Dimensionimi teknik është përgjegjësi e OE.

4. Mbi ndikimin në konkurrencë
Autoriteti Kontraktor vlerëson se:

a) Kërkesat janë të njëjta për të giithë operatorët;
b) Nuk referojnë teknologji specifike;
c) Nuk krijojnë avantazh të padrejtë.

Megjithatë, për të shmangur paqartësi, mund të saktësohen parametra orientues mbi volumet dhe përdorimin.

PËRFUNDIM
Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron ne thelb.
Megjithatë, ankesa pranohet pjesqerisht vetëm për saktësim teknik, pa ndryshuar kërkesat thelbësore të kontratës.
…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr.5

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik se mungesa e përcaktimit të numrit të përdoruesve dhe volumit të të dhënave e bën të pamundur ofertimin, Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

Së pari, nga shqyrtimi i specifikimeve teknike rezulton se sistemi i kërkuar është konceptuar si një platforme Ëb-Cloud e shkallëzueshme, e cila në vetvete përjashton nevojën për dimensionim të ngurtë paraprak të përdoruesve apo volumit të të dhënave.

Në mënyrë të veçantë, në DST është përcaktuar:

a) Akses përmes shfletuesit pa instalim lokal;
b) Perdorim nga kategori të ndryshme perdoruesish (administrate, biznese, gytetarë);
c) Ndërveprim me sisteme të tjera shtetërore;
ç) Funksionalitete që mbulojnë subjekte, prona, familjare, detyrime dhe pagesa.

Sa më sipër, tregon qartqe se kemi tqe bqejmqe me një sistem:

a) *Me perdorim te giere institucional;*
b) *Me arkitekturë te shkallzueshme;*
c) *Jo me kapacitet te kufizuar.*

Për rrjedhojë, përcaktimi i një numri të fiksuar përdoruesish apo volumesh:

a) *Do të ishte artificial;*
b) *Nuk do te reflektonte perdorimin real te sistemit;*
c) *Do të kufizonte zgjidhjet teknike te operatoreve ekonomike.*

Së dyti, operatorët ekonomikë që veprojnë në këtë fushë:

a) *Kane eksperience ne sisteme te ngjashme;*
b) *Janë ne giendje te dimensionone zgjiahjen bazuar ne kerkesat funksionale.*

Së treti, mungesa e një numri fiks përdoruesish:

a) *Nuk krijon avantazh per anje operator;*
b) *Nuk diskriminon pjesëmarresit;*
c) *Nuk cenon konkurrencen.*

Përkundrazi, kjo qasje:

a) *Garanton neutralitet teknologjik;*
b) *Lejon fleksibilitet ne ofertim;*
c) *Perputhet me natyren cloud te sistemit.*

PËRFUNDIM
Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron dhe rrëzohet.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr.6

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik, sipas të cilit: "...kërkesa për një numër minimal punonjësish dhe mënyra e provimit të stafit përmes listëpagesave apo kontratave krijon mospërputhje dhe është joproporcionale..."

Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

1. Mbi natyreën e kriterit të vendosur

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar:

a) *Një numër minimal të fuqisqe punëtore;*
b) *Disponueshmërinë e stafit teknik të specializuar.*

Ky kriter eshtë vendosur në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

2. Mbi lidhjen e kriterit me objektin e kontratës
Objekti i prokurimit përfshin:

a) *Analizën dhe migrimin e të dhënave;*
b) *Zhvillimin e moduleve funksionale;*
c) *Integrimin me sisteme shtetërore dhe financiare;*

ç) Implementimin e portalit per gytetare dhe biznese;

d) *Implementimin e komponentit te inteligjencës artificiale (Al);*

dh) Testimin, trajnimin dhe vënien në punë tê sistemit;

e) *Mirembaitjen për një periudhe 12-mujore.*

3. Mbi proporcionalitetin e kriterit Autoriteti Kontraktor vlerëson se:

a) *Kërkesa për një numër minimal punonjësish është në përpjesëtim me kompleksitetin e projektit;*
b) *Nuk është e tepruar në raport me natyrën e shërbimit;*
c) *Nuk kërkon që të gjithë punonjësit të jenë specialiste IT.*

4. Sqarim mbi strukturën organizative dhe stafin teknik
Sa i takon pretendimit për mosperputhje, Autoriteti Kontraktor sqaron se:

a) *Numri minimal prej 10 punonjësish përfaqëson strukturën organizative të përgjithshme të operatorit ekonomik;*
b) *Kjo strukturë përfshin:*
- *staf administrativ;*
- *staf financiar;*
- *staf mbështetes;*
- *si dhe staf teknik;*

c) Këta punonjes duhet te jenë te perhershem dhe te provuar pêrmes listepagesave;
- *Stafi teknik i specializuar:*
- *mund tê jetë pjeserisht pjesê e kesaj strukture;*
- *por mund te angazhohet edhe permes kontratave të punes.*

Për rrjedhojë, kërkesa për fuqinë punëtore dhe mënyra e provimit të stafit i referohen niveleve të ndryshme të kapaciteteve dhe nuk përbëjnë mospërputhje.
5. Mbi ndikimin në konkurrencë
Autoriteti Kontraktor vlereson se:
a) *Kriteri eshte i njäjtenger te gjithe operatorêt ekonomikë;*
b) *Nuk favorizon apératore te caktuar;*
c) *Nuk vendos kerkesa të paarritshme.*

PËRFUNDIM
Pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron dhe rrëzohet.

PËRFUNDIM I PËRGJITHSHËM
Autoriteti kontraktor vlerëson se dokumentet e tenderit janë hartuar në përputhje me ligjin dhe nuk cënojnë konkurrencën apo trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.
Për rrjedhojë:
- Ankesat 1-4 nuk qëndrojnë në thelb dhe trajtohen vetëm me sqarime.
- Ankesat 5-6 rrëzohen plotësisht.".

II.8. Në datën 13.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026 e operatorit ekonomik "***KREATX***" SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.9. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.10. Me shkresën nr. 1329/30 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1133/1 prot, datë 19.05.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe shkresa nr. 1329/19 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "KREATX" SHPK*", ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

"*... **Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 1***
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "KREATX" shpk, sipas të cilit procedura e prokurimit me objekt "Blerje sistem menaxhimi financiar" përbën në thelb një kontratë shërbimi dhe jo furnizimi, si dhe për rrjedhojë Autoriteti Kontraktor ka gabuar në përdorimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim nuk qëndron në mënyrën absolute siç paraqitet nga ankimuesi.
Në vlerësimin e natyrës juridike të një kontrate publike, përcaktues nuk është vetëm ekzistenca e elementëve të caktuara të sherbimit apo funizimit, por identifikimi i elementit dominues të kontratës në raport me objektin dhe qëllimin e saj. Në rastin konkret, objekti i prokurimit konsiston në sigurimin e një zgjidhjeje të integruar softëare për menaximin financiar të institucionit, e cila përfshin furnizimin me sistemin përkatës, vënien në funksion dhe garantimin e përdorimit të tij gjatë periudhës kontraktore.
Elementët e implementimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjes janë të lidhur ngushtë me funksionalizimin e këtij sistemi dhe përbëjnë komponentë ndihmës të nevojshëm për përdorimin efektiv të produktit, por nuk e përcaktojnë në mënyrë të vetme natyrën juridike të kontratës.
Referimet e bëra nga operatori ekonomik në nenin 4 të ligjit nr. 162/2020 dhe në nenin 15 të rregullave të prokurimit publik janë të sakta në aspektin e dallimit teorik ndërmjet kontratave të furnizimit dhe atyre të shërbimit, por këto dispozita nuk përjashtojnë rastet kur një kontratë përfshin elementë të përziera dhe keërkon një vlerësim të përgiithshëm të objektit të saj. Legislacioni i prokurimit publik nuk parashikon një ndalim për klasifikimin si furnizim të kontratave që përmbajnë edhe komponentë shërbimi, për aq kohë sa elementi kryesor i kontratës lidhet me sigurimin e një produkti të përdorshëm nga autoriteti kontraktor.
Sa i përket pretendimit për mungesën e shtojcave që lidhen me listën e artikujve dhe grafikun e lëvrimit, Autoriteti Kontraktor sqaron se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me furizim të mallrave fizike të ndara në artikuj, por me një sistem softëare të integruar, i cili nuk mund të strukturohet në mënyrë të njëjtë si një kontratë klasike furnizimi. Megjithatë, për qëllime të rritjes së qartësisë dhe shmangies së çdo paqartësie në procesin e ofertimit, Autoriteti Kontraktor vlerëson të arsyeshme të bëjë përshtatjet përkatëse në dokumentacion, pa ndryshuar thelbin e objektit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin se në kontratat e furnizimit nuk mund të vendosen kërkesa për personelin, Autoriteti Kontraktor thekson se, në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020, autoritetet kontraktore kanë të drejtë të kërkojnë prova mbi kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, përfshirë burimet njerëzore, në çdo rast kur këto janë të domosdoshme për realizimin e kontratës. Në një kontratë të natyrës së tillë, ku përveç furnizimit kërkohet edhe implementimi dhe funksionalizimi i sistemit, kërkesa për disponimin e stafit teknik nuk përbën tejkalim të ligjit, por një garanci për realizimin e suksesshëm të kontratës. Sa i përket referencës së operatorit ekonomik ndaj praktikave të institucioneve të tjera, Autoriteti Kontraktor vlerëson se praktikat administrative nuk kanë karakter detyrues dhe çdo procedurë prokurimi duhet të vlerësohet në raport me nevojat konkrete dhe specifikat e objektit që prokurohet. Për këtë arsye, fakti që në raste të tjera janë përdorur procedura shërbimi nuk përbën në vetvete provë për klasifikim të detyrueshëm në këtë rast.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se klasifikimi i procedurës dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit janë të justifikuara në raport me objektin e kontratës dhe nuk përbëjnë shkelje të legjislacionit në fuqi. Megjithatë, për qëllime të qartësimit dhe përmirësimit të dokumentacionit, do të bëhen saktësimet përkatëse në DST, pa ndikuar në thelbin e procedurës.

Për rrjedhojë, ankesa neë këtë pikë nuk pranohet në thelb, por merret pjesërisht në konsideratë vetëm për efekt sqarimi.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 2

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Kreatx SHPK, sipas teë cilit "AK e ka plotësuar formularin e njoftimit paraprak të informacionit në fillim të DST, por në pikën nr. 4.2 të Formularit të Njoftimit të Kontratës ka plotësuar se për këtë kontratë nuk gjen zbatim ky njoftim" dhe se "Kjo kontraditë në DST duhet saktësuar nga AK, pasi sjell konfuzion për OE ofertues lidhur me dokumentacionin dhe fazat që kalon procedura e prokurimit publik", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim nuk qëndron në pjesën ku ankimuesi i atribuon kësaj pasaktësie pasoja juridike mbi vlefshmërinë apo natyrën e procedurës.

Nga shgyrtimi i dokumentacionit të tenderit rezulton se seksioni "Njoftimi Paraprak i Informacionit/Njoftimi Periodik i Informacionit" është pjesë e formularëve standarde të përfshirë në modelin e dokumenteve të tenderit dhe vetë ai seksion parashikon shprehimisht se plotësohet vetëm "nëse aplikohet". Nga ana tjetër, në Njoftimin e Kontratës, ne pikën 4.2, është percaktuar qartë dhe pa ekuivok se për këtë procedurë nuk Është përdorur njoftimi paraprak/periodik i informacionit, duke u shënuar "Jo", ndërsa në pikën 4.2.1 është përcaktuar po ashtu se nuk aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave. Për rrjedhojë, dokumenti që pasqyron vullnetin procedural të Autoritetit Kontraktor për procedurën konkrete është vetë Njoftimi i Kontratës, i cili qartëson se nuk

kemi procedurë të ndërtuar mbi njoftim paraprak dhe as procedurë me efekte që lidhen me të.

Në këto kushte, prania e disa të dhënave të plotësuara për seksionin standard të njoftimit paraprak nuk ka prodhuar dhe as mund të prodhojë ndonbjë efekt juridik mbi ecurinë e procedures, mbi afatet, mbi fazat e saj apo mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë. Procedura është publikuar si "E Hapur, mbi kufirin e lart monetar", me afat normal paraqitjeje ofertash, pa shkurtim afatesh dhe pa asnjë element tjetër procedural që do të lidhej me përdorimin efektiv të një njoftimi paraprak informacioni. Për rrjedhojë, nuk jemi përpara një kontradikte thelbësore që cënon ligishmërinë e procedurës, por përpara një mosperputhjeje formale në përmbajtjen e një formulari standard, e cila nuk ka ndikuar në konkurrencë, në transparencë substanciale apo në trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi i operatorit ekonomik se kjo situatë krijon paqartësi mbi "fazat që kalon procedura" nuk provohet nga vetë dokumentacioni, pasi procedura nuk është procedurë me faza, nuk është procedurë e kufizuar, nuk është procedurë konkurruese me negocim dhe nuk shoqërohet me mekanizma të veçantë që do të vareshin nga përdorimi i njoftimit paraprak të informacionit. Përkundrazi, nga dokumentet e tenderit rezulton qartë se kemi një procedurë të hapur, me objekt të përcaktuar, me numër reference të identifikuar, me afat të qartë për paraqitjen e ofertave dhe me kriteret përkatëse të vlerësimit të shpallura në mënyrë të plotë. Në këtë kuptim, nuk rezulton që ndonjë operator ekonomik të jetë penguar në ofertim, të jetë vendosur në pozitë të pafavorshme apo të ketë pësuar kufizim konkurrues për shkak të kësaj pasaktësie formale.
Megjithatë, në respektim të parimit të transparencës dhe me qëllim shmangien e çdo paqartësie të mundshme interpretimi, Autoriteti Kontraktor vlerëson të arsyeshme të bëjë saktësimin përkatës në dokumentacionin e procedurës, duke unifikuar referencat lidhur me seksionin e njoftimit paraprak të informacionit, pa ndikuar në përmbajtjen thelbësore të dokumenteve të tenderit dhe pa sjellë ndryshim të natyres apo vlefshmërisë së procedurës.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa nr. 2 nuk përbën shkak për ndryshim thelbësor të dokumenteve të tenderit dhe as për anullim të procedurës, por merret pjesërisht në konsiderate vetëm për efekt sqarimi dhe harmonizimi formal të dokumentacionit.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 3
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Kreatx SHPK mbi metodologjinë e vlerësimit të ofertave dhe kriteret për përcaktimin e ofertës fituese, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa duhet trajtuar në mënyrë të diferencuar për secilin element të ngritur, pasi një pjesë e pretendimeve nuk qëndrojëne, ndërsa një pjesë tjetër kërkon saktësim për efekt transparence.

Sa i përket pretendimit se metoda e përzgjedhjes "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto" nuk është e qartë dhe bie ndesh me nenin 45 të RRPP, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo nuk qëndron në thelb. Nga DST rezulton se janë përcaktuar qartë katër kriteret kryesore të vlerësimit, përkatësisht çmimi, eksperienca e ngjashme, metodologjia dhe stafi teknik, si dhe pesha përkatëse e tyre në total prej 100 pikësh, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Po ashtu, për kriterin e çmimit është përdorur formula standarde e parashikuar në nenin 45 të RRPP për kriteret me trend zbritës, e cila është praktike e konsoliduar në procedurat e prokurimit publik.

Pretendimi se nuk kuptohet zbatimi i formulës për çmimin nuk qëndron në aspektin metodologjik, pasi "vlera më e uleët" (Vmin) dhe "treguesi i ofertes" (Okn) janë elementë standartë të formulës dhe i referohen drejtpërdrejt vlerës totale të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatorët ekonomike. Në këtë kuptim, çdo ofertues që paraqet çmimin më të ulët përfiton pikët maksimale, ndërsa ofertat e tjera pikëzohen proporcionalisht, çka është në përputhje me praktikën e ndjekur gjërësisht.
Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se formulimi aktual në DST mund të përmirësohet në drejtim të qartësimit eksplicit të këtyre elementëve, duke specifikuar se treguesi i ofertës për kriterin e çmimit është vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH, me qëllim shmangien e çdo interpretimi të mundshëm nga operatorët ekonomikë.

Në lidhje me referimin ndaj VKM nr. 354/2016 në shenimin poshtë formulës së cmimit, Autoriteti Kontraktor pranon se ky referim nuk është i përshtatshëm për natyrën e kësaj kontrate dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Për rrjedhojë, ky element do të korrigjohet për efekt harmonizimi të dokumentacionit.

Sa i përket nënkriterit "Eksperienca e ngjashme", Autoriteti Kontraktor vlerëson se parimi i përdorur është i drejtë dhe në përputhje me qëllimin për të identifikuar ofertën me cilësore, duke diferencuar operatorët mbi bazën e eksperiencës përtej minimumit kualifikues. Megjithatë, konstatohet se formulimi i treguesit të ofertës dhe mënyra e përllogaritjes së pikëve nuk është paraqitur me qartësi të plotë, si dhe ekziston një paqartësi midis kriterit kualifikues dhe kriterit të vlerësimit me pikë.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme të bëjë saktësimin përkatës në DST, duke përcaktuar qartë çfarë konsiderohet "eksperiencë e ngjashme" për efekt vlerësimi me pikë, mënyrën e llogaritjes së treguesit të ofertës për këtë kriter, si dallimin midis minimumit kualifikues dhe elementëve që sjellin pikë shtesë.

Në lidhje me nënkriterin "Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit", Autoriteti Kontraktor vlerëson se struktura e këtij kriteri është në përputhje me praktikat vlerësimit cilësor, por pranon se disa elementë të tij mund të krijojnë mbivendosje me kriterin e stafit teknik, veçanërisht në pjesën që lidhet me organizimin dhe përshkrimin e stafit.

Gjithashtu, disa elementë të formulimit, si "qartësia në interpretimin e objektit" apo "mjetet dhe teknikat e propozuara", mund të përmirësohen për të reflektuar më saktë natyrën e kontratës, e cila lidhet me zgjidhje teknologjike dhe jo me punë fizike.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson të arsyeshme të rishijojë këtë nënenkriter, duke shmangur mbivendosjen me kriterin e stafit teknik, riformuluar elementët e vlerësimit në mënyrë më të qartë dhe të matshme, si dhe kufizuar diskrecionin e vlerësimit në përputhje me parimin e transparencës.

Sa i përket nënkriterit "Eksperienca e stafit teknik", Autoriteti Kontraktor vlerëson se qëllimi i këtij kriteri është i drejtë dhe në përputhje me nevojën për të garantuar kapacitetet profesionale për zbatimin e kontratës. Megjithatë, konstatohet se terminologjia e përdorur në DST nuk është plotësisht e harmonizuar me kriteret kualifikuese, duke krijuar paqartësi për operatorët ekonomikë.
Në veçanti, përdorimi i termit "drejtues projekti" në vend të "menaxher projekti", mungesa e një perkufizimi të qartë për "stafin teknik kryesor", si dhe mungesa e ndarjes së qartë të pikëzimit midis eksperiencës së përgithshme dhe asaj specifike, janë elementë që kërkojnë saktësim.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor do të bëjë përmirësimet përkatëse në DST, me qëllim qartësimin e plotë të këtij kriteri dhe garantimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në peërfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se metodologjia e përzgjedhes së ofertës fituese është në thelb në përputhje me legjislacionin në fuqi, por pranon se disa elementë të saj kërkojnë saktësim dhe përmirësim për efekt transparence dhe qartësie. Për rrjedhojë, ankesa merret piesërisht në konsideratë, duke u reflektuar përmes modifikimeve përkatëse në dokumentet e tenderit, pa cënuar thelbin e procedurës.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 4
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik mbi mosplotësimin e shtojcave nr. 2, nr. 3 dhe nr. 7 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

Nga shgyrtimi i DST rezulton se objekti i procedurës është konceptuar si "blerje sistemi për menaxhim financiar", i cili në thelb përbën një zgjidhje të integruar softëare, e cila përfshin zhvillim, implementim, konfigurim, integrim dhe mirëmbajtje. Në këtë kuptim, edhe pse në Njoftimin e Kontratës është klasifikuar si kontrate për mallra, përmbajtja e specifikimeve teknike dhe mënyra e realizimit të kontratës tregojnë se kemi të bëjmë me një kontratë me natyrë mbizotërues.

Në këtë kontekst, mungesa e plotësimit të shtojcave nr.2 dhe nr.3, të cilat lidhen me lista të detajuara të artikujve dhe çmimeve për njësi, nuk ka ardhur si pasojë e një mospërmbushjeje formale, por si

reflektim i natyrës së kontratës, e cila nuk përbehet nga artikuj të standardizuar dhe të matshëm në njësi fizike, por nga një zgjidhje softëare e integruar që ofrohet si paketë funksionale.
Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo mënyrë formulimi krijon paqartësi për operatorët ekonomikë në lidhje me strukturën e ofertës ekonomike dhe elementët që duhet të përfshihen në të. Në veçanti, mungesa e një ndarjeje të qartë të komponentëve të ofertës (implementim, licencim, integrim, mirëmbajtje) mund të ndikojë në mënyrën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Po kështu, sa i takon shtojcës nr.7 "Grafiku i ekzekutimit" konstatohet se edhe pse në specifikimet teknike janë parashikuar fazat e realizimit të projektit dhe afatet përkatëse (implementim brenda 6 muajve dhe mirëmbajtje 12 muaj), këto nuk janë reflektuar në mënyrë të strukturuar dhe të formalizuar në shtojcën përkatëse, duke krijuar mungesë koherence brenda dokumentacionit të tenderit.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht në drejtim të nevojës për qartësim dhe plotësim të dokumentacionit, me qëllim garantimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, duke reflektuar në mënyrë të qarte strukturën e ofertës ekonomike përmes një ndarjeje funksionale të komponentëve të zgjidhjes, si dhe duke plotësuar shtojcat përkatëse me elementët orientues të nevojshëm për ofertim, pa ndryshuar thelbin e objektit të prokurimit.

…

Përgjigie mbi ankesën e pikës Nr. 5
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi përmbajtjen e specifikimeve teknike në shtojcën nr.6 të DST, Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

Sa i përket referimit të bërë në DST lidhur me nivelin e sigurisë së sistemit dhe detyrimin për zbatimin e rregulloreve të miratuara nga ish Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky formulim është bërë në përputhje me kuadrin rregullator ekzistues në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit dhe synon të garantojë standarde të larta të sigurisë për të dhënat fiskale dhe funksionimin e sistemit.

Megjithatë, duke marrë në konsiderate hyrjen ne fuqi të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", si dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, përfshirë VKM nr. 531/2025, Autoriteti Kontraktor pranon se referimi ndaj strukturës institucionale dhe rregulloreve të mëparshme kërkon përditësim, me qëllim harmonizimin e plotë të dokumentacionit të tenderit me kuadrin e ri ligjor dhe institucional në fuqi.

Në këtë kuptim, edhe pse kërkesa për respektimin e standardeve të sigurisë mbetet e vlefshme në thelb dhe nuk cënon konkurrencën, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme të modifikojë formulimin ëperkatës në DST, duke iu referuar kuadrit aktual ligjor dhe autoritetit kompetent për sigurinë kibernetike, me qëllim shmangien e çdo paqartësie për operatorët ekonomikë.

Sa i përket pretendimit mbi formulimin e ndërveprimit të sistemit me "subjekte financiare", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky formulim synon të përfshijë në mënyrë të përgjithshme subjektet që operojnë në fushën e pagesave dhe arkëtimeve, përfshirë bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera financiare të licencuara që mund të ofrojnë shërbime pagesash.
Megjithatë, Autoriteti Kontraktor pranon se përdorimi i këtij termi në mënyrë të përgjithshme, pa një përcaktim më të qartë të kategorive të subjekteve apo mënyrës së ndërveprimit, mund të krijojë paqartësi për operatorët ekonomikë në hartimin e ofertës teknike, veçanërisht në lidhje me integrimet e kërkuara dhe kompleksitetin e tyre.

Për rrjedhojë, në funksion të parimit të transparencës dhe sigurimit të një kuptimi tê qartë të kërkesave teknike, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me saktësimin e kësaj pjese të specifikimeve teknike, duke përcaktuar në mënyrë më të qartë kategoritë e subjekteve me të cilat sistemi duhet të ndërveprojë, si dhe natyrën e këtij ndërveprimi, pa kufizuar konkurrencën dhe pa favorizuar subjekte të caktuara.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht në drejtim të nevojës për përditësim dhe saktësim të formulimeve neë specifikimet teknike, por jo në thelb të kerkesave teknike të vendosura, të cilat mbeten të justifikuara dhe proporcionale me objektin e kontratës. Për rrjedhojë, do të kryhen modifikimet përkatëse në DSE, në funksion të qartësisë dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 6
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Kreatx SHPK për kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të Shtojcës nr. 9 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, për arsyet si më poshtë.

Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor, që kërkon disponimin e një numri minimal prej 10 (dhjetë) punonjësish për tre muajt e fundit, i vërtetuar përmes dokumentacionit përkatës (vërtetim nga organet kompetente dhe listëpagesa), është në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i cili parashikon të drejtën e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar prova mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, përfshirë burimet njerëzore.

Në mënyrë konkrete, ky kriter nuk lidhet me të gjithë stafin që do të angazhohet në realizimin e kontratës, por me ekzistencën e një strukture organizative minimale të qëndrueshme të operatorit ekonomik. Kërkesa për 10 punonjës të deklaruar në listëpagesa synon të provojë kapacitetin real dhe funksionimin efektiv të subjektit në treg, duke shmangur situatat e deklarimeve formale apo të përkohshme të stafit vetëm për efekt pjesëmarrjeje neë procedurë.

Autoriteti Kontraktor sqaron se stafi teknik i specializuar që do të angazhohet për realizimin e kontratës nuk është i kufizuar vetëm në këtë strukturë organizative. Një pjesë e stafit teknik mund të jetë pjesë e këtyre 10 punonjësve, ndërsa pjesa tjetër mund të angazhohet në mënyrë të ligishme përmes kontratave të punës apo formave të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi. Për rrjedhojë, kriteri nuk kufizon fleksibilitetin e operatorëve ekonomikë në organizimin e burimeve njerë

Pretendimi i operatorit ekonomik se ky kriter është joproporcional dhe në kundërshtim me nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative nuk qëndron, pasi kërkesa për një strukturë minimale organizative ndjek një qëllim legjitim, konkretisht garantimin e kapaciteteve bazë për realizimin e kontratës dhe stabilitetin e operatorit ekonomik gjatë zbatimit të saj.
Gjithashtu, ky kriter nuk cënon parimin e konkurrencës të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 162/2020, për sa kohë që nuk vendos kufizime të pajustifikuara, por kërkon vetëm një nivel minimal organizativ të arsyeshëm për pjesëmarrje në procedurë.

Sa i përket referencës ndaj praktikës së Komisionit te Prokurimit Publik, theksohet se çdo vendim vlerësohet në raport me rrethanat konkrete të procedurës përkatëse dhe nuk mund të zbatohet automatikisht në çdo rast. Në procedurën objekt shqyrtimi, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se kërkesa për një strukturë minimale prej 10 punonjësish është e justifikuar dhe në përputhje me natyrën e kontratës.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 të Dokumenteve të Tenderit është në përputhje me legjislacionin në fuqi, proporcional dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës. Për rrjedhojë, pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 7
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Kreatx SHPK për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të Shtojcës nr. 9 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor, në funksion të respektimit të parimit të proporcionalitetit dhe nxitjes së konkurrencës, vlerëson se ankesa duhet të pranohet pjesërisht.

Autoriteti Kontraktor, duke marre ne konsideratë nenin 2 dhe nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 11 dhe 12 të Kodit të Procedurave Administrative, çmon se kriteret për stafin teknik duhet të jenë në raport të drejtë me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, duke garantuar njëkohësisht konkurrencën efektive.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontrakten vendos të rishikoje pjesërisht kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të ĐST, si më poshtë:

Kriteri 2.3.3 riformulohet si vijon:

- *Zhvillues softëare: minimumi 2 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë protesionale;*
- *Menaxher projekti IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperienë profesionale;*
- *Specialist databazash: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist infrastrukture IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale.*

Kriteri 2.3.4 riformulohet si vijon:

- *Specialist databazash enterprise/cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist platformash cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale;*
- *Analist biznesi/funksional: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperienë profesionale;*
- *Specialist testimi: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale.*

Sqarim mbi mënyrën e vlerësimit dhe provimit të eksperiencës së stafit teknik.

Në lidhje me pretendimet për paqartësi mbi provimin e eksperiencës profesionale të stafit teknik, Autoriteti Kontraktor sqaron se në Dokumentet e Tenderit është kërkuar paraqitja e CV-ve të stafit të propozuar dhe certifikimeve profesionale përkatëse, si elementë të mjaftueshëm për vlerësimin e këtij kriteri në fazën e ofertimit.

CV-të e stafit përmbajnë të dhëna mbi eksperiencën profesionale, përfshirë periudhat e angazhimit, pozicionet e mbajtura dhe përfshirjen në projekte konkrete, duke mundësuar verifikimin e përmbushjes së kërkesave minimale për eksperiencë sipas DST.

Certifikimet profesionale të kërkuara shërbejnë për të provuar kualifikimin teknik dhe kompetencat profesionale të stafit.

Autoriteti Kontraktor thekson se operatorët ekonomikë paraqesin fillimisht formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni i plotë provues kërkohet vetëm nga ofertuesi i renditur i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti Kontraktor sqaron se:
- kërkesa për stafin teknik nuk nënkupton që çdo rol të mbulohet nga një individ i ndryshëm;
- një punonjës mund të përmbushë më shumë se një kërkesë profesionale;
- stafi teknik mund të sigurohet edhe përmes kontratave të punës.

Sa i përket kriterit 2.3.2, kërkesa për 10 punonjës lidhet me kapacitetin organizativ dhe nuk kërkon që të gjithë të jenë specialistë IT.

Përfundim
Ankesa pranohet pjesërisht dhe DST do të modifikohen sipas sa me sipër, ndërsa pjesa tjetër e pretendimeve rrëzohet si e pabazuar.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 8

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Kreatx SHPK mbi kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të Shtojcës nr. 9 të Dokumenteve të Tenderit, lidhur me kërkesën që certifikatat të jenë të lëshuara nga organizma të akreditуar, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa duhet të pranohet pjesërisht.

Autoriteti Kontraktor, duke marrë në konsideratë nenin 2 dhe nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative, çmon se kriteret kualifikuese duhet të jenë proporcionale dhe të mos kufizojnë në mënyrë të pajustifikuar konkurrencën.

Nga shqyrtimi i Dokumenteve të Tenderit rezulton se në formulimin e kriterit është përdorur shprehja "organizma të akreditуar", ndërkohë që në pjesën e argumentimit është përdorur koncepti "certifikime të njohura ndërkombëtarisht". Kjo mospërputhje krijon paqartësi në interpretim dhe mund të çojë në zbatim kufizues të kriterit.

Në praktikën e industrisë së teknologjisë së informacionit, certifikimet profesionale lëshohen jo vetëm nga organizma të akreditуar në kuptimin formal, por edhe nga subjekte ndërkombëtare të specializuara dhe të njohura gjërësisht në treg, të cilat ofrojnë certifikime të standardizuara dhe të pranuara ndërkombëtarisht.

Gjithashtu, në përputhje me praktikën administrative të Komisionit te Prokurimit Publik, përfshirë vendimin nr. 260/2026, është pranuar se kufizimi vetëm në organizma të akreditуar mund të konsiderohet joproporcional në fushën e TIK.
Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshmë modifikimin e DST, duke harmonizuar formulimin e kriterit si vijon:

"Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizma të akreditуar, shqiptare ose të huaj, ose nga subjekte vendase apo të huaja të njohura ndërkombëtarisht në industrinë e teknologjisë së informacionit, që ofrojnë certifikime profesionale në fushat përkatëe.".
Ky modifikim eliminon paqartësinë ndeërmjet DST dhe argumentimit, garanton proporcionalitetin e kriterit dhe siguron një nivel të mjaftueshëm konkurrence në procedurë.

Në përfundim, Autoritet Kostraktor vlerëson se ankesa duhet të pranohet pjesërisht, duke reflektuar ndryshimin e mësipërm në Dokumentet e Tenderit, ndërsa pjesa tjetër e pretendimeve rrëzohet si e pabazuar.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 9

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik mbi kërkesën për certifikatën ISO 42001:2023 për inteligjencën artificiale, Autoriteti Kontraktor vlereëson se ky pretendim është i pabazuar.

Autoriteti Kontraktor, në zbatim tê nenit 2 dhe nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe në respektim të neneve 11 dhe 12 të Kodit të Procedurave Administrative, ka përcaktuar kriteret kualifikuese në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me natyrën e kontratës.

Në kundërshtim me sa pretendohet nga operatori ekonomik, Autoriteti Kontraktor nuk ka vendosur një kërkesë detyruese dhe përjashtuese vetëm për zotërimin e certifikatës ISO 42001:2023.
Nga permbajtja e Dokumenteve të Tenderit rezulton qartë se operatorët ekonomikë kanë mundësinë të përmbushin këtë kërkesë edhe përmes:

1- standardeve ekuivalente;
2- si dhe dokumentacionit teknik dhe organizativ që provon zbatimin real dhe operacional të masave përkatëse.

Në mënyrë konkrete, DSI parashikojnë që ky dokumentacion mund të përfshijë, pa u kufizuar në:

1. *politika dhe procedura të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave;*

2. *përshkrim teknik të arkitekturës dhe masave të sigurisë së aplikuara;*
3. *dokumentacion që provon implementimin praktik të kontrolleve përkatëse në sistem.*

Në këto kushte, kërkesa për ISO 42001:2023 nuk përbën një kriter përjashtues, por një standard referues, i cili mund të përmbushet edhe përmes mjeteve të tjera ekuivalente.

Sa i përket pretendimit se një certifikim i tillë nuk gjendet në tregun vendas, Autoriteti Kontraktor thekson se legjislacioni i prokurimit publik nuk kufizon vlefshmërinë e mbështeten në kapacitete dhe standarde ndërkombëtare.

Sa i përket referencës ndaj praktikës së Komisionit të Prokurimit Publik, përfshirë vendimin nr. 467/2026, theksohet se ajo lidhet me raste kur kërkesa për certifikime është vendosur në mënyrë të ngurtë dhe pa alternativa, situatë e cila nuk qëndron në rastin konkret.

Në perfundim, pretendimi i operatorit ekonomik rrëzohet si i pabazuar.

…

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 10

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik se kërkesa për demonstrim "live" përbën kriter kualifikimi në kundërshtim me nenin 77 të ligiit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Autoriteti Kontraktor vlereëson se ky pretendim eshtë i pabazuar.

Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, kriteret e kualifikimit lidhen me provimin e kapaciteteve juridike, financiare dhe teknike të operatorëve ekonomikë përmes dokumentacionit përkatës. Në rastin konkret, kriteri 2.3.7 nuk kërkon paraqitjen e asnjë dokumenti për hyrje në procedurë dhe nuk vendos kushte për pjesëmarrje, por zbatohet në fazën e vlerësimit teknik, pas përfundimit të fazës së kualifikimit.

Për rrjedhojë, ky kriter nuk përbën kriter kualifikimi në kuptimin e nenit 77 të ligjit, por një mekanizëm konkret verifikimi të ofertës teknike, në funksion të vlerësimit të saj.

Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 80 te ligjit nr. 162/2020, Autoriteti Kontraktor vlerëson se edhe ky pretendim nuk qëndron. Neni 80 parashikon që autoriteti kontraktor vlerëson ofertat mbi bazën e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe nuk kufizon mjetet që mund të përdoren për verifikimin e tyre vetëm në dokumentacion.

Në këtë kuptim, demonstrimi "live" nuk përbën një fazë të re proceduriale, por një formë konkrete e verifikimit të përmbajtjes së ofertës teknike, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë reale të saj me kërkesat funksionale dhe teknike tee peercaktuara nee DST dhe Termat e Referencees.

Lidhur me pretendimin për cënim të parimit të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 162/2020, konstatohet se kërkesa për demonstrim "live" aplikohet në mënyrë të njëjtë për të giithë operatorët ekonomikëdhe nuk referon teknologji, produkt apo furnizues të caktuar.

Kërkesa që sistemi të jeteë ekzistues dhe funksional lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, e cila ka si objekt implementimin e një sistemi financiar institucional, ku kërkohet stabilitet, besueshmëri dhe aftësi për funksionim real. Në këtë kuptim, kriteri nuk kufizon konkurrencën, por synon të shmangë oferta të natyrës konceptuale apo jo të provuara në praktikë, të cilat mund të rrisin rrezikun e mosrealizimit të kontratës.

Sa i përket pretendimit për shkelje të VKM nr. 285/2021, konkretisht nenit 41, Autoriteti Kontraktor sqaron se kjo dispozitë rregullon dokumentacionin për provimin e kapaciteteve në fazën e kualifikimit. Demonstrimi "live" nuk përbën dokument provues dhe nuk kërkohet për të provar kapacitetin teknik, por për të verifikuar përmbajtjen e ofertës së paraqitur, ndaj nuk bie në kundërshtim me këtë dispozitë.

Gjithashtu, pretendimi për mungesë argumentimi nuk qëndron, pasi nga dokumentacioni i procedurës rezulton qartë se demonstrimi ka për qëllim verifikimin e funksionaliteteve reale të sistemit, shmangien e ofertave teorike dhe garantimin e funksionimit efektiv të zgjidhjes së propozuar, në përputhje me objektin e kontratës.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri 2.3.7 është në përputhje me legislacionin në fuqi, nuk cënon konkurrenceën dhe ishte i domosdoshëm për garantimin e realizimit të suksesshëm të kontratës dhe mbrojtjen e interesit publik.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri 2.3.7 është në përputhje me legislacionin në fuqi, nuk cënon konkurrencën dhe ishte i domosdoshëm për garantimin e realizimit të suksesshëm të kontratës dhe mbrojtien e interesit publik.

Kundërshtimet e përmbledhura të operatorit ekonomik "KREATX" shpk:

Në procesverbalin e argumentimit të DST që AK ka hartuar, kemi konstatuar plot pasaktësi që duhen rregulluar nga AK, duke u fokusuar tek tre më kryesorët si më poshtë:

1. AK nuk ka përcaktuar saktë se për cilën xhiro të tre viteve të fundit bëhet fjalë 2022, 2023, 2024 apo 2023, 2024, 2025. E theksojmë këtë, pasi në procesverbal janë vendosur katër vite për xhiron vjetore,

ndonëse LPP dhe KPP përcaktojnë qartë si kriter kualifikues për kapacitetet ekonomike dhe financiare xhiron e tre viteve të fundit.

2. AK ka përdorur mënyrë të gabuar për përllogaritjen e fondit limit të prokurimit objekt ankimi, duke iu referuar metodës së përllogaritjes së çmimeve të mallrave për kontratë pune publike/mbikëqyrje punimesh/kolaudim punimesh ndërtimore. Kjo metodë nuk vlen për prokurimin objekt ankimi, pasi bëhet fjalë për zhvillimin dhe implementimin e njeë softëare dhe mirëmbajtjen e tij.

3. Në tërësi, AK nuk ka argumentuar bindshëm hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të vendosura në DST.

Në lidhje me pasojën e parashikuar në DST për rastet kur gjatë demonstrimit konstatohet mospërputhje me kërkesat teknike, Autoriteti Kontraktor sqaron se kjo nuk përbën kriter kualifikimi, por rezultat të vlerësimit teknik të ofertës. Në këto raste, konstatohet se oferta teknike nuk përmbush kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe për rrjedhojë nuk mund të vlerësohet pozitivisht.

QËNDRIM I AUTORITETIT KONTRAKTOR

<u>Mbi pretendimet për procesverbalin e argumentimit të DST</u>
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi pasaktësitë e supozuara në procesverbalin e argumentimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit, Autoriteti Kontraktor, pas shqyrtimit të tyre, vlereëson se këto pretendime nuk qëndrojnë në thelb dhe nuk cënojnë ligishmërinë e procedurës.

Lidhur me pretendimin për mungesë qartësie në përcaktimin e xhiros vjetore, sqarohet se referimi për "tre vitet e fundit" është një standard i përcaktuar drejtpërdrejt nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik dhe nuk kërkon interpretim të mëtejshëm nga Autoriteti Kontraktor. Çdo operator ekonomik, në zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 dhe dispozitave përkatëse të akteve nënligjore, i referohet automatikisht tre viteve financiare të fundit të mbyllura në momentin e shpalljes së procedurës. Për rrjedhojë, edhe nëse në procesverbal është përdorur një formulim jo i detajuar, kjo nuk krijon paqartësi reale apo cënim të barazisë në garë.

Në lidhje me pretendimin për metodologjinë e përllogaritjes së fondit limit, Autoriteti Kontraktor thekson se përllogaritja është kryer mbi bazën e analizës së tregut, natyrës së shërbimit dhe komponentëve përbërës të kontratës, të cilët përfshijnë furnizimin me sistem, implementimin dhe mirëmbajtjen. Referencat metodologjike të përdorura ëne procesverbal nuk përbëjnë në vetvete bazë ligjore kufizuese, por shërbejnë si orientim teknik për përllogaritjen, ndërkohë që vlefshmëria e fondit limit lidhet me përputhshmërinë e tij me realitetin e tregut dhe nevojat e Autoritetit Kontraktor, Në këtë kuptim, nuk konstatohet asnjë shkelje e legjislacionit në fuqi.

Sa i takon pretendimit për mungesë argumentimi të specifikimeve teknike dhe kritereve të vendosura, rezulton se këto të fundit janë të lidhura drejpërdrejt me objektin e kontratës dhe synojnë garantimin e realizimit të saj në përputhje me kërkesat funksionale dhe operacionale teë Autoritetit Kontraktor. Për më tepër, një pjesë e kritereve janë rishikuar tashmë në funksion të proporcionalitetit dhe nxitjes së konkurrencës, çka përforcon faktin se Autoriteti Kontraktor ka ushtruar diskrecionin e tij në mënyrë të arsyetuar dhe në përputhje me nenet 11 dhe 12 të Kodit të Procedurave Administrative.

Në lidhje me pretendimin për perdorimin e një strukture të papërshtatshme të DST, Autoriteti Kontraktor vlerëson se objekti i prokurimit nuk ka natyrë të pastër të një kategorie të vetme, por përfshin elementë të furnizimit, implementimit dhe mirëmbajtjes së sistemit, çka justifikon përdorimin e një strukture të kombinuar të dokumenteve të tenderit. Kjo qasje nuk cënon transparencën dhe as nuk krijon pengesa për operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave.

Në përfundim, lidhur me kërkesën për anulimin e procedurës në zbatim të nenit 98, pika 1, shkronja "c" të ligjit nr. 162/2020, Autoriteti Kontraktor vlerëson se nuk ndodhemi përpara kushteve ligjore për aplikimin e kësaj dispozite. Mangësitë e pretenduara nuk janë të natyrës thelbësore dhe nuk e bëjnë të pamundur zhvillimin e procedurës, ndërkohë që konkurrenca nuk rezulton e cënuar.

Për rrjedhojë, pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë dhe nuk përbëjnë shkak për anullim të procedurës.".

II.11. Me shkresën e datës 25.05.2026 "*Prarashtime për ankimin administrativ të datës 11.04.2026 të Kreatx SHPK, për modifikimin dhe sqarimin e DST, si dhe për anullimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje sistem menaxhimi financiar", me REF-80745-04-01-2026*", protokolluar me tonën me nr. 1133/3 prot, datë 28.05.2026, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK parashtrimet e tij lidhur me vendimarrjen e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës të parashtruara në shkresën nr. 1329/19 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "KREATX" SHPK*", përsa i përket pretendimeve të parashtruara nga ankimuesi në ankesën e dorëzuar të sipërpërmendur.

II.12. Në datën 13.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026 e operatorit ekonomik "***DATA LOG***" SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.13. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin,

adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.14. Me shkresën nr. 1329/28 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1133/1 prot, datë 19.05.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe shkresa nr. 1329/20 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "DATA LOG" SHPK*", ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

" ... ***Përgjigija pika 1***

Referuar nenit 4 pika 10 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenit 16 pika3 të VRM nr. 285, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të përdorë sistemin CPV për klasifikimin e objektit të prokurimit, detyrim i cili është përmbushur përmes përcaktimit të kodit përkatës në njoftimin e kontratës. Këto dispozita nuk parashikojnë detyrimin për të përfshirë të gjitha kodet e mundshme që lidhen me çdo element të kontratës, por vetëm identifikimin e objektit të prokurimit përmes një kodi të përshtatshëm.
Në rastin konkret, objekti i prokurimit "Blerje sistem menaxhimi financiar" përbën një zgjidhje të integruar softëare, ndërsa kodi CPV 48000000-8 "Paketa softëare dhe sisteme informacioni" përfaqëson në mënyrë të saktë objektin kryesor të kontratës. Shërbimet e tjera si implementimi, mirëmbajtja dhe asistenca teknike janë në funksion të këtij sistemi dhe nuk përmbajnë objekte të veçanta prokurimi që kërkojnë klasifikim të ndarë.
Operatori ekonomik nuk ka provuar se mënyra e klasifikimit ka sjellë kufizim të konkurrencës, paqartësi në objekt apo diskriminim të operatorëve ekonomikë. Përkundrazi, përdorimi i një kodi të përgjithshëm dhe giithëpërfshirës garanton akses më të gjërë në procedurë.

Për rjedhojë, mungesa e kodeve të tjera të mundshme nuk përbën shkelje ligiore dhe nuk ndikon në vlefshmërinë e procedurës.

...

Përgjigija pika 2

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për heqjen e kriterit të përcaktuar nqë pikën 2.3.2 të Dokumenteve të Tenderit, që kërkon paraqitjen e listëpagesave për 3 muajt e fundit, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim është i pabazuar.

Kriteri i vendosur në pikën 2.3.2 të DST lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të provuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik, konkretisht disponueshmërinë reale të fuqisë punëtore minimale të kërkuar për realizimin e kontratës. Kërkesa për paraqitjen e listëpagesave për një periudhë të kufizuar kohore përbën një mjet verifikimi objektiv dhe të besueshëm për të provuar marrëdhëniet e punës dhe angazhimin aktual të stafit.

Në zbatim të kësaj pike, kriteri zbatohet vetëm për numrin minimal prej 10 punonjësish të kërkuar si pjesë e strukturës organizative dhe nuk nënkupton që i gjithë stafi i nevojshëm për realizimin e kontratës duhet të jetë i punësuar në mënyrë të përhershme. Pjesa tjetër e stafit teknik mund të angazhohet përmes kontratave të punës, duke garantuar fleksibilitet për operatorët ekonomike dhe duke mos kufizuar pjesëmarrjen në procedurë.

Pretendimi se ky kriter është në kundershtim me legjislacionin ne fuqi nuk qëndron, pasi legjislacioni i prokurimit publik i jep autoritetit kontraktor të drejtën të kërkojë dokumentacion që provon kapacitetet teknike dhe profesionale, përfshirë fuqinë punëtore.

Kërkesa për listepagesa për një periudhë 3-mujore është proporcionale dhe e justifikuar, pasi synon të shmanqë deklarimet formale apo të përkohshme të stafit vetëm për efekt të procedurës.

Për rrjedhojë, kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 të DST është në përputhje me legjislacionin në fuqi, proporcional dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës, ndaj pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

...

Përgjigja pika 3

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ju sarojmë se në DST janë keërkuar bilancet për Vitet 2023, 2024 dhe 2025, jo vitet për të cilat ju ankoheni, për kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.2 të Dokumenteve të Tenderit mbi paraqitjen e bilanceve për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim qështe i pabazuar.

Kriteri i vendosur lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik të operatorqëve ekonomikë për realizimin e kontratës dhe është në përputhje me legislacionin në fuqi për prokurimin publik, i cili i jep autoritetit kontraktor të drejtën të kërkojë dokumentacion që provon stabilitetin financiar të operatorit ekonomik.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve për tre vitet e fundit financiare të mbyllura dhe të disponueshme, konkretisht për vitet 2023, 2024 dhe 2025, përbën një praktikë të zakonshme dhe proporcionale, e cila synon të sigurojë një vlerësim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë, në raport me objektin dhe vlerën e kontratës.

***Për qëllime të qartësimit të mëtejshëm dhe në respekt të parimit të transparencës, Autoriteti Kontraktor do të bëjë saktesimin përkatës në dokumentacionin e procedurës, pa ndikuar në përmbatjen thelbësore të kërkesave**.*

…

<u>Përgjigja pika 4</u>

<u>Për sa më sipër ju japim të drejtë, në hartimin e dokumentave të tenderit gabimisht shtojca është etiketuar si shtojca 10, në lidhje me pretendimin tuaj do të bëhen ndryshimet në DST.</u>

...

Përgjigje mbi Ankesën nr. 5 dhe nr. 6

Autorteti Kontraktor, në funksion të proporcionalitetit dhe nxitjes së konkurrencës, rishikon pjesërisht kriteret për stafin teknik si më poshtë:

Kriteri 2.3.3:

- *Zhvillues softëare: minimumi 2 punonjës me ≥3 vite eksperiencë*
- *Menaxher projekti IT: minimumi 1 punonjës me >5 vite eksperiencë*
- *Specialist databazash: minimumi 1 punonjës me ≥5 vite eksperiencë*
- *Specialist infrastrukture IT: minimumi 1 punonjës me ≥5 vite eksperiencë*

Kriteri 2.3.4:
Specialist databazash enterprise/cloud: minimumi 1 punonjës me ≥5 vite eksperiencë.
Specialist platformash cloud: minimumi 1 punonjës me ≥3 vite eksperiencë
Analist biznesi/funksional: minimumi 1 punonjës me ≥3 vite eksperiencë
Specialist testimi: minimumi 1 punonjës me ≥3 vite eksperiencë

II. Sqarim mbi kriterin 2.3.2 (10 punonjeës)

Kërkesa për minimalisht 10 punonjës i referohet kapacitetit të përgithshëm organizativ të operatorit ekonomik. Në këtë numër përfshihen punonjës administrative, financiarë, mbështetës dhe teknikë, dhe nuk kërkohet që të giithë të jenë specialiste IT.

Stafi teknik i specializuar perben vetem nje pjese te ketij numri dhe mund te sigurohet si nga punonjes te brendshëm, ashtu edhe permes kontratave te punes te lidhura per realizimin e kontrates.

Një punonjës mund të përmbushë më shumë se një kërkesë profesionale nëse zotëron disa certifikime ose kualifikime përkatëse.

***Përfundim: Autoriteti Kontraktor kërkon pranimin pjesor të ankesës dhe miratimin e ndryshimeve të mësipërme, ndërsa pjesa tjetër e ankesës të rrëzohet si e pabazuar**.*

...

Përgjigja pika 7

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik mbi kufizimin e zgjidhjes vetëm në arkitekture Cloud, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim është i pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik. Në specifikimet teknike nuk është vendosur një kërkesë për favorizim të një teknologjie të caktuar, por është përcaktuar një arkitekture funksionale dhe operacionale, e cila është e domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës.

Në mënyrë konkrete, sistemi kërkohet të:

- *Jetë i aksesueshëm përmes shfletuesve standarde, pa instalim në pajisjet e përdoruesve (zero footprint);*
- *Ofrojë menaxhim të centralizuar dhe përditësime në kohë reale për të gjithë përdoruesit;*
- *Garantojë disponueshmëri të lartë dhe shkallëzueshmëri dinamike;*
- *Funksionojë në mënyrê të unifikuar për të gjithë përdoruesit e institucionit.*

Këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e sistemit financiar institucional dhe me nevojën për efikasitet operacional, siguri dhe administrim të centralizuar.

Për një sistem financiar institucional me përdorim të shpërndarë, arkitektura e centralizuar është kusht thelbësor për garantimin e integritetit të të dhënave, kontrollit operacional dhe menaxhimit të unifikuar të proceseve.

Zgjidhjet e tipit On-Premise nuk përmbushin në mënyrë të barasvlefshme këto kërkesa, pasi:

- *Kërkojnë instalim dhe mirëmbajtje lokale;*
- *Nuk garantojnë përditësime të menjëhershme dhe të unifikuara;*
- *Nuk sigurojnë në të njëjtin nivel shkallëzueshmëri dhe disponueshmëri;*
- *Rrisin kompleksitetin operacional dhe riskun teknik.*

Për rrjedhojë, kërkesa për arkitekture Cloud nuk përbën kufizim të konkurrencës, por një përcaktim teknik të domosdoshëm për përmbushjen e objektit të kontratës.
Në përputhje me nenin 36 dhe nenin 3 të ligjit nr. 162/2020, specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë proporcionale dhe në funksion të interesit publik, pa synuar favorizimin apo përjashtimin e operatoreve ekonomikë.
***Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron dhe ankesa duhet të rrëzohet**.*

...

Përgjigjja pika 8

Autoriteti Kontraktor nuk e ndan pretendimin e operatorit ekonomik lidhur me mungesën e përcaktimit të numrit të përdoruesve per secilin modul të sistemit.

Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike rezulton se objekti i prokurimit është konceptuar si një zgjidhje e integruar institucionale për menaxhimin financiar, e cila përfshin projektimin, implementimin, konfigurimin, integrimin dhe vënien në funksion të plotë të sistemit, si dhe trajnimin dhe mirëmbajtjen e tij.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në mënyrë të qarëte:

- *Modulet përbërëse të sistemit;*
- *Funksionalitetet e kërkuara për secilin modul;*
- *Kërkesat për performancë, siguri dhe disponueshmëri;*
- *Detyrimet për implementim dhe mirëmbatje.*

Referuar Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 36, specifikimet teknike duhet të përcaktojnë karakteristikat funksionale dhe të performancës së objektit të prokurimit, pa qënë e detyreshme përcaktimi i çdo elementi teknik të detajuar, për sa kohë objektivi dhe rezultati i kërkuar janë të qarta dhe të matshme.

Në rastin konkret, përcaktimi i një numri fiks përdoruesish për çdo modul nuk përbën element thelbësor të objektit të kontratës, pasi:

- *Sistemi nuk është kërkuar si furnizim me licenca të ndara sipas përdoruesve;*
- *Ofertimi nuk është strukturuar mbi bazë "per user", por mbi realizimin e plotë të zgjidhjes;*
- *Përdorimi i sistemit lidhet me nevojat dinamike dhe strukturën organizative të Autoritetit Kontraktor gjatë zbatimit të kontrateës.*

Në këto kushte, kërkesa për përcaktimin paraprak të një numri të saktë përdoruesish nuk është e domosdoshme për formulimin e ofertës dhe nuk ndikon në krahasueshmërinë e saj, për sa kohë operatorëve ekonomikë u kërkohet të ofertojnë për realizimin e plotë të objektit të kontratës.

Për më tepër, në përputhje me nenin 3 të Ligit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Autoriteti Kontraktor ka vepruar në respekt të parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë, duke mos kufizuar mënyrën e ofertimit apo modelin teknik të zgjidhjes.

Për të shmangur çdo paqartësi interpretimi, Autoriteti Kontraktor sqaron se operatorët ekonomike duhet të paraqesin ofertë për një zgjidhje të plotë institucionale (enterprise), e cila garanton përdorimin e sistemit nga të gjithë përdoruesit e autorizuar gjateë periudhës së zbatimit të kontratës, duke përfshire në ofertë të gjitha kostot përkatese.

Ky sqarim nuk përbën ndryshim të specifikimeve teknike, por vetëm një qartësim të mënyrës se ofertimit, pa ndikuar në përmbajtjen e objektit të prokurimit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik se mungesa e numrit të përdoruesve përbën shkelje të nenit 36 të ligjit dhe cënon krahasueshmërinë e ofertave nuk ëendron.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa nr. 8 është e pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

…

Përgjigje ndaj pikave 9 - 14

Në lidhje me pretendiet e operatorit konomik për mungesën e specifiimeve teknike dhe funksionale për modulet e sistemit financiar, Autoriteti Kontraktor sqaron si vijon:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të ligit nr. 162/2020, duke përcaktuar funksionalitetet kryesore dhe objektin e kontratës, pa kufizuar mënyrën e implementimit të zgjidhjes nga operatorët ekonomikë.

Autoriteti Kontraktor ka synuar që përmes këtij formulimi të:

- *Garantojë konkurrencë të hapur;*
- *Shmange kufizime teknike të panevojshme;*
- *Lejojë fleksibilitet në zgjidhjet teknologjike të ofruara.*

Megjithatë, në funksion të rritjes së qartësisë dhe krahasueshmërisë së ofertave, Autoriteti Kontraktor vlerëson se është e arsyeshme të bëjë një saktësim të mëtejshëm të kërkesave funksionale minimale për modulet financiare, pa ndryshuar thelbin e specifikimeve teknike dhe objektin e kontratës.

Ky saktësim:
Nuk përbën ndryshim thelbësor ëte dokumenteve të tenderit;
Nuk cënon parimin e barazisë dhe konkurrencës;
Shërben vetëm për të standardizuar kuptimin e kërkesave dhe për të mundësuar hartimin e ofertave të krahasueshme.
Për rrrjedhojë, pretendimi i operatorit ekonomik merret pjesërisht në konsideratë vetëm në aspektin e nevojës për saktësim, ndërsa kriteret dhe specifikimet teknike në thelb mbeten të vlefshme dhe në përputhje me legislacionin në fuqi.

…

Përgjigje pika nr. 15

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi mungesën e specifikimeve teknike për integrimet me platformat qeveritare (ESB/AKSHI, Tatimet, QKB dhe bankat), Autoriteti Kontraktor, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të procedurës, vlerëson si më poshtë:

Operatori ekonomik pretendon se specifikimet teknike nuk përmbajnë elementë të detajuara si protokollet teknike (REST, SOAP), formatet e të dhënave (XML, JSON) frekuencën e sinkronizimit, SLA-në e integrimit dhe mënyrën e trajtimit të gabimeve, duke e konsideruar këtë si shkelje të nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021.

Në analizë të këtij pretendimi, Autoriteti Kontraktor konstaton se referuar nenit 36, pika 1 dhe 3/a tê ligjit nr. 162/2020, specifikimet teknike duhet të përcaktojnë karakteristikat dhe kërkesat funksionale të objektit të prokurimit në mënyrë të tilleë që operatorët ekonomikë të jenë në gjendje të përgatisin

ofertat e tyre. Në rastin konkret, dokumentet e tenderit përcaktojnë qartë detyrimin për integrimin e sistemit me platformat shtetërore përkatëse, duke identifikuar sistemet me të cilat kërkohet ndërveprimi.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se ligji nuk kërkon detajim në nivel implementimi teknik, siç janë protokollet konkrete, formatet e të dhënave apo parametrat e nivelit të zhvillimit të sistemit.
Përkundrazi, një detajim i tillë do të perbënte kufizim të konkurrencës dhe do të binte në kundërshtim me nenin 36, pika 4 të ligjit nr. 162/2020.
Gjithashtu, referuar nenit 3 të ligjit nr. 162/2020, autoritetet kontraktore duhet të garantojnë trajtim të barabarte dhe mosdiskriminim të operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me natyrën e integrimeve, Autoriteti Kontraktor vlerëson se sistemet e përmëndura funksionojnë mbi standarde teknike të përcaktuara nga vetë institucionet përkatëse. Për këtë arsye, detajimi i parametrave teknikë në këtë fazë është i panevojshëm.

Në aspektin e proporcionalitetit, referuar nenit 77 te ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 41 të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për integrim është në përpjesêtim të drejtë me natyrën e kontratës. Pretendimi se mungesa e këtyre detajeve pengon përgatitjen e ofertave nuk qëndron, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte informacioni.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor arrin në përfundimin se specifikimet teknike janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përfundim, Ankesa nr. 15 konsiderohet e pabazuar.
Autoriteti Kontraktor kërkon nga Komisioni i Prokurimit Publik rrëzimin e kësaj ankese dhe vijimin e procedures pa ndryshime.

…

Përgjigje pika nr. 16

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për "mungesë të specifikimeve teknike për integrimin me subjektet financiare (API pagesash - marrëveshje tripalëshe)", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa është e pabazuar si në aspektin ligior, ashtu edhe në atë teknik.

Operatori ekonomik pretendon se mungojnë elementë të detajuara si standardet API, formatet e mesazheve, mekanizmat e rakordimit, frekuenca e sinkronizimit, trajtimi i gabimeve dhe kërkesat e sigurisë. Megjithatë, nga shqyrtimi i specifikimeve teknike rezulton se është kërkuar qartë

funksionaliteti i integrimit me bankat dhe sistemet financiare, përfshire importin automatik të arketimeve, komunikimin përmes API, rakordimin e faturave dhe ndërveprimin me palë të treta.

Në përputhje me nenin 36 teë ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" specifikimet teknike duhet të përcaktojnë karakteristikat funksionale të shërbimit. Në rastin konkret, këto karakteristika janë të përcaktuara në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar ofertimin nga operatorët ekonomikë.

Pretendimi për mungesë të detajeve teknike nuk qëndron, pasi përcaktimi i standardeve specifike teknologjike si REST, SOAP apo formate të të dhënave do të përbente kufizim të konkurrencës dhe do të binte në kundërshtim me nenin 36, pika 4 të LPP, i cili ndalon specifikimet që favorizojnë teknologii të caktuara.

Integrimet me bankat dhe subjektet financiare janë të natyrës dinamike dhe varen nga infrastruktura e palëve të treta.
Gjithashtu, operatorët ekonomike që operojnë në këtë fushë kanë eksperiencën e nevojshme për të vlerësuar kostot mbi bazë të kërkesave funksionale dhe jo të implementimit teknik të detajuar.

Për sa më sipër, nuk konstatohet shkelje e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 dhe as e VKM nr. 285/2021.
Specifikimet teknike janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe sigurojnë një proces konkurrues dhe transparent.
Në përfundim, Autoriteti Kontraktor nuk e pranon ankesën nr. 16.

…

Përgjigje pika nr. 17

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi komponentin "Asistent Virtual me Inteligiencë Artificiale (AI)"; Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa është e pabazuar si neë aspekytin ligjor ashtu edhe në atë teknik.

Pretendimi se specifikimet teknike nuk përmbajnë elementë të mjaftueshëm nuk qëndron.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit rezulton se komponenti Al është përshkruar qartë në aspektin funksional, duke përfshirë ndërveprimin me përdoruesit përmes zërit dhe kanaleve të komunikimit, mbështetjen shumëgjuhëshe, trajtimin e kërkesave që lidhen me detyrimet financiare, përditësimin me legjislacionin në fuqi, si dhe disponueshmërinë e një paneli analitik për monitorim. Këto elementë përmbushin kërkesat e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, i cili kërkon përcaktimin e karakteristikave funksionale të shërbimit dhe jo detyrimisht specifikimin e teknologjiëse apo algoritmit të përdorur.

Sa i përket pretendimit për mungesë parametrash të matshëm, theksohet se legjislacioni i prokurimit publik nuk kërkon detyrimisht përcaktimin e treguesve numerikë të detajuar për sisteme softëare dhe veçanërisht për komponentë të inteligiencës artificiale në këtë fazë të procedurës. Parametrat e tillë përbëjnë element të ofertës teknike dhe shërbejnë si faktor konkurrues ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke mundësuar zgjedhjen e zgjidhjes më të përshtatshme.

Në lidhje me mungesën e përcaktimit të arkitekturës së zbatimit (Cloud, On-Premise apo hibride), Autoriteti Kontraktor ka vepruar në përputhje me parimin e neutralitetit teknologjik.
Mospërcaktimi i një arkitekture të detyrueshme synon të shmangë kufizimin e konkurrencës dhe favorizimin e teknologjive të caktuara, në përputhje me nenin 36, pika 4 të ligjit nr. 162/2020.

Pretendimi për mungesë argumentimi nuk qëndron, pasi komponenti Al është i lidhur dreitpërdrejt me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, automatizimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit të administratës, duke qënë në përputhje me objektin e kontratës dhe parimin e mirëpërdorimit të fondeve publike.
Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi se komponenti Al është joproporcional me objektin e prokurimit. Ky komponent nuk përbën një sistem të veçuar, por një element funksional të integruar në sistemin e menaxhimit financiar, i cili mundëson komunikimin dhe ndërveprimin efektiv me përdoruesit e sistemit.

Kërkesa për heqjen e këtij komponenti dhe zhvillimin e një procedure të veçantë për të përbën ndërhyrje të pajustifikuar në diskrecionin e Autoritetit Kontraktor për përcaktimin e nevojave dhe strukturës së zgjidhjes teknologjike, pa u mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore.

Megjithate, me qëllim rritjen e qartësisë dhe transparencës së dokumenteve të tenderit, Autoriteti Kontraktor do teë reflektojë një saktësim të mëtejshëm në specifikimet teknike, duke peërcaktuar më qartë kërkesat minimale funksionale dhe operacionale për këtë komponent, pa ndryshuar natyrën dhe objektin e kontratës.

Në përfundim, konstatohet se specifikimet teknike për komponentin "Asistent Virtual Al" janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk kufizojnë konkurrencën dhe janë proporcionalisht të lidhura me objektin e kontratës.

Për sa me sipër, kërkohet rrëzimi i plotë i Ankesës nr. 17 si e pabazuar.

…

Përgjigje pika nr. 18

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi kriterin 2.3.7, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa është e pabazuar si në aspektin ligjor, ashtu edhe në atë faktik.

Pretendimi se kërkesa për demonstrim "live" përbën kriter kualifikimi në kundërshtim me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 nuk qëndron. Referuar këtij neni, kriteret e kualifikimit lidhen me provimin e kapaciteteve juridike, financiare dhe teknike përmes dokumentacionit përkateës.

Në rastin konkret, kriteri 2.3.7 nuk kërkon paraqitjen e asnjë dokumenti apo prove për hyrje në garë dhe nuk vendos kushte për pjesëmarrje, por zbatohet në fazën e vlerësimit teknik, pas kualifikimit të operatorëve ekonomikë. Për rrjedhojë, ai nuk përbën kriter kualifikimi në kuptimin e nenit 77, por një mekanizëm verifikimi të ofertës teknike.

Po ashtu, pretendimi për shkelje të nenit 80 të ligjit, në kuptimin e shtimit të një faze të re proceduriale, nuk qëndron. Neni 80 i LPP parashikon që autoriteti kontraktor vlerëson ofertat mbi bazën e përmbushjes se kërkesave të përcaktuara dhe nuk kufizon mjetet e verifikimit vetëm në dokumentacion. Demonstrimi "live" nuk përbën fazë të re të procedurës, por një formë konkrete e verifikimit të përmbajtjes së oferteës, me qëllim evidentimin e përputhshmërisë reale të saj me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe termave të referencës.

Lidhur me pretendimin për cënim të parimit të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë, sipas, nenit 3 të LPP, konstatohet se kriteri në fjalë aplikohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomike dhe nuk referon teknologji, produkt apo furnizues të caktuar.

Kërkesa që sistemi të jetë ekzistues dhe funksional lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me implementimin e një sistemi financiar institucional, ku kërkohet stabilitet, besueshmëri dhe funksionim i menjëhershëm. Neë këtë kuptim, kriteri nuk kufizon konkurrencën, por synon të përjashtojë zgjidhje të paimplementuara apo thjesht konceptuale, të cilat do të rrisnin ndjeshëm rrezikun e mosrealizimit të kontratës.

Sa i përket pretendimit për shkelje të VKM nr. 285/2021, konkretisht nenit 41, ky interpretim është i pasaktë, pasi kjo dispozitë rregullon dokumentet për provimin e kapaciteteve në fazën e kualifikimit. Demonstrimi "live" nuk përbën dokument provues dhe nuk kërkohet për të provuar aftësinë teknike, por për të verifikuar përmbajtjen e ofertës së paraqitur, ndaj nuk bie në kundërshtim me këtë dispozitë.
Gjithashtu, pretendimi për mungesë argumentimi bie poshtë nga vetë dokumentacioni i procedurës, ku është përcaktuar qartë se demonstrimi synon verifikimin e funksionaliteteve reale, shmangien e ofertave teorike dhe garantimin e funksionimit efektiv të sistemit. Ky arsyetim është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe përmbush kërkesat e proporcionalitetit.

Në lidhje me faktin që në DST parashikohet se mosplotësimi i kërkeave gjatë demonstrimit çon në mosvlerësimin e ofertës, Autoriteti Kontraktor sqaron se kjo nuk përbën kriter kualifikimi, por pasojë të vlerësimit teknik. Mosplotësimi gjatë demonstrimit përbën evidencë se oferta teknike nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe termat e referencës, dhe për këtë arsye nuk mund të vlerësohet pozitivisht në fazën teknike.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri 2.3.7 është në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk cënon konkurrencën dhe është i domosdoshëm për garantimin e realizimit të suksesshëm të kontratës dhe mbrojtjen e interesit publik.

Për sa më sipër, kërkohet nga Komisioni i Prokurimit Publik rrëzimi i ankesës nr. 18 si e pabazuar.".

II.15. Me shkresën e datës 25.05.2026 "*Prapësime*", protokolluar me tonën me nr. 1134/3 prot, datë 25.05.2026, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK parashtrimet e tij lidhur me vendimarrjen e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës të parashtruara në shkresën nr. 1329/28 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "DATA LOG" SHPK*", përsa i përket pretendimeve të parashtruara nga ankimuesi në ankesën e dorëzuar të sipërpërmendur.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën nr.5, si në vijim: "*Në këto kushte, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor të specifikojë qartë përgjegjësinë për sigurimin e infrastrukturës cloud ...*", lidhur me pretendimet e parashtruara nga operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK në kërkesën nr. 8, si në vijim: "*8. Përdorimi i inteligjencës artificiale lidhet drejtpërdrejt me kosto operative shtesë, si tarifa për përdorimin e API-ve, konsum token-ësh apo nevoja për infrastrukturë të dedikuar në rastet e zhvillimeve më të avancuara. Në dokumentacionin e tenderit nuk është përcaktuar qartë se kush do të mbulojë këto kosto, në çfarë mase dhe brenda cilave kufij.*
Për rrjedhojë, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor të sqarojë në mënyrë të detajuar përgjegjësinë për mbulimin e këtyre shpenzimeve, si dhe të përcaktojë limite të qarta mbi përdorimin (p.sh. token apo

volum shërbimi), në rast se këto do të përballohen nga operatori ekonomik. Në të kundërt, kjo kërkesë krijon paqartësi, barrë financiare të paparashikuar dhe cenon parimin e barazisë në konkurrim.", si dhe lidhur me me pretendimet e parashtruara nga operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK në kërkesën nr. 9, si në vijim: "*9. Ne lidhje me piken "Baze te dhenash per pagesat qe replikon me bazen e sistemit te taksave [Pagesa Online]", në Termat e Referencës, kërkojmë informacion dhe qartësi se cfare payment gateëay do mund te integrohet?*
Ku konsiston kjo pikë dhe si duhet të funksionojë në raport me sistemin e taksave dhe tarifave vendor? Kërkojmë të paraqiten detaje me specifike.", të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*", protokolluar me tonën me nr. 1128/1 prot, datë 19.05.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

"***… Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 5***
(Paqartësi mbi infrastrukturën cloud dhe integrimet)
Në funksion të qartësimit të mënyrës së ofertimit dhe zbatimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor sqaron se:

4. *Infrastruktura cloud do të sigurohet nga operatori ekonomik, i cili duhet të përfshijë në ofertë të giitha kostot dhe elementet teknike të nevojshëm për funksionimin e sistemit;*

...
Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 8

(Përdorimi i inteligjencës artificiale dhe kostot operative)
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit Dokumentet e Tenderit nuk përcaktojnë qartë mbulimin e kostove operative që lidhen me përdorimin e komponenteve të inteligjencës artificiale (si tarifa API, konsum token-ësh apo infrastrukturqe e dedikuar), Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim nuk përbën shkelje të legislacionit në fuqi.

Autoriteti Kontraktor thekson se komponenti i inteligjenceës artificiale i parashikuar në Termat e Referencës nuk përbën një modul të veçantë apo një sistem të pavarur, por një funksionalitet ndihmës në formën një asistenti virtual (chatbot), i cili ka për qëllim ofrimin e informacionit për përdoruesit në kohe reale.

Në këte kuptim, ky komponent nuk përfaqëson një sistem të plotë të inteligjencës artificiale me ndikim të drejtpërdrejtë në procese vendimmarrëse, por një element mbështetës të sistemit, me rol informues dhe orientues.

Sa i përket kostove operative të lidhura me këtë funksionalitet, Autoriteti Kontraktor sqaron se: çdo zgjidhje teknike e propozuar nga operatori ekonomik, përfshirë edhe përdorimin e shërbimeve të inteligjencës artificiale, përbën pjesë integrale të ofertës së tij, kostot që lidhen me implementimin dhe funksionimin e këtij komponenti (përfshire tarifa API apo shërbime të ngjashme) duhet të parashikohen nga operatori ekonomik në ofertën e tij financiare, Autoriteti Kontraktor nuk parashikon mbulim të veçantë për këto kosto jashtë kontrateës së përgjithshme.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo qasje është në përputhje me natyreën e kontratës si një zgjidhje e integruar dhe nuk cënon parimin e barazisë në konkurrim, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte dhe janë të lirë të propozojnë mënyrën e implementimit të këtij funksionaliteti

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 9

(Pagesat online dhe integrimi me sistemin e taksave)

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilave mungon qarteësia mbi mënyrën e realizimit të pagesave online, përfshirë llojin e "payment gateëay" që do të integrohet dhe funksionimin e tij në raport me sistemin e taksave dhe tarifave vendore, Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto pretendime nuk përbëjne shkelje të legjislacionit në fuqi, por kërkojnë sqarim në funksion të përgatitjes së ofertes.

Autoriteti Kontraktor sqaron se funksionaliteti i pagesave online ka për qëllim mundësimin e kryerjes së pagesave nga qytetarët në mënyrë elektronike, nëpërmjet integrimit të sistemit me njeë ose me shumë shërbime të pagesave të autorizuara.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor thekson se:

1- Nuk është parashikuar kufizim ndaj një "payment gateëay" të caktuar, por operatorët ekonomikë janë të lirë të propozojnë zgjidhje teknike të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fugi dhe standardet e sigurisë së pagesave.

2- Integrimi duhet të mundësojë lidhjen funksionale ndërmjet sistemit të taksave dhe tarifave vendore dhe platformës së pagesave, duke garantuar rregjistrimin automatic dhe të saktë të pagesave të kryera.

3- Sistemi duhet të sigurojeë gjurmueshmëri, saktësi dhe përditësim në kohe reale të të dhënave të pagesave në bazën përkatëse;

4- Mënyra konkrete e implementimit teknik, përfshirë zgjedhjen e ofruesit të shërbimit të pagesave, mbetet në diskrecionin e operatorit ekonomik, i cili duhet të garantojë përputhshmëri me kërkesat funksionale të përcaktuara në Termat e Referencës.

Sa i përket kërkesave për integrimin e VKB-ve dhe legjislacionit përkatës fiskal, Autoriteti Kontraktor sqaron se ky funksionalitet konsiston në mundësimin e përditësimit dhe reflektimit në sistem të ndryshimeve ligiore dhe nënligiore që lidhen me administrimin e taksave dhe tarifave vendore, përfshirë:

5. *Ndryshimet ne legjislacionin fiskal;*
6. *Vendimet e Këshillit të Ministrave;*
7. *Vendimet e Këshillit Bashkiak;*
8. *Paketën fiskale vendore.*

Ky funksionalitet synon të sigurojë që sistemi të jetë i përditësuar dhe në përputhje me kuadrin ligior në fuqi, pa imponuar një metodologji specifike teknike për realizimin e tij.
Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto elementë janë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave dhe nuk cënojnë parimin e barazisë në konkurrim, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte.".

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: "*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.*
Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.
Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.".

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se :

"*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*
a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:
i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.
2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.".

III.1.4. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të sipërpërmendura të operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, në thelb lidhet me kërkesat për sqarim lidhur me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar në SPE.
Gjithashtu, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik si më sipër cituam, rezulton, se e ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues lidhur me pretendimet e tij për specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Përkatësisht si në vijim: "***… Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 5***
(Paqartësi mbi infrastrukturën cloud dhe integrimet)
Në funksion të qartësimit të mënyrës së ofertimit dhe zbatimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor sqaron se:

5. *Infrastruktura cloud do të sigurohet nga operatori ekonomik, i cili duhet të përfshijë në ofertë të giitha kostot dhe elementet teknike të nevojshëm për funksionimin e sistemit;*

...
Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 8

(Përdorimi i inteligjenceës artificiale dhe kostot operative)
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilit Dokumentet e Tenderit nuk përcaktojnë qartë mbulimin e kostove operative që lidhen me pqerdorimin e komponenteve të inteligjencqes artificiale (si tarifa API, konsum token-ësh apo infrastrukturqe e dedikuar), Autoriteti Kontraktor vlerqeson se ky pretendim nuk pqerbën shkelje tqe legislacionit nqe fuqi.

Autoriteti Kontraktor thekson se komponenti i inteligjenceës artificiale i parashikuar në Termat e Referencqes nuk përbën një modul të veçantë apo një sistem të pavarur, por një funksionalitet ndihmës në formën një asistenti virtual (chatbot), i cili ka për qëllim ofrimin e informacionit për përdoruesit në kohe reale.

Në këte kuptim, ky komponent nuk përfaqëson një sistem të plotë të inteligjencës artificiale me ndikim të drejtpërdrejtë në procese vendimmarrëse, por një element mbështetës të sistemit, me rol informues dhe orientues.

Sa i përket kostove operative të lidhura me këtë funksionalitet, Autoriteti Kontraktor sqaron se: çdo zgjidhje teknike e propozuar nga operatori ekonomik, përfshirë edhe përdorimin e shërbimeve të inteligjencës artificiale, përbën pjesë integrale të ofertës së tij, kostot që lidhen me implementimin dhe funksionimin e këtij komponenti (përfshire tarifa API apo shërbime të ngjashme) duhet të parashikohen nga operatori ekonomik në ofertën e tij financiare, Autoriteti Kontraktor nuk parashikon mbulim të veçantë për këto kosto jashtë kontrateës së përgjithshme.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo qasje është në përputhje me natyreën e kontratës si një zgjidhje e integruar dhe nuk cënon parimin e barazisë në konkurrim, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte dhe janë të lirë të propozojnë mënyrën e implementimit të këtij funksionaliteti

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 9

(Pagesat online dhe integrimi me sistemin e taksave)

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation, sipas të cilave mungon qarteësia mbi mënyrën e realizimit të pagesave online, përfshirë llojin e "payment gateëay" që do të integrohet dhe funksionimin e tij në raport me sistemin e taksave dhe tarifave vendore, Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto pretendime nuk përbëjne shkelje të legjislacionit në fuqi, por kërkojnë sqarim në funksion të përgatitjes së ofertes.

Autoriteti Kontraktor sqaron se funksionaliteti i pagesave online ka për qëllim mundësimin e kryerjes së pagesave nga qytetarët në mënyrë elektronike, nëpërmjet integrimit të sistemit me njeë ose me shumë shërbime të pagesave të autorizuara.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor thekson se:

1- Nuk është parashikuar kufizim ndaj një "payment gateëay" të caktuar, por operatorët ekonomikë janë të lirë të propozojnë zgjidhje teknike të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fugi dhe standardet e sigurisë së pagesave.

2- Integrimi duhet të mundësojë lidhjen funksionale ndërmjet sistemit të taksave dhe tarifave vendore dhe platformës së pagesave, duke garantuar rregjistrimin automatic dhe të saktë të pagesave të kryera.
3- Sistemi duhet të sigurojeë gjurmueshmëri, saktësi dhe përditësim në kohe reale të të dhënave të pagesave në bazën përkatëse;
4- Mënyra konkrete e implementimit teknik, përfshirë zgjedhjen e ofruesit të shërbimit të pagesave, mbetet në diskrecionin e operatorit ekonomik, i cili duhet të garantojë përputhshmëri me kërkesat funksionale të përcaktuara në Termat e Referencës.

Sa i përket kërkesave për integrimin e VKB-ve dhe legjislacionit përkatës fiskal, Autoriteti Kontraktor sqaron se ky funksionalitet konsiston në mundësimin e përditësimit dhe reflektimit në sistem të ndryshimeve ligiore dhe nënligiore që lidhen me administrimin e taksave dhe tarifave vendore, përfshirë:

9. *Ndryshimet ne legjislacionin fiskal;*
10. *Vendimet e Këshillit të Ministrave;*
11. *Vendimet e Këshillit Bashkiak;*
12. *Paketën fiskale vendore.*

Ky funksionalitet synon të sigurojë që sistemi të jetë i përditësuar dhe në përputhje me kuadrin ligior në fuqi, pa imponuar një metodologji specifike teknike për realizimin e tij.
Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto elementë janë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertave dhe nuk cënojnë parimin e barazisë në konkurrim, pasi të gjithë operatorët ekonomikë ndodhen në të njëjtat kushte.", duke sqaruar operatorin ekonomik ankimues lidhur me pretendimet e tij të sipërpërmendura.
Duke qenë, se pretendimet e mësipërme i operatorit ekonomik ankimues janë sqaruar nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*", protokolluar me tonën me nr. 1128/1 prot, datë 19.05.2026, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, pasi gjykon, se vendimi i dhënë nga KSHA është shterues dhe sqarues për operatorin ekonomik ankimues për këto pretendime të tij dhe për më tepër me sqarimet e dhëna nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka më objekt ankese.
Autoriteti në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar të publikojë shtojcën me sqarimet e dhëna, me qëllim që si operatori ekonomik ankimues dhe të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto sqarime.
Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*Idealdevs Corporation*" SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.4**, si në vijim: "*Së katërti: Edhe pse AK ka përdorur DST për mallra, ndërkohë që prokurimi lidhet me shërbime, shtojca nr.2 "Lista e çmimeve për njësi", shtojca nr.3 të DST "Lista e çmimeve të artikujve" dhe shtojca nr.7 të DST "Grafiku i ekzekutimit", nuk janë plotësuar nga AK me sasinë dhe llojin e mallrave dhe afatet e lëvrimit, duke lënë OE ofertues të paqartë në këtë drejtim.*
Për rrjedhojë, AK duhet të modifikojë DST, me qëllim plotësimin e këtyre shtojcave sipas nevojave të prokuruara, duke ja bërë të ditur OE të interesuar për ofertim", lidhur me pretendimet e parashtruara nga operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK në kërkesën **nr. 5**, si në vijim: "*Së pesti: Në shtojcën nr.6 të DST, ku renditen specifikimet teknike, AK shprehet se "Niveli i sigurisë është i mesëm (M) pasi disponueshmëria dhe integriteti i të dhënave tatimore kërkojnë nivelin D2 dhe I2 për të garantuar shërbim të pandërprerë për qytetarët. Operatori Ekonomik duhet të zbatoje rregulloret e sigurisë të miratuara nga AKCESK ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.".*
Në lidhje me këtë përcaktim, vlen të sjellim në vëmendje të AK dhe KPP se me miratimin e ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", janë miratuar rregulla të reja për sigurinë kibernetike. Pjesë e këtyre rregullave janë edhe masat teknike, organizative dhe operacionale të miratuara me VKM nr.531/2025. Po kështu, miratimi i ligjit të ri e suprimoi Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike së bashku me rregullat e miratuara prej tij, duke i zëvendësuar ato me një institucion të ri siç është Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe akte të reja nënligjore për sigurinë e sistemeve. Për pasojë, AK duhet të modifikojë specifikimet teknike të DST në përputhje me kuadrin e ri legjislativ dhe institucional për sigurinë kibernetike.
Po në specifikimet teknike të sistemit në shtojcën nr.6 të DST, AK shprehet se, "Sistemi duhet të ndërveprojë me institucionet dhe platformat e mëposhtme: AKSHI: Për shkëmbimin e të dhënave me regjistrat shtetërorë. Sistemi i Tatimeve dhe (QKR): Për marrjen e të dhënave të bizneseve në nivel NIPT-i. Subjekte Financiare: Për importin automatik të arkëtimeve ditore dhe rakordimin e faturave nepermjet komunikimeve API te pagesave nepermjet marreveshjes 3 paleshe.". Vlen të theksohet se, subjektet financiare nuk përbëjnë as institucion dhe as platformë, siç shprehet AK. Për pasojë, nevojitet që të modifikohen DST dhe të sqarohet më mirë në specifikimet teknike të sistemit, se me cilat subjekte tregtare do të ndërveprojë sistemi. Pra, me çdo subjekt tregtar, privat apo bankë të nivelit të dytë apo me me vetëm një kategori të tyre. Kjo duhet të jetë e qartë në DST, pasi i përgatit OE ofertues që të paraqesin një ofertë teknike të plotë dhe në përputhje me DST", si dhe lidhur me pretendimet e parashtruara nga operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK në kërkesën **nr. 7**, si në vijim: "*Kreatx SHPK vëren se kërkimi i një stafi të certifikuar prej 11 punonjësish si kriter kualifikues nga çdo OE ofertues dhe me përvojë të paharmonizuar e të çrregullt (5, 6, 7, 8 dhe 10 vjet përvojë), për një kontratë që synon vetëm blerjen e një sistemi të menaxhimit financiar, është totalisht joproporcional dhe bie në kundërshtim flagrant me LPP, RRPP dhe me nenet 11 dhe 12 të KPA. Ky vlerësim i Kreatx SHPK argumentohet me pikat e mëposhtme:*

1. AK nuk ka zbatuar rekomandimin nr.787, datë 23.01.2026 të APP, "Mbi hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë dhe shërbime", që udhëzon AK të harmonizojë

numrin e punonjësve me numrin e personelit të certifikuar, kur përdorin si kriter për të shpallur fituese ofertën ekonomikisht më të favorshme. Në rastin objekt ankimi administrativ, AK ka përcaktuar në pikën 2.3.2 të shtojcës nr.9 të DST si kriter kualifikues fuqinë prej 10 punonjësish, ndërkohë që në pikën 2.3.3 të të njëjtës shtojcë kërkon një personel të certifikuar prej 11 punonjësish. Pra, ka një mungesë harmonizimi mes numrit të punonjësve dhe personelit të certifikuar që u kërkohet ofertuesve dhe në zbatim të rekomandimit të APP ky numër duhet të harmonizohet në mënyrë të barabartë, duke modifikuar DST.

2. Numri i personelit të certifikuar prej 11 punonjësish nuk është proporcional në raport me objektin dhe vlerën e kontratës së prokurimit publik. Ky numër nuk është i justifikuar apo i argumentuar nga AK as në procesverbalin bashkëlidhur DST. Për të mos rënë në përsëritje, për proporcionalitetin në raport me numrin e punonjësve të certifikuar vlen i njëjti argument si në pjesën e gjashtë të këtij ankimi administrativ.

Përcaktimi si kriter kualifikues i një personeli të certifikuar prej 11 punonjësish nuk justifikohet as nga objekti i prokurimit e as nga fondi limit i kontratës së prokurimit publik. Me këtë prokurim publik AK synon që të blejë një program financiar si mall, që nuk kërkon shërbimin e zhvillimit të tij nga e para. Sakaq, një staf i certifikuar prej 11 punonjësish nuk mund të jetë kurrsesi proporcional në këtë rast.

Po ashtu, fondi limit prej 25 000 000 Lekë pa TVSH nuk justifikon këtë kërkesë kaq të lartë për staf të certifikuar. Praktika administrative e prokurimit publik në institucione qendrore si AKSHI, OBP apo KLGJ, ku prokurohen kontrata me fond limit shumëfish më të lartë sesa kjo objekt ankimi, kanë pasur si kriter kualifikues një staf të certifikuar deri në 15 punonjës. Pra, kërkesa prej 11 vetësh është joproporcionale dhe duhet ulur nga AK, duke modifikuar DST.

3. Kriteri i posaçëm kualifikues për të zotëruar minimumi 3 (tre) punonjës të certifikuar në zhvillimin e zgjidhjeve informatike dhe minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrimin dhe/ose implementimin e sistemeve të menaxhimit të bazave të të dhënave është e tepruar, joproporcionale dhe e paargumentuar nga AK. Nuk ka arsye bindëse që AK t`i nevojiten tre punonjës të certfikuar për zgjidhjet informatike dhe dy punonjës të certifikuar për administrimin dhe implementimin e sistemeve të menaxhimit të bazave, ndërkohë që vetëm ekzistenca e njërit prej tyre siguron përmbushjen e kontratës së së mallrave me sukses. Meqenëse vendosja e këtyre kritereve kualifikuese është joproporcionale, AK duhet të modifikojë DST, duke ulur numrin e punonjësve të pajisr me këto certifikime.

4. Kriteri kualifikues i përvojave që kërkohen për secilin prej punonjësve të certifikuar pranë OE, duke nisur me minimumi 5 vjet, e duke vijuar me 6 vjet, 7 vjet dhe përfunduar me 10 vjet për menaxherin e projektit, është krejtësisht joproporcionale dhe e paargumentuar nga AK. Këto kritere janë totalisht diskriminuese, në kundërshtim me nenin 2 të LPP, duke pasur si synim kufizimin e pjesëmarrjes në tender të shumicës së OE. Shkelja e parimit të proporcionalitetit dhe diskriminimit thellohet më tej edhe nga fakti se, përvoja e mësipërme shërben vetëm për të kualifikuar ofertën e OE si të vlefshme, por nuk i garanton atij asnjë lloj pike në ofertim, pasi përfitimi i tyre bëhet mbi bazën e formulës së përcaktuar nga AK me përvojë shtesë mbi kriterin kualifikues.

Kështu, për të marrë pikët maksimale sipas formulës duhen së paku 2, 5 apo mbi 5 vite përvojë shtesë mbi kriterin kualifikues për secilin prej punonjësve të certifikuar. Në këtë mënyrë, për efekt të përfitimit të pikëve, automatikisht përvoja e stafit të certifikuar shkon në 10 vite, 12 vite, 13 vite dhe 15 vite, situatë kjo në kundërshtim flagrant me parimin e proporcionalitetit.
I bëjmë me dije AK dhe KPP se, disponimi i 11 punonjësve të certifikuar sipas kërkesave të AK dhe me përvojën e caktuar prej tyre në DST, ka një kosto aq të lartë për OE ofertues saqë tejkalon edhe vlerën e kontratës publike që po prokurohet. Për këtë mund të merret në analogji buxheti i AKSHI dhe AKSK si struktura të specializuara në çështjet informatike, ku për një vit e gjysmë sa zgjat edhe kontrata me AK, buxheti i stafit është i konsiderueshëm. Në këtë drejtim, AK duhet të modifikojë DST dhe të ulë kërkesat e viteve të përvojës për stafin e certifikuar që u kërkon OE ofertues.
5. Për kriterin e veçantë kualifikues, sa i takon disponimit të një punonjësi të certifikuar për analizën e biznesit dhe/ose analizën funksionale të sistemeve softëare, ka gabime në DST, pasi në numra AK ka vendosur 6 vite përvojë, ndërsa me shkrimin në kllapa tetë vite përvojë profesionale. Për rrjedhojë, AK duhet të modifikojë DST edhe në këtë drejtim.
6. Kriteri kualifikues i përvojave që kërkohet për 11 punonjësit e certifikuar pranë OE, në vite të ndryshme me 5 vjet, 6 vjet, 7 vjet, 8 vjet dhe 10 vjet, është i paharmonizuar në mënyrë të barabartë. Kjo situatë komplekson mënyrën e përllogaritjes së pikëve për ofertuesit, sipas formulës së përcaktuar për nënkriterin e stafit profesional. AK nuk justifikon në asnjë moment as në DST dhe as në procesverbalin e argumentimit se përse janë përcaktuar vite të ndryshme për përvojën e punonjësve të certifikuar. Kompleksimi i procedurave të pikëzimit për shkak të veprimeve të gabuara të AK, ul nivelin e transparencës, duke u bërë shkak për cenimin e parimit të ushtrimit të diskrecionit të ligjshëm nga AK. Pra, në funksion të parimit të transparencës, AK duhet të modifikojë DST, duke barazuar përvojën e kërkuar për të gjithë stafin e certifikuar që u kërkon OE ofertues.
Së fundi, në DST mungon shënimi që një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim. Mungesa e këtij shënimi në DST kufizon tej mase konkurencën në këtë prokurim publik, pasi janë të pakët OE ofertues që disponojnë punonjës të certfikuar prej 11 personash siç e kërkon AK. Vendosja e një shënimi të tillë u mundëson OE që të marrin pjesë në prokurim dhe siguron parimin e konkurencës në tender. Po ashtu, shënimi e bën prokurimin publik të AK në përputhje me të gjithë praktikën administrative të prokurimeve publike TIK në vend, pasi autoritete të tjera kontraktore si AKSHI, OBP, KLGJ dhe PP, i publikojnë DST me këtë shënim. Për rrjedhojë, AK duhet të modifikojë DST duke shtuar shënimin e përmendur më sipër.", të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Me shkresën nr. 1329/30 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1133/1 prot, datë 19.05.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe shkresa nr. 1329/19 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "KREATX"*

SHPK“, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*KREATX*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

“*…Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 4*
Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik mbi mosplotësimin e shtojcave nr. 2, nr. 3 dhe nr. 7 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

Nga shgyrtimi i DST rezulton se objekti i procedurës është konceptuar si "blerje sistemi për menaxhim financiar", i cili në thelb përbën një zgjidhje të integruar softëare, e cila përfshin zhvillim, implementim, konfigurim, integrim dhe mirëmbajtje. Në këtë kuptim, edhe pse në Njoftimin e Kontratës është klasifikuar si kontrate për mallra, përmbajtja e specifikimeve teknike dhe mënyra e realizimit të kontratës tregojnë se kemi të bëjmë me një kontratë me natyrë mbizotërues.

Në këtë kontekst, mungesa e plotësimit të shtojcave nr.2 dhe nr.3, të cilat lidhen me lista të detajuara të artikujve dhe çmimeve për njësi, nuk ka ardhur si pasojë e një mospërmbushjeje formale, por si reflektim i natyrës së kontratës, e cila nuk përbehet nga artikuj të standardizuar dhe të matshëm në njësi fizike, por nga një zgjidhje softëare e integruar që ofrohet si paketë funksionale.
Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo mënyrë formulimi krijon paqartësi për operatorët ekonomikë në lidhje me strukturën e ofertës ekonomike dhe elementët që duhet të përfshihen në të. Në veçanti, mungesa e një ndarjeje të qartë të komponentëve të ofertës (implementim, licencim, integrim, mirëmbajtje) mund të ndikojë në mënyrën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Po kështu, sa i takon shtojcës nr.7 "Grafiku i ekzekutimit" konstatohet se edhe pse në specifikimet teknike janë parashikuar fazat e realizimit të projektit dhe afatet përkatëse (implementim brenda 6 muajve dhe mirëmbajtje 12 muaj), këto nuk janë reflektuar në mënyrë të strukturuar dhe të formalizuar në shtojcën përkatëse, duke krijuar mungesë koherence brenda dokumentacionit të tenderit.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht në drejtim të nevojës për qartësim dhe plotësim të dokumentacionit, me qëllim garantimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, duke reflektuar në mënyrë të qarte strukturën e ofertës ekonomike përmes një ndarjeje funksionale të komponentëve të zgjidhjes, si dhe duke plotësuar shtojcat përkatëse me elementët orientues të nevojshëm për ofertim, pa ndryshuar thelbin e objektit të prokurimit.

...

Përgjigie mbi ankesën e pikës Nr. 5
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi përmbajtjen e specifikimeve teknike në shtojcën nr.6 të DST, Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

Sa i përket referimit të bërë në DST lidhur me nivelin e sigurisë së sistemit dhe detyrimin për zbatimin e rregulloreve të miratuara nga ish Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky formulim është bërë në përputhje me kuadrin rregullator ekzistues në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit dhe synon të garantojë standarde të larta të sigurisë për të dhënat fiskale dhe funksionimin e sistemit.

Megjithatë, duke marrë në konsiderate hyrjen ne fuqi të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", si dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, përfshirë VKM nr. 531/2025, Autoriteti Kontraktor pranon se referimi ndaj strukturës institucionale dhe rregulloreve të mëparshme kërkon përditësim, me qëllim harmonizimin e plotë të dokumentacionit të tenderit me kuadrin e ri ligjor dhe institucional në fuqi.

Në këtë kuptim, edhe pse kërkesa për respektimin e standardeve të sigurisë mbetet e vlefshme në thelb dhe nuk cënon konkurrencën, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme të modifikojë formulimin ëperkatës në DST, duke iu referuar kuadrit aktual ligjor dhe autoritetit kompetent për sigurinë kibernetike, me qëllim shmangien e çdo paqartësie për operatorët ekonomikë.

Sa i përket pretendimit mbi formulimin e ndërveprimit të sistemit me "subjekte financiare", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky formulim synon të përfshijë në mënyrë të përgjithshme subjektet që operojnë në fushën e pagesave dhe arkëtimeve, përfshirë bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera financiare të licencuara që mund të ofrojnë shërbime pagesash.
Megjithatë, Autoriteti Kontraktor pranon se përdorimi i këtij termi në mënyrë të përgjithshme, pa një përcaktim më të qartë të kategorive të subjekteve apo mënyrës së ndërveprimit, mund të krijojë paqartësi për operatorët ekonomikë në hartimin e ofertës teknike, veçanërisht në lidhje me integrimet e kërkuara dhe kompleksitetin e tyre.

Për rrjedhojë, në funksion të parimit të transparencës dhe sigurimit të një kuptimi tê qartë të kërkesave teknike, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me saktësimin e kësaj pjese të specifikimeve teknike, duke përcaktuar në mënyrë më të qartë kategoritë e subjekteve me të cilat sistemi duhet të ndërveprojë, si dhe natyrën e këtij ndërveprimi, pa kufizuar konkurrencën dhe pa favorizuar subjekte të caktuara.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht në drejtim të nevojës për përditësim dhe saktësim të formulimeve neë specifikimet teknike, por jo në thelb të kerkesave teknike të vendosura, të cilat mbeten të justifikuara dhe proporcionale me

objektin e kontratës. Për rrjedhojë, do të kryhen modifikimet përkatëse në DSE, në funksion të qartësisë dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi.

...

Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 7
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Kreatx SHPK për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të Shtojcës nr. 9 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor, në funksion të respektimit të parimit të proporcionalitetit dhe nxitjes së konkurrencës, vlerëson se ankesa duhet të pranohet pjesërisht.

Autoriteti Kontraktor, duke marre ne konsideratë nenin 2 dhe nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 11 dhe 12 të Kodit të Procedurave Administrative, çmon se kriteret për stafin teknik duhet të jenë në raport të drejtë me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, duke garantuar njëkohësisht konkurrencën efektive.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontrakten vendos të rishikoje pjesërisht kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të ĐST, si më poshtë:

Kriteri 2.3.3 riformulohet si vijon:
- *Zhvillues softëare: minimumi 2 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë protesionale;*
- *Menaxher projekti IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperienë profesionale;*
- *Specialist databazash: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist infrastrukture IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale.*

Kriteri 2.3.4 riformulohet si vijon:
- *Specialist databazash enterprise/cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist platformash cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale;*
- *Analist biznesi/funksional: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperienë profesionale;*
- *Specialist testimi: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale.*

Sqarim mbi mënyrën e vlerësimit dhe provimit të eksperiencës së stafit teknik.

Në lidhje me pretendimet për paqartësi mbi provimin e eksperiencës profesionale të stafit teknik, Autoriteti Kontraktor sqaron se në Dokumentet e Tenderit është kërkuar paraqitja e CV-ve të stafit të

propozuar dhe certifikimeve profesionale përkatëse, si elementë të mjaftueshëm për vlerësimin e këtij kriteri në fazën e ofertimit.

CV-të e stafit përmbajnë të dhëna mbi eksperiencën profesionale, përfshirë periudhat e angazhimit, pozicionet e mbajtura dhe përfshirjen në projekte konkrete, duke mundësuar verifikimin e përmbushjes së kërkesave minimale për eksperiencë sipas DST.

Certifikimet profesionale të kërkuara shërbejnë për të provuar kualifikimin teknik dhe kompetencat profesionale të stafit.
Autoriteti Kontraktor thekson se operatorët ekonomikë paraqesin fillimisht formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni i plotë provues kërkohet vetëm nga ofertuesi i renditur i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti Kontraktor sqaron se:
- kërkesa për stafin teknik nuk nënkupton që çdo rol të mbulohet nga një individ i ndryshëm;
- një punonjës mund të përmbushë më shumë se një kërkesë profesionale;
- stafi teknik mund të sigurohet edhe përmes kontratave të punës.

Sa i përket kriterit 2.3.2, kërkesa për 10 punonjës lidhet me kapacitetin organizativ dhe nuk kërkon që të gjithë të jenë specialistë IT.".

III.2.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: "*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.*
Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.
Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.".

III.2.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se :

"*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*
a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.
2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.".

III.2.4. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të sipërpërmendura të operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, në thelb lidhet me kërkesat për modifikimin e Shtojcës 2 "*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE*", Shtojcës 3 "*LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE*" dhe Shtojcës 7 "*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*" të dokumentave tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, lidhur me kërkesën për sqarim për specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar në SPE, si dhe lidhet me kërkesën për modifikimin e kritereve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe në pikën 2.3.4 "*Kapaciteti teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar në SPE.
Gjithashtu, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik si më sipër cituam, rezulton, se e ka pranuar kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin Shtojcës 2 "*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE*", Shtojcës 3 "*LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE*" dhe Shtojcës 7 "*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*" të dokumentave tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues lidhur me pretendimet e tij për specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe ka pranuar kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kritereve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe në pikën 2.3.4 "*Kapaciteti teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përkatësisht si në vijim: **"***...Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 4*

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik mbi mosplotësimin e shtojcave nr. 2, nr. 3 dhe nr. 7 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

Nga shgyrtimi i DST rezulton se objekti i procedurës është konceptuar si "blerje sistemi për menaxhim financiar", i cili në thelb përbën një zgjidhje të integruar softëare, e cila përfshin zhvillim, implementim, konfigurim, integrim dhe mirëmbajtje. Në këtë kuptim, edhe pse në Njoftimin e Kontratës është klasifikuar si kontrate për mallra, përmbajtja e specifikimeve teknike dhe mënyra e realizimit të kontratës tregojnë se kemi të bëjmë me një kontratë me natyrë mbizotërues.

Në këtë kontekst, mungesa e plotësimit të shtojcave nr.2 dhe nr.3, të cilat lidhen me lista të detajuara të artikujve dhe çmimeve për njësi, nuk ka ardhur si pasojë e një mospërmbushjeje formale, por si reflektim i natyrës së kontratës, e cila nuk përbehet nga artikuj të standardizuar dhe të matshëm në njësi fizike, por nga një zgjidhje softëare e integruar që ofrohet si paketë funksionale.
Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo mënyrë formulimi krijon paqartësi për operatorët ekonomikë në lidhje me strukturën e ofertës ekonomike dhe elementët që duhet të përfshihen në të. Në veçanti, mungesa e një ndarjeje të qartë të komponentëve të ofertës (implementim, licencim, integrim, mirëmbajtje) mund të ndikojë në mënyrën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Po kështu, sa i takon shtojcës nr.7 "Grafiku i ekzekutimit" konstatohet se edhe pse në specifikimet teknike janë parashikuar fazat e realizimit të projektit dhe afatet përkatëse (implementim brenda 6 muajve dhe mirëmbajtje 12 muaj), këto nuk janë reflektuar në mënyrë të strukturuar dhe të formalizuar në shtojcën përkatëse, duke krijuar mungesë koherence brenda dokumentacionit të tenderit.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht në drejtim të nevojës për qartësim dhe plotësim të dokumentacionit, me qëllim garantimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, duke reflektuar në mënyrë të qarte strukturën e ofertës ekonomike përmes një ndarjeje funksionale të komponentëve të zgjidhjes, si dhe duke plotësuar shtojcat përkatëse me elementët orientues të nevojshëm për ofertim, pa ndryshuar thelbin e objektit të prokurimit.

...

Përgjigie mbi ankesën e pikës Nr. 5
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi përmbajtjen e specifikimeve teknike në shtojcën nr.6 të DST, Autoriteti Kontraktor vlerëson si më poshtë:

Sa i përket referimit të bërë në DST lidhur me nivelin e sigurisë së sistemit dhe detyrimin për zbatimin e rregulloreve të miratuara nga ish Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky formulim është bërë në përputhje me kuadrin rregullator ekzistues në momentin e hartimit të dokumenteve të tenderit dhe synon të garantojë standarde të larta të sigurisë për të dhënat fiskale dhe funksionimin e sistemit.

Megjithatë, duke marrë në konsiderate hyrjen ne fuqi të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", si dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, përfshirë VKM nr. 531/2025, Autoriteti Kontraktor pranon se referimi ndaj strukturës institucionale dhe rregulloreve të mëparshme kërkon përditësim, me qëllim harmonizimin e plotë të dokumentacionit të tenderit me kuadrin e ri ligjor dhe institucional në fuqi.

Në këtë kuptim, edhe pse kërkesa për respektimin e standardeve të sigurisë mbetet e vlefshme në thelb dhe nuk cënon konkurrencën, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme të modifikojë formulimin ëperkatës në DST, duke iu referuar kuadrit aktual ligjor dhe autoritetit kompetent për sigurinë kibernetike, me qëllim shmangien e çdo paqartësie për operatorët ekonomikë.

Sa i përket pretendimit mbi formulimin e ndërveprimit të sistemit me "subjekte financiare", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky formulim synon të përfshijë në mënyrë të përgjithshme subjektet që operojnë në fushën e pagesave dhe arkëtimeve, përfshirë bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera financiare të licencuara që mund të ofrojnë shërbime pagesash.
Megjithatë, Autoriteti Kontraktor pranon se përdorimi i këtij termi në mënyrë të përgjithshme, pa një përcaktim më të qartë të kategorive të subjekteve apo mënyrës së ndërveprimit, mund të krijojë paqartësi për operatorët ekonomikë në hartimin e ofertës teknike, veçanërisht në lidhje me integrimet e kërkuara dhe kompleksitetin e tyre.

Për rrjedhojë, në funksion të parimit të transparencës dhe sigurimit të një kuptimi tê qartë të kërkesave teknike, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me saktësimin e kësaj pjese të specifikimeve teknike, duke përcaktuar në mënyrë më të qartë kategoritë e subjekteve me të cilat sistemi duhet të ndërveprojë, si dhe natyrën e këtij ndërveprimi, pa kufizuar konkurrencën dhe pa favorizuar subjekte të caktuara.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht në drejtim të nevojës për përditësim dhe saktësim të formulimeve neë specifikimet teknike, por jo në thelb të kerkesave teknike të vendosura, të cilat mbeten të justifikuara dhe proporcionale me objektin e kontratës. Për rrjedhojë, do të kryhen modifikimet përkatëse në DSE, në funksion të qartësisë dhe përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi.
Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 7
Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Kreatx SHPK për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të Shtojcës nr. 9 të Dokumenteve të Tenderit, Autoriteti Kontraktor, në funksion të respektimit

të parimit të proporcionalitetit dhe nxitjes së konkurrencës, vlerëson se ankesa duhet të pranohet pjesërisht.

Autoriteti Kontraktor, duke marre ne konsideratë nenin 2 dhe nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 11 dhe 12 të Kodit të Procedurave Administrative, çmon se kriteret për stafin teknik duhet të jenë në raport të drejtë me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, duke garantuar njëkohësisht konkurrencën efektive.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontrakten vendos të rishikoje pjesërisht kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të ĐST, si më poshtë:

Kriteri 2.3.3 riformulohet si vijon:

- *Zhvillues softëare: minimumi 2 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë protesionale;*
- *Menaxher projekti IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperienë profesionale;*
- *Specialist databazash: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist infrastrukture IT: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale.*

Kriteri 2.3.4 riformulohet si vijon:

- *Specialist databazash enterprise/cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 5 vite eksperiencë profesionale;*
- *Specialist platformash cloud: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale;*
- *Analist biznesi/funksional: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperienë profesionale;*
- *Specialist testimi: minimumi 1 punonjës me jo më pak se 3 vite eksperiencë profesionale.*

Sqarim mbi mënyrën e vlerësimit dhe provimit të eksperiencës së stafit teknik.

Në lidhje me pretendimet për paqartësi mbi provimin e eksperiencës profesionale të stafit teknik, Autoriteti Kontraktor sqaron se në Dokumentet e Tenderit është kërkuar paraqitja e CV-ve të stafit të propozuar dhe certifikimeve profesionale përkatëse, si elementë të mjaftueshëm për vlerësimin e këtij kriteri në fazën e ofertimit.

CV-të e stafit përmbajnë të dhëna mbi eksperiencën profesionale, përfshirë periudhat e angazhimit, pozicionet e mbajtura dhe përfshirjen në projekte konkrete, duke mundësuar verifikimin e përmbushjes së kërkesave minimale për eksperiencë sipas DST.

Certifikimet profesionale të kërkuara shërbejnë për të provuar kualifikimin teknik dhe kompetencat profesionale të stafit.
Autoriteti Kontraktor thekson se operatorët ekonomikë paraqesin fillimisht formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni i plotë provues kërkohet vetëm nga ofertuesi i renditur i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti Kontraktor sqaron se:
- kërkesa për stafin teknik nuk nënkupton që çdo rol të mbulohet nga një individ i ndryshëm;
- një punonjës mund të përmbushë më shumë se një kërkesë profesionale;
- stafi teknik mund të sigurohet edhe përmes kontratave të punës.

Sa i përket kriterit 2.3.2, kërkesa për 10 punonjës lidhet me kapacitetin organizativ dhe nuk kërkon që të gjithë të jenë specialistë IT.””, duke pranuar pretendimet e ankimuesit për modifikimin e Shtojcës 2 “*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE*”, Shtojcës 3 “*LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE*” dhe Shtojcës 7 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumentave tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues lidhur me pretendimet e tij për specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe ka pranuar kërkesën e ankimueit për modifikimin e kritereve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe në pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.
Duke qenë, se pretendimet e mësipërme i operatorit ekonomik ankimues janë pranuar dhe janë sqaruar nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 1329/19 prot, datë 12.05.2026 “*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik “KREATX” SHPK*“, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, pasi gjykon, se vendimi i dhënë nga KSHA është shterues dhe sqarues për operatorin ekonomik ankimues për këto pretendime të tij dhe për më tepër modifikimet dhe sqarimet e dhëna nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka më objekt ankese.
Autoriteti në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar të publikojë shtojcën për modifikimet dhe sqarimet e dhëna, me qëllim që si operatori ekonomik ankimues dhe të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto modifikime dhe sqarime.
Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*KREATX*” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën nr. 3, si në vijim*: Kërkesa 3.1*
Kërkohet të ndryshohet argumentimi i kritereve në përputhje me bazën ligjore aktuale në fuqi pasi fakti që këto kritere bazohen mbi legjislacion të shfuqizuar i bën ato të pavlefshme për tu zbatuar." dhe në kërkesën nr.4, si në vijim: "*Kërkesa 4.1*
Kërkohet ndryshimi i argumentimit të kritereve, duke qartësuar në mënyrë të saktë dhe përfundimtare nëse formulari i vetëdeklarimit përbën Shtojcën 9 apo Shtojcen 10, si dhe reflektimi i këtij saktësimi në të gjithë dokumentet e tenderit.", të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Me shkresën nr. 1329/28 prot, datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1133/1 prot, datë 19.05.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe shkresa nr. 1329/20 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "DATA LOG" SHPK*", ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimuesit, si më poshtë vijon:

"*... Përgjigja pika 3*

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ju sarojmë se në DST janë keërkuar bilancet për Vitet 2023, 2024 dhe 2025, jo vitet për të cilat ju ankoheni, për kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.2 të Dokumenteve të Tenderit mbi paraqitjen e bilanceve për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim qështe i pabazuar.

Kriteri i vendosur lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të provuar kapacitetin financiar dhe ekonomik të operatorqëve ekonomikë për realizimin e kontratës dhe është në përputhje me legislacionin në fuqi për prokurimin publik, i cili i jep autoritetit kontraktor të drejtën të kërkojë dokumentacion që provon stabilitetin financiar të operatorit ekonomik.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve për tre vitet e fundit financiare të mbyllura dhe të disponueshme, konkretisht për vitet 2023, 2024 dhe 2025, përbën një praktikë të zakonshme dhe proporcionale, e cila synon të sigurojë një vlerësim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë, në raport me objektin dhe vlerën e kontratës.

Për qëllime të qartësimit të mëtejshëm dhe në respekt të parimit të transparencës, Autoriteti Kontraktor do të bëjë saktesimin përkatës në dokumentacionin e procedurës, pa ndikuar në përmbatjen thelbësore të kërkesave.

Përgjigja pika 4

Për sa më sipër ju japim të drejtë, në hartimin e dokumentave të tenderit gabimisht shtojca është etiketuar si shtojca 10, në lidhje me pretendimin tuaj do të bëhen ndryshimet në DST.".

III.3.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: "*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.*
Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.
Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.".

III.3.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se :

"*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*
a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:
i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.
2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji,

Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës "ç" të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.".

III.3.4. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të sipërpërmendura të operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, në thelb lidhet me kërkesën për ndryshimin e procesverbalit të argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike përsa i përket bazës ligjore të përdorur për argumentimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikë 2.2.2 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit dhe për saktësimin e numri të Shtojcës "*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*" të dokumentave tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të publikuar në SPE.

Gjithashtu, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik si më sipër cituam, rezulton, se e ka pranuar kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për ndryshimin e procesverbalit të argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike përsa i përket bazës ligjore të përdorur për argumentimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikë 2.2.2 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit duke pranuar që të bëjë ndryshimet sipas pretendimit të ankimuesit përkatësisht si në vijim: "*Për qëllime të qartësimit të mëtejshëm dhe në respekt të parimit të transparencës, Autoriteti Kontraktor do të bëjë saktesimin përkatës në dokumentacionin e procedurës, pa ndikuar në përmbatjen thelbësore të kërkesave*." dhe për përcaktimin e numrit të Shtojcës "*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*" të dokumentave tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi si dhe modifikimin e kritereve kualifikuese të përcaktuara në Shtojcën 8 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke përcaktuar numrin e saktë të Shtojcës "*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*" në këto dokumenta tenderit, përkatësisht si në vijim: **"***...Përgjigja pika 4*
Për sa më sipër ju japim të drejtë, në hartimin e dokumentave të tenderit gabimisht shtojca është etiketuar si shtojca 10, në lidhje me pretendimin tuaj do të bëhen ndryshimet në DST.", duke pranuar pretendimet e ankimuesit për për saktësimin e numri të Shtojcës "*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*" të dokumentave tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Duke qenë, se pretendimet e mësipërme i operatorit ekonomik ankimues janë pranuar nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 1329/20 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "DATA LOG" SHPK*", KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, pasi gjykon, se vendimi i dhënë nga KSHA është shterues dhe sqarues për operatorin ekonomik ankimues për këto pretendime të tij dhe për më tepër modifikimet e bëra nga ana e autoritetit kontraktor nuk ka më objekt ankese.

Autoriteti në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar të publikojë shtojcën për modifikimet, me qëllim që si operatori ekonomik ankimues dhe të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto modifikime dhe sqarime.
Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*DATA LOG*" SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.1**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.6**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6521, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1132/2026 prot., datë 14.04.2026, lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.6**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026, si dhe lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.2** të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në pikë 2.3.2 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

"*2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e sherbimit objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) punonjes <u>për tre muaj e fundit</u>, e vertetuar kjo me:*
a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj,
b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kerkuar
Shënim: Kriteri 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.".

III.4.2. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."
Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.4.3. Neni 21 pika 1 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" i ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj*.".

III.4.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e

profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.".

III.4.5. Në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet se:

"*5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.".

III.4.6. Në procesverbalin e argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar:

"**Argumentim:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, si dhe specifikimet teknike. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*".

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Duke marrë shkas nga pretendimet e mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimues dhe konkretisht të ankimuesit "***Idealdevs Corporation***" SHPK, i cili kërkon *"....Për sa më sipër, kërkojmë modifikimin e kërkesës për pjesën që i referohet listëpagesave për 3-muajt e fundit të kriterit 2.3.2, si më poshtë vijon:*

- Listepagesën e sigurimeve shoqerore (formularët E-sig025) per punonjësit e mesipërm për muajin e fundit.....", të ankimuesit "***Smart ICT Services***" SHPK, i cili kërkon *"....1. Të modifikojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2, duke hequr kërkesën për paraqitjen e listëpagesave për 3 muajt e fundit si kusht të detyrueshëm për provimin e fuqisë punëtore.*

2. Në mënyrë alternative, nëse autoriteti kontraktor çmon të nevojshme mbajtjen e kësaj forme prove, ta reduktojë atë në paraqitjen e listëpagesës së muajit të fundit nga data e dorëzimit të ofertës, si një kërkesë më proporcionale dhe më e lidhur me provimin aktual të disponueshmërisë së stafit. .", të ankimuesit "***KREATX***" SHPK i cili kërkon: "*Kreatx SHPK vëren se vendosja e një numri prej 10 punonjësish si kriter kualifikues për çdo OE ofertues, për një kontratë që synon vetëm blerjen e një sistemi të menaxhimit financiar, pa pasur si qëllim shërbimin e implementimit të tij, është joproporcional dhe bie ndesh me LPP, RRPP dhe me nenin 12 të KPA.*

Numri prej 10 punonjësish që duhet të ketë çdo OE ofertues është joproporcional pasi:

1. Nuk përligjet nga asnjë qëllim legjitim i AK (Neni 12 i KPA);

2. Nuk parashikohet kurrkund në ligj dhe aktet nënligjore (Neni 12 i KPA);

3. Kufizon pjesëmarrjen në tender për çdo OE në përpjesëtim të zhdrejtë me nevojën që ka autoriteti kontraktor për prokurimin, pasi në momentin që sistemi është i ngritur dhe do të blihet nuk ka nevojë për kaq shumë punonjës. Po ashtu, kufizon edhe numrin e OE ofertues për AK dhe nuk justifikon as ndonjë interes publik (Neni 12 i KPA).

4. Cenon të drejtën e OE ofertues që të marrin pjesë në tender (Neni 2 i LPP dhe neni 12 i KPA).

5. Përbën shkelje të LPP dhe RRPP dhe praktikës administrative të KPP, duke mos kaluar testin e proporcionalitetit, për sa kohë që me vendimin nr.115/2026, për prokurimin me REF-65151-10-15-2025, me objekt "Sistem i informatizuar i menaxhimit, monitorimit dhe kontrollit të parkimit me pagesë", me fond limit 20,833,333 (Njëzet milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lekë) pa TVSH, KPP ka urdhëruar AK që të ulë numrin e punonjësve kur prokuron blerjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit.", si dhe të ankimuesit "*DATA LOG*" SHPK, i cili kërkon si në vijim: *"Kërkesa 2.1*

Kërkojmë heqjen e ketij kriteri pasi diskriminon OE dhe kufizon konkurrencën, gjithashtu nuk është proporcional me procedurën aktuale, mbështetur në vendimin nr.785/2025 datë 17.06.2025.”, Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar në pikën pikë 2.3.2 “*Kapacitetit teknik*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi lidhur me vërtetimin e administratës tatimore dhe të listëpagesave të punonjësve për periudhën 3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur, është një kërkesë e ekzagjeruar në këtë procedurë prokurimi. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre, çka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit të operatorëve ekonomikë lidhet me praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës, që duhet t’i shërbejë autoritetit kontraktor si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që punonjësit për kryerjen e shërbimit të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore apo vërtetim nga administrata tatimore, ku për çdo muaj të specifikohet numri i punonjësve për një periudhë prej 3 muajsh të fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur, pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore. Komisioni gjykon, se e rëndësishme është, që operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave, të kenë në dispozicion stafin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, i cili do të përbënte garanci, se kontrata që do të lidhet si rezultat i procedurës së prokurimit do të realizohej në kohë dhe me sukses. Kriteri sa më sipër, që punonjësit për kryerjen e shërbimit të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën 3 muajt e fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur, nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës dhe është tërësisht i panevojshëm. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional, operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente të provojnë, se disponojnë numrin e kërkuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar, por kurrsesi të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojë një numër të tillë punonjësish për periudhën prej 3 muajsh të fundit nga njoftimi i kontratës së shpallur si dhe punonjësit të figurojnë në listëpagesa për të gjithë periudhën e specifikuar më sipër.

Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*KREATX*” SHPK për uljen e numrit të punonjëve në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për numrin e punonjësve prej minimalisht 10 (dhjetë) punonjës është një kërkesë e ekzagjeruar dhe nuk i shërben qëllimit për përmbushjen me sukses të kontratës. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor pavarësisht se ky i fundit ka argumentuar se ndër të tjera një numër i tillë punonjësish i nevojitet për shkak të kompleksitetit të procedurës, KPP gjykon, se referuar tipologjisë së kontratës, komponentëve të saj, si dhe certifikimeve të kërkuara, kërkesa për numrin e punonjësve si më sipër nuk është në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kritereve kualifikuese, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat

mbi përcaktimin e kritereve për kualifikim, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik nuk e gjykon të drejtë numrin e punonjësve të kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik dhe autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri duke ulur numrin e punonjësve, pasi ky numër nuk është në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, si dhe nuk i shërben qëllimit për realizimin në kohë dhe cilësi të kontratës. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, por ato duhet të mos jenë diskriminuese e përjashtuese. Në këtë mënyrë, KKP e gjen të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për uljen e numrit të punonjësve. Autoriteti kontraktor të rishikojë kriterin e veçantë të kualifikimit të pikës 2.3.2 të kritereve të veçanta të kualifikimit.

Sa më lart, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikë 2.3.2 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar, me periudhën kohore të kërkimit të vërtetimit të numrit të punonjësve dhe listëpagesave të tyre, pasi siç është argumentuar më lart e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave të vërtetohet numri i punonjësve në përmbushje të kapacitetit profesional, ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK, si në vijim: *"....1. Të modifikojë kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2, duke hequr kërkesën për paraqitjen e listëpagesave për 3 muajt e fundit si kusht të detyrueshëm për provimin e fuqisë punëtore.*", Komisioni gjykon se nuk qëndron, pasi referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, disponimi i fuqisë punëtore nga na a eoperatorëve ekonomikë ofertues është i nevojshëm për ealizimin e objektit të kontratës dhe konkretisht të zhvillimit të Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore te Bashkise Himarë dhe mirëmbajtjes së këtij sistemi.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues

"*DATA LOG*" SHPK qëndrojnë, ndërsa pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK qëndrojnë pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.2** dhe kërkesën **nr.3**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.8**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026, si dhe lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.5** të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në pikë 2.3.3, pikën 2.3.4 dhe pikën 2.3.6 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

"*2.3.3 Për të garantuar implementimin, realizimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit si dhe suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:*

a) Minimumi 3 (tre) punonjës ,secili me minimumi 7 (shtate) vite pervoje profesionale ne zhvillimin e zgjidhjeve informatike.
Për përmbushjen e këtij kriteri, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë të paktën një certifikim profesional për secilin punonjës, të lëshuar nga institucione të njohura ndërkombëtarisht, që vërtetojnë aftësi në zhvillim dhe programim softëare, si p.sh.:
– certifikime në zhvillim aplikacionesh, platforma softëare, ose gjuhë programimi,
– ose certifikime ekuivalente, të barasvlefshme për nga niveli dhe përmbajtja.
b) Minimumi 1 (një) punonjës menaxher te projekteve IT. (Minimumi 10 (dhjete) vite pervoje profesionale ne)
Kjo kerkese permbushet permes certifikimeve profesionale te njohura nderkombetarisht ne fushen e menaxhimit te projekteve (p.sh PMP, PRINCE2, Scrum Master), ose certifikime ekuivalente.
c) Minimumi 2 (dy) punonjës, me profil në administrimin dhe/ose implementimin e sistemeve të menaxhimit të bazave të të dhënave. (Minimumi 8 (tetë) vite përvojë profesionale)
Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale në fushën e databazave, të lëshuara nga organizata ose institucione përkatëse, ose certifikimeve ekuivalente.
d) Minimumi 1 (një) punonjës me profil administrimin e sistemeve operative dhe infrastrukturës IT. (Minimumi 8 (tetë) vite përvojë profesionale)

Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale të njohura ndërkombëtarisht ose certifikimeve ekuivalente.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist në administrimin e databazave enterprise në mjedise cloud, (Minimum 8 (tetë) vite përvojë profesionale në administrimin, konfigurimin, sigurimin dhe optimizimin e performancës së databazave të përdorura për sisteme kritike institucionale.)
Specialisti duhet të ketë certifikime profesionale të vlefshme në teknologji databazash enterprise (p.sh. Oracle, MS SQL Server, PostgreSQL Enterprise ose ekuivalente) dhe të demonstrojë përvojë në auditimin e sigurisë dhe menaxhimin operacional të databazave.
e) Minimumi 1 (një) punonjës me profil në përdorimin dhe/ose administrimin e platformave cloud. (Minimumi 5 (pesë) vite përvojë profesionale)
Certifikimi duhet të jetë i lëshuar nga ofrues të njohur ndërkombëtarisht të shërbimeve cloud (publike ose private), ose certifikim tjetër ekuivalent
f) Minimumi 1 (një) punonjës me profil në analizën e biznesit dhe/ose analizën funksionale të sistemeve softëare. (Minimumi 6 (tetë) vite përvojë profesionale)
Kjo kërkesë vërtetohet përmes certifikimeve profesionale përkatëse ose përmes përvojës së dokumentuar në projekte të ngjashme.
g) Minimumi 1 (një) punonjës me profil në testimin e sistemeve informatike. (Minimumi 5 (pesë) vite përvojë profesionale, për realizimin e testimeve funksionale dhe teknike)
Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale në fushën e testimit softëare ose certifikimeve ekuivalente.
Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit
Te gjitha certifikimet e siperpermendura duhet te jene aktive ne daten e ofertimit.
**Shënim 1: Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizma te akredituar, shqiptar ose te huaj.*
Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:
-Çertifikata për specialistët e kërkuar, te dhena nga organizma te akredituar, shqiptar ose te huaj.
-Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (çertifikimin, diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.
-Listëpagesat sipas formularit e –Sig 25 për tre muajt e fundit sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër ose te paraqiten kontrata pune me punonjes qe disponojne certifikimet e kerkuara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 5 vjet pervoje ne fushen e teknologjise se informacionit.

Kjo duhet te vertetohet me:

- *Ekstrakti Historik i Regjistrit Tregtar te Operatorit Ekonomik leshuar nga QKR*
- *Profili (CV) i Operatorit Ekonomik*".

III.5.2. Në pikën 4.4 "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*Procedura*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin e vlerësimit, si më poshtë vijon:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) ***Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X***

Sipas rëndësisë:

1. ***Çmimi*** ***pikët 50***
2. ***Eksperienca e ngjashme e kompanisë*** ***pikët 10***
3. ***Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit*** ***pikët 10***
4. ***Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar*** ***piket 30***

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi ***[0-50] pikë***

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1}/O_{k1}$

P_{k1} *Pikët e kriterit që vlerësohet*

V_{mink1} *Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet*

P_{maxk1} *Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet*

O_{k1} *Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet*

Shënim: Oferta duhet të hartohet në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.5.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit.

2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë ***[0 - 10 pikë]***

Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të shërbimit të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/kontratat e ngjashme të kryera përtej minimumit të kërkuar

garantojnë AK që me qëndrueshmërinë në treg, eksperiencën e stafit teknik dhe të vetë organizatës të fituar si dhe kapacitetin e lartë teknik kontraktori mbikqyrës nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së punimeve
Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë kontrata me vlerën më të lartë për objekte të ngjashëm përtej minimumit të percaktuar në kriterin e kualifikimit pika 2.3.1/a, Shtojca 8 dhe që janë realizuar në periudhën kohore brenda tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
*Ofertuesi me vlerën e kontratës së **objektit** të ngjashëm në vlerë absolute më të madhe do ti akordohen pikët maksimale të nën-kriterit dhe ofertuesit e tjerë të kualifikuar (minimalisht sa eshte percaktuar ne piken 2.3.1/a), Shtojca 8) do ti akordohen pikët sipas metodologjisë/formulës më poshtë:*
Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$P_{kn} = V_{maxkn} \times P_{maxkn} / O_{kn}$

P_{kn} *Pikët e kriterit që vlerësohet*
V_{maxkn} *Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e objektit të ngjashëm)*
P_{maxkn} *Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet*
O_{kn} *Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet*

Për të plotësuar këtë kërkesë ofertuesit mjaftojnë të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.1/a.

3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit [0–10 pikë]

Përqasja teknike dhe metodologjia
Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjetjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave te

Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.
Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

Elementi i vlerësimit	*Përshkrimi*	*Pikët*
Kuptimi i detyrës	*Qartësia në interpretimin e objektit të kontratës*	*0 – 3 pikë*
Organizimi i punës	*Planifikimi, fazat dhe menaxhimi i aktivitetit*	*0 – 3 pikë*
Metodat teknike	*Mjetet dhe teknikat e propozuara*	*0 – 2 pikë*
Menaxhimi i riskut	*Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve të mundshme*	*0 – 2 pikë*

4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar [0–30 pikë]

Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

- *Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.*

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar
4.1 Drejtuesi i projektit – 15 pikë

Përshkrimi	*Pikët*
Eksperiencë + 3 vite (mbi kriterin minimal)	*5 pikë*
Eksperiencë + 3–5 vite (mbi kriterin minimal)	*10 pikë*
Eksperiencë + 5 vite (mbi kriterin minimal)	*15 pikë*

4.2 Stafi teknik kryesor –15 pikë
Vlerësohet për çdo specialist sipas eksperiencës:

Përshkrimi	*Pikët*
Eksperiencë +2 vite (mbi kriterin minimal)	*2 pikë*
Eksperiencë + 2–5 vite (mbi kriterin minimal)	*3 pikë*
Eksperiencë + 5 vite (mbi kriterin minimal)	*5 pikë*

a- Kualifikim i përgjithshëm
b Eksperienca në fushën përkatëse

- *Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.*
- *Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.*

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.
Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të punimeve të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/eksperiencat e ngjashme ne të cilat ka qenë angazhuar stafi kyc i propozuar nga kompania demostrojne aftesinë teknike dhe profesionale të personave qe do të angazhohen gjatë zbatimit te shërbimit të mbikqyrjes, dhë garantojnë AK që me eksperiencën e fituar të tyre kontraktori nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës se punimeve qe do te mbikqyret.
Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë eksperiencat e secilit prej stafit kyc te propozuar.

III.5.3. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."
Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.5.4. Neni 21 pika 1 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" i ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*".

III.5.5. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.".

III.5.6. Në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet se:

"*5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.".

III.5.7. Në procesverbalin e argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikë 2.3.3, pikën 2.3.4 dhe pikën 2.3.6 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka argumentuar përkatësisht si më poshtë vijon:

"**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, si dhe specifikimet teknike. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*
Në funksion të garantimit të një implementimi të suksesshëm, të qëndrueshëm dhe cilësor të kontratës, si dhe për të siguruar mirëmbajtje efektive përgjatë gjithë periudhës së parashikuar, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesa minimale për burimet njerëzore të operatorëve ekonomikë.
Këto kërkesa janë në përputhje me natyrën komplekse të projektit në fushën e teknologjisë së informacionit, i cili kërkon ekspertizë të specializuar në disa fusha të ndërlidhura (zhvillim softëare, menaxhim projekti, databaza, infrastrukturë IT, cloud, analizë biznesi dhe testim).

a) Zhvillues softëare (minimumi 3 punonjës me ≥ 7 vite eksperiencë)
Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitete të mjaftueshme teknike për zhvillimin, përshtatjen dhe integrimin e zgjidhjeve informatike.
• Numri minimal prej 3 specialistësh siguron ndarjen e punës dhe vazhdimësinë e projektit edhe në rast mungesash apo ngarkese të lartë.
• Eksperienca ≥ 7 vite garanton nivel të avancuar profesional dhe aftësi për të trajtuar sisteme komplekse.
• Kërkesa për certifikime ndërkombëtare siguron standardizim të njohurive dhe përputhje me praktikat më të mira të industrisë.
Kjo kërkesë është proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me natyrën teknike të kontratës.

b) Menaxher projekti IT (minimumi 1 me ≥ 10 vite eksperiencë)
Menaxhimi i projektit është kritik për koordinimin, respektimin e afateve dhe kontrollin e cilësisë.
• Eksperienca e gjatë (≥ 10 vite) siguron aftësi në menaxhimin e projekteve komplekse dhe shumëpalëshe.

• Certifikimet ndërkombëtare (si PMP, PRINCE2, Scrum Master) garantojnë përdorimin e metodologjive të standardizuara dhe të provuara.
Kjo kërkesë redukton rrezikun e dështimit të projektit për shkak të menaxhimit joefektiv.

c) Specialistë të databazave (minimumi 2 me ≥ 8 vite eksperiencë)
Databazat përbëjnë komponent kritik të çdo sistemi informatik, veçanërisht për sisteme institucionale.
• Numri prej 2 specialistësh siguron redundancë dhe vazhdimësi në operim.
• Eksperienca ≥ 8 vite garanton aftësi në administrimin e databazave komplekse dhe kritike.
• Certifikimet profesionale sigurojnë njohje të standardeve të industrisë dhe teknologjive të avancuara.
Kjo kërkesë është thelbësore për garantimin e integritetit, sigurisë dhe performancës së të dhënave.

d) Specialist i sistemeve operative dhe infrastrukturës IT (minimumi 1 me ≥ 8 vite eksperiencë)
Ky rol është i domosdoshëm për:
• Konfigurimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve ku do të funksionojë sistemi;
• Sigurimin e stabilitetit dhe sigurisë së infrastrukturës IT.
Eksperienca dhe certifikimet garantojnë aftësi për menaxhimin e sistemeve kritike dhe zgjidhjen e problematikave teknike..

ARGUMENTIM: *Ky profil është i domosdoshëm për të udhëhequr projektin në të gjitha fazat e tij, duke përfshirë planifikimin, koordinimin e burimeve, ndjekjen e afateve dhe menaxhimin e rreziqeve. Një menaxher projekti i çertifikuar siguron që ndërtimi i sistemit të gjobave online dhe infrastrukturës përkatëse të realizohet në mënyrë të strukturuar, efikase dhe brenda parametrave të përcaktuar të kohës dhe buxhetit.*
2.3.4 – Specialist i databazave enterprise në cloud (minimumi 1 me ≥ 8 vite eksperiencë)
Duke qenë se sistemet moderne operojnë gjithnjë e më shumë në mjedise cloud, kjo kërkesë është vendosur për të garantuar:
• Administrim profesional të databazave në mjedise të shpërndara dhe scalable;
• Siguri të lartë të të dhënave dhe përputhje me standardet moderne;
• Optimizim të performancës dhe vazhdimësi të shërbimit për sisteme kritike institucionale.
Certifikimet në teknologji enterprise (Oracle, MS SQL, PostgreSQL, etj.) sigurojnë ekspertizë të verifikueshme dhe të standardizuar.
e) Specialist në platforma cloud (minimumi 1 me ≥ 5 vite eksperiencë)
Kjo kërkesë është e domosdoshme për:
• Menaxhimin e infrastrukturës cloud (publike ose private);
• Implementimin e shërbimeve moderne dhe fleksibile;
• Sigurimin e shkallëzueshmërisë dhe vazhdimësisë së sistemeve.
Eksperienca dhe certifikimet nga ofrues të njohur ndërkombëtarisht garantojnë përdorimin korrekt të teknologjive cloud.

f) Analist biznesi / analist funksional (minimumi 1 me ≥ 6 vite eksperiencë)
Ky rol është thelbësor për:
• Përkthimin e kërkesave të institucionit në specifikime teknike;
• Sigurimin që sistemi i zhvilluar i përgjigjet realisht nevojave të përdoruesve.
Eksperienca në projekte të ngjashme siguron kuptim të proceseve dhe rrit cilësinë e zgjidhjes finale.
g) Specialist testimi (minimumi 1 me ≥ 5 vite eksperiencë)
Testimi është fazë kritike për garantimin e cilësisë dhe funksionalitetit të sistemit.
• Siguron identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve përpara implementimit;
• Redukton rrezikun e dështimeve gjatë përdorimit në praktikë.
Certifikimet në testim softëare garantojnë përdorimin e metodologjive standarde të sigurimit të cilësisë.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*
Kërkesa që operatori ekonomik të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë në fushën e teknologjisë së informacionit është vendosur në funksion të garantimit të kapacitetit teknik dhe organizativ për realizimin me sukses të kontratës.
Qëllimi i kriterit
Ky kriter synon të sigurojë që operatori ekonomik:
• Ka përvojë të konsoliduar në tregun e teknologjisë së informacionit;
• Ka kaluar një periudhë të mjaftueshme operimi për të provuar qëndrueshmëri dhe besueshmëri;
• Ka zhvilluar kapacitete të brendshme për menaxhimin dhe realizimin e projekteve të ngjashme;
• Është në gjendje të përballojë kompleksitetin teknik dhe organizativ të kontratës.

Arsyetimi i pragut prej 5 vitesh
Përcaktimi i një periudhe minimale prej 5 vitesh konsiderohet:
• Proporcional, pasi nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në mënyrë të panevojshme;
• I arsyeshëm, për të garantuar një nivel minimal eksperience dhe stabiliteti në treg;
• Në përputhje me praktikat e zakonshme të prokurimit publik, për kontrata që lidhen me zhvillimin dhe implementimin e sistemeve informatike.
Ky prag kohor siguron një balancë ndërmjet:
• Nxitjes së konkurrencës;
• Dhe garantimit të cilësisë dhe besueshmërisë së operatorit ekonomik.

Mënyra e verifikimit
Për të provuar përmbushjen e këtij kriteri, kërkohet paraqitja e:

- *Ekstraktit Historik të Regjistrit Tregtar të lëshuar nga QKR, i cili:*

- *Vërteton datën e regjistrimit të operatorit ekonomik;*
- *Siguron informacion zyrtar dhe të verifikueshëm mbi aktivitetin e tij.*
- *Profilit (CV) të Operatorit Ekonomik, i cili:*
- *Evidenton aktivitetin, projektet dhe fushat e ekspertizës;*
- *Jep një panoramë të përvojës reale në sektorin e teknologjisë së informacionit.*

Kombinimi i këtyre dokumenteve garanton një verifikim të plotë dhe objektiv të përvojës së operatorit ekonomik.".

III.5.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik..

III.5.9.1. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorëvë ekonomikë ankimues për modifikimin e kritereve kualifikuese të përcaktuara përkatësisht në pikën 2.3.3, pikën 2.3.4 dhe pikën 2.3.6 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ku operatori ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK kërkon heqjen e kërkeses për vitet e eksperiencës së punës për punonjësit me aftësi profesionale për "*zhvillimin e zgjidhjeve informatike*", me aftësi profesionale për "*menaxher te projekteve IT*", me aftësi profesionale për "*me profil në administrimin dhe/ose implementimin e sistemeve të menaxhimit të bazave të të dhënave*", me aftësi profesinale për "*me profil administrimin e sistemeve operative dhe infrastrukturës IT*", me aftësi profesionale për "*specialist në administrimin e databazave enterprise në mjedise cloud*", me aftësi profesionale për "*me profil në përdorimin dhe/ose administrimin e platformave cloud*", me aftësi profesinale për "*me profil në analizën e biznesit dhe/ose analizën funksionale të sistemeve softëare*", me aftësi profesionale për "*me profil në testimin e sistemeve informatike*" dhe lidhur me kërkesën për heqjen e vitet e eksperiencës të operatorit ekonomik ofertues, si dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK për heqjen e kërkesës për vitet e eksperiencës së punës për punonjësit me aftësi

profesionale për "*specialist në administrimin e databazave enterprise në mjedise cloud*", me aftësi profesionale për "*me profil në përdorimin dhe/ose administrimin e platformave cloud*", me aftësi profesinale për "*me profil në analizën e biznesit dhe/ose analizën funksionale të sistemeve softëare*", me aftësi profesionale për "*me profil në testimin e sistemeve informatike*", Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor e ka përcaktuar kërkesën e mësipërme me argumentimin se me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar dhe me nivel të anacuar profesional për realizimin me sukses të kontratës, e cila është procedurë e përzier, ku objekti i saj është zhvillimi dhe implementimi i Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore te Bashkise Himarë dhe mirëmbajtjes së këtij sistemi për një periudhë 12 mujore.

Për më tepër, Komisioni konstaton se kriteri i përzgjedhjes së operatorit ekonomik të suksseshsëm do të bëhët mbi bazën e kriterit të vlerësimit "*Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto*", ku dy nga kriteret e vlerësimit është nënkriteri "*Eksperienca e ngjashme e kompanisë*" dhe nënkriteri "*Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar*", sipas përcaktimeve të pikës 4.4 "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*Procedura*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ku autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit të secilit nënkriter dhe konkretisht për nënkriterin "*Eksperienca e ngjashme e kompanisë*" do të marrë pikët maksimale ai operator ekonomik ofertues i cili dëshmon se ka realizuar kontrata të ngjashme me vlerën më të madhe, ndërsa për nënkriterin "*Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar*" do të marrë pikët maksimale ai operator ekonomik ofertues i cili dëshmon se ka të punësuar në stafin e tij punënjësit e kërkuar në kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe që kanë eksperiencë për një periudhë më të gjatë kohore përsa i përket certifikimeve që zotërojnë.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se bazuar në kompleksitetin dhe volumin e kontratës objekt-prokurimi dhe nisur nga kriteri i vlerësimit i përcaktuar në pikën 4.4 "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*Procedura*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, kërkeses për vitet e eksperiencës së punës për punonjësit e kërkuar në kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit, si dhe kërkesa për vitet e eksperiesncës së operatorit ekonomik ofertues të përcaktuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit, janë kërkesa të paargumentuar në raport me objektin e prokurimi, si dhe është e ekzagjeruar dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, pasi eksperienca e stafit të kualifikuar dhe eksperienca e operatorit ekonomik janë kritere vlerësimi dhe jo kritere kualifikuese.

Akoma më tej, qoftë në argumentet e publikuara nga autoriteti kontraktor në procesverbalin e argumentimit të vendosjes së këtyre kritereve objekt ankimimi, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të justifikojë teknikisht dhe ligjërisht përcaktimin e eksperjencës për stafin e kualifikuar dhe për operatorin ekonomik ofertues. Përsa kohë një specialist mund të jetë i diplomuar apo certifikuar në atë

specialitet të kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk është e nevojshme eksperienca prej më shumë se 10 (dhjetë), 8 (tetë), 6 (gjashtë) apo 5 (pesë) vite, si dhe përsa kohë që operartori ekonomik ofertues vërteton se ka realizuar kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk është e nevojshme eksperienca 5 (pesë) vjeçare e operatorit ekonomik ofertues.
Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor lidhur me eksperiencën e stafit të kualifikuar dhe eksperienca e opertorit ekonomik ofertues është një kërkesë e paargumentuar teknikisht nga ana e autoritetit kontraktor dhe bie ndësh me kriterin e vlerësimit të përcaktuar në në pikën 4.4 "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*Procedura*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3, pikën 2.3.4 dhe pikën 2.3.6 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke hequr kërkesën për vitet e eksperiencës së stafit dhe vitet e eksperiencës së operatorit ekonomik ofertues.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK qëndrojnë.

III.5.9.2. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomikë ankimues "KREATX" SHPK për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuara përkatësisht në pikën 2.3.4 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ku operatori ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK përsa i përket kërkesës që certifikatat e punonjësve të jenë të lëshuara nga organe të akredituara nga shqiptare ose të huaja, duke pretenduar si në vijim: "*Së teti: Në kriteret e veçanta kualifikuese në shtojcën nr.9, pika 2.3.4, të DST, për certifikatat AK shprehet se, "Shënim 1: Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizma te akredituar, shqiptar ose te huaj. Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:*
- Çertifikata për specialistët e kërkuar, te dhena nga organizma te akredituar, shqiptar ose te huaj.".
Kreatx SHPK vëren se ky kriter kualifikues në DST, ku subjekti që lëshon certifikatën për personelin e OE duhet të jetë me patjetër i akredituar, në tregun aktual që ushtrohet aktiviteti TIK në Shqipëri dhe jashtë vendit tonë, është joproporcional dhe kufizues për pjesëmarrjen në tender. Kjo pasi, tregu nuk përmban vetëm organe të akredituara vendase apo të huaja të pajisura me autoritetin e certifikimit të personelit, madje këto subjekte ose janë në minorancë ose nuk ekzistojnë fare brenda Shqipërisë.
Shumica e certifikimeve të personelit të OE burojnë nga subjekte tregtare apo organizata private të huaja të paakredituara, por të njohura ndërkombëtarisht në fushën e IT. Për pasojë, kriteri kualifikues në këtë rast duhet të ndryshojë nga AK, duke konsideruar të vlefshme edhe certifikatat e lëshuara nga subjekte vendase ose të huaja të njohura në industrinë e teknologjisë së informacionit.

Pretendimi i mësipërm i Kreatx SHPK gjen mbështetje ***në vendimin nr.260/2026 të KPP****, ku KPP ka legjitimuar modifikimin e DST, duke pranuar se certifikimet në fushën e IT mund të lëshohen nga organe të akredituara vendase apo të huaja, nga subjektet që ofrojnë kurse profesionale sipas kuadrit legjislativ të kurseve profesionale në Republikën e Shqipërisë/legjislacioni për arsimin e lartë, si dhe nga subjekte të huaja profesional çertifikuese, të njohura në industrinë e teknologjisë së informacionit vendase apo të huaja. Në këto kushte, AK duhet të modifikojë DST sipas praktikës administrative të ndjekur nga KPP, duke u mundësuar ofertimin edhe OE që disponojnë staf të certifikuar nga subjekte të njohura ndërkombëtarisht në industrinë e TIK.*", Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor e ka përcaktuar kërkesën e mësipërme me argumentimin se me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar dhe me nivel të avancuar profesional për realizimin me sukses të kontratës, e cila është procedurë e përzier, ku objekti i saj është zhvillimi dhe implementimi i Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore te Bashkise Himarë dhe mirëmbajtjes së këtij sistemi për një periudhë 12 mujore.

KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Lidhur me pretendimin e mesipërm të operatorit ekonomik ankimues "KREATX" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konkretisht shtojcës nr. 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*", konstaton, se kemi të bëjmë me një procedurë specifike dhe sensitive referuar objektit të prokurimit që është "*implementimi i një sistemi informatik të sigurt, i cili* ***duhet të*** *automatizojë ciklin e plotë të administrimit të taksave dhe tarifave vendore, si dhe mirëmbajtja e këtij sistemi për një periudhë 12 mujore*". Për realizimin e procedurës objekt ankimi nevojitet një staf i specializuar për të cilin për të patur sigurinë për realizimin me sukses të objektit të procedurës autoriteti kontraktor ka kërkuar dorëzimin e certifikatave sipas kategorive të caktuara, referuar profilit të secilit prej punonjësve, duke përcaktuar që këto certifikata të jenë të lëshuara nga organizma të akredituar vendas apo të huaj . Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues Komisioni konstaton, se operatori ekonomik nuk ka arritur të argumentojë se si kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e diplomave apo certifikatave cënon interesin e tij të ligjshëm dhe ngushton konkurencën. Nga ana tjetër referuar procesverbalit "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim", autoriteti kontraktor ka argumentuar nevojën për secilin nga specialistët për realizimin me sukses të kontratës. Akoma më tej Komisioni gjykon, se punonjësit e kërkuar si dhe kualifikimet e tyre janë përcaktuar bazuar në natyrën e shërbimit, duke u përputhur me

specifikimet teknike, termat e referencës, objektin e prokurimit dhe proceset e punës që do të kryejë secili. Referuar natyrës së shërbimit që do të kryejë secili prej punonjësve për shkak të natyrës së punës Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e certifikatës i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, pasi nisur nga detyrat që do të kryejnë është e nevojshme që të zotërojnë njohuri më të thelluara të cilat mund të vërtetohen përmes paraqitjes së certifikatës përkatëse, pasi janë njohuri që nuk mund të fitohen nëpërmjet trajnimeve nga organizma ndërkombëtarë të paakreditуar. Pra paraqitja e certifikatës është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. KPP gjykon, se ky kriter është i përshtatshëm për arritjen e synimit të kërkuar dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin duke përmbushur në këtë mënyrë edhe testin e proporcionalitetit në lidhje me hartimin e tij. Komisioni gjykon, se formimi profesional i personelit përbën domosdoshmëri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me certifikatë sipas kategorive dhe shërbimeve që do të kryejë secili nga punonjësit. Akoma më tej referuar ankesës me me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026 operatorit ekonomik ankimues nuk ka argumentuar se si ky kriter cënon interesin e tij të ligjshëm dhe cënon konkurrencën.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.4**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.7**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6521, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1132/2026 prot., datë 14.04.2026, lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.10**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026, si dhe lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.18** të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në pikën 2.3.7 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

"*2.3.7 Verifikimi Praktik i Funksionaliteteve*

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që, gjatë fazës së vlerësimit teknik, të kërkojë nga Operatorët Ekonomikë të kualifikuar paraprakisht, zhvillimin e një seance demonstrimi 'live' të platformës/softuerit të ofruar. Ky demonstrim ka për qëllim vërtetimin e funksionaliteteve teknike të deklaruara në ofertë dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat funksionale e Teknike (pika 13 ToR).
Demonstrimi duhet të realizohet mbi një sistem ekzistues dhe funksional, jo prototip ose version demonstrues.
Operatori Ekonomik do të njoftohet me përpara për datën dhe orën e prezantimit që do te kryhet në ambientet e Autoritetit Kontraktues.
Në rast se Operatori Ekonomik dështon të provojë ekzistencën e funksionaliteteve të kërkuara në DST, ose nëse konstatohet se sistemi nuk i përgjigjet specifikimeve të deklaruara në ofertën teknike, oferta nuk do të konsiderohet dhe do të skualifikohet".

III.6.2. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."
Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.6.3. Neni 21 pika 1 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" i ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*".

III.6.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.".

III.6.5. Në nenin 40, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet se:

"*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë)

ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.".

III.6.6. Në procesverbalin e argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me kriterin kualifikues të përcaktuara në pikën 2.3.7 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka argumentuar përkatësisht si më poshtë vijon:

"***ARDUMENTIMI:*** *Argumentimi i kriterit 2.3.7 – Verifikimi praktik i funksionaliteteve*
Në funksion të garantimit të përputhshmërisë reale të ofertave teknike me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) dhe Termat e Referencës (ToR), Autoriteti Kontraktues ka parashikuar mundësinë e zhvillimit të një verifikimi praktik ("live") të funksionaliteteve të platformës/softuerit të ofruar.

Qëllimi i kriterit
Ky kriter synon të sigurojë që:
- *Funksionalitetet e deklaruara në ofertë janë reale, ekzistuese dhe të verifikueshme;*
- *Sistemi i propozuar është i zhvilluar dhe funksional, dhe jo në fazë koncepti apo prototipi;*
- *Ekziston një përputhje e plotë ndërmjet ofertës teknike dhe kërkesave funksionale e teknike të përcaktuara në ToR;*
- *Reduktohet rreziku i mosrealizimit të kontratës ose i ofrimit të një zgjidhjeje jo funksionale.*

Arsyetimi i nevojës për demonstrim "live"
Në projektet në fushën e teknologjisë së informacionit, ekziston rreziku që operatorët ekonomikë të paraqesin:
- *Përshkrime teorike ose të përgjithshme të sistemeve;*
- *Zgjidhje që nuk janë të implementuara realisht;*
- *Funksionalitete që nuk janë plotësisht të zhvilluara ose të testuara.*

Për këtë arsye, demonstrimi praktik:
- *Mundëson verifikimin objektiv dhe të drejtpërdrejtë të kapaciteteve teknike;*
- *Siguron që sistemi është operacional në kushte reale përdorimi;*
- *Rrit transparencën dhe besueshmërinë në procesin e vlerësimit;*
- *Mbron interesin publik duke shmangur kontraktimin e zgjidhjeve të papjekura.*

Kërkesa për sistem ekzistues dhe funksional
Kushti që demonstrimi të realizohet mbi një sistem:

- *Ekzistues dhe funksional, dhe jo prototip apo demo, është i nevojshëm për të garantuar që:*
- *Operatori ekonomik ka eksperiencë reale në zhvillimin dhe implementimin e sistemeve të ngjashme;*
- *Zgjidhja e propozuar është e testuar dhe e përdorshme;*
- *Implementimi i kontratës nuk do të fillojë nga zero, duke reduktuar rreziqet dhe vonesat.*

Procedura dhe garancia e transparencës

- *Operatorët ekonomikë do të njoftohen paraprakisht për datën dhe orën e demonstrimit, duke garantuar trajtim të barabartë dhe kohë të mjaftueshme për përgatitje.*
- *Demonstrimi do të zhvillohet në kushte të njëjta për të gjithë operatorët e kualifikuar, duke respektuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit***.**".

III.6.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.6.8. Referuar pretendimëve të mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Komisioni konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit. Nga shqyrtimi i kritereve të kualifikimit, KPP vëren, objekti i prokurimit është zhvillimi dhe implementimi i Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore te Bashkise Himarë dhe për këtë produkt autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kriterin kualifikues në pikën 2.3.7 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI*

KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi që gjatë fazës së vlerësimit të ofertave operatorët ekonomikë ofertues të kualifikuar duhet të paraqiten pranë ambienteve të autoritetit kontraktor për të zhvilluar një seancë demostrimi "live", ku demostrojnë funksionalitete teknike të sistemit të ofruar prej tyre me qëllim vërtetimin e përputhshmërisë funksionaliteteve të sistemit të ofruar me funksionalitet e sistemit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve të parashtruara nga operatori ekonomik ankimues, në ankesën e tij, gjykojmë, se referuar objektit të prokurimit si dhe natyrës së produkteve që kërkohet të furnizohet, gjykojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor për zhvillimin e një seance demostrimi është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit që kërkohet të prokurohet, si dhe është një kërkesë e pa argumentuar në legjislacionin për prokurimin publik, referuar proceverbalit të argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronke (SPE). Vlen të theksojmë, se qëllimi i autoritetit kontraktor, është furnizimi në kohë dhe në cilësi me produktin objekt-prokurimi, por në respekt të parimeve të ligjit për prokurimin publik, kriteret e kualifikimit të hartuara nga autoriteti kontraktor, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e kritereve të kualifikimit autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, e cila kufizon pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Akoma më tej, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka në dispozicion edhe momentin procedural të kontrollit pas lidhjes së kontratës të përputhshmërisë së produktit të furnizuar nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet i mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikoje dokumentat e tenderit objekt ankimimi, duke hequr kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.7 "Kapaciteti teknik" të Shtojcës 8 "*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit, pasi kjo kërkesë është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit dhe për më tepër është e pa argumentuar ligjërisht.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK, e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK qëndrojnë.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.7**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, si dhe lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.9**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në pikë 2.3.5 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

"*2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues që do të realizoje këtë kontratë duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatat përkatëse të vlefshme, si mëposhtë:*
Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave, duhet të paraqesin certifikata të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues.
Konkretisht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme, ose standarde ekuivalente, të vlefshme në datën e ofertimit:
***ISO 9001:2015** – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë;*
***ISO/IEC 27001** – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;*
***ISO/IEC 20000-1** – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit.*
***Certifikatë ISO/IEC 27018:2019** ose version i përditësuar – Kod praktikash për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud;*
***Certifikatë ISO/IEC 42001:2023** – Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale, e vlefshme;*
OSE
Dokumentacion teknik dhe organizativ i cili duhet të vërtetojë zbatimin real dhe operacional të masave ekuivalente për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud.
Ky dokumentacion mund të përfshijë, pa u kufizuar në:
– politika dhe procedura të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
– përshkrim teknik të arkitekturës cloud dhe masave të sigurisë së aplikuara;
– dokumentacion që vërteton përdorimin aktiv të këtyre masave në sisteme cloud për një periudhë minimale prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.
Dokumentacioni duhet të jetë i mjaftueshëm për të provuar përmbushjen e kërkesës sipas dokumenteve të Tenderit dhe do të verifikohet nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me to.
Dokumentacioni i paraqitur:

- *duhet të jetë i mjaftueshëm për verifikim objektiv;*

- *verifikohet nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Dokumentet e Tenderit;*

në rast paqartësish, AK ka të drejtë të kërkojë sqarime ose dokumente plotësuese, pa ndryshuar kriterin.".

III.7.2. Në pikë 12 "*Sistemi duhet te kete edhe nje asistent Virtual*" të Shtojcës 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të produktit objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

"***12. Sistemi duhet te kete edhe nje asistent Virtual.***
Ky propozim kerkon ekzistencen e një Agjenti të avancuar të Inteligjencës Artificiale (AI), i projektuar për të mbështetur Bashkinë e Himarës në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët – me zë dhe me shkrim, optimizimin e proceseve administrative dhe trajtimin e kërkesave si përmes telefonatave (me zë), ashtu edhe përmes sistemit të email/ëhatsapp.
Objektivat:
• T'u ofrojë qytetarëve përgjigje të shpejta dhe të sakta për pyetjet më të shpeshta.
• T'u ofrojë subjekteve apo individeve përgjigje për pyetje që lidhen me sistemin e taksave apo tarifave qe aplikohen.Aktet ligjore e nenligjore qe lidhen me to.
• Të informojë në mënyrë të detajuar qytetarët dhe subjektet mbi detyrimet tyre tatimore .
• Të reduktojë ngarkesën e punës për punonjësit e bashkisë, duke liruar kohë për aktivitete me vlerë më të lartë.
-Karakteristikat kryesore qe kerkohen per Agjentin AI
• Ndërveprim me zë: Qytetarët mund të telefonojnë bashkinë dhe të marrin përgjigje në kohë reale, natyrale dhe të ngjashme me komunikimin njerëzor nga Agjenti AI.
• Agjenti AI duhet te njihet me çdo përditësim të ligjeve,VKM-ve ,VKB-ve,urdherave te ndryshem etj dhe ua komunikon ato me detaje qytetarëve kur adresojnë pyetje ne keto drejtime.
• Mbështetje me email: Kategorizim dhe përgjigje automatike të email-eve.
• Mbështetje shumëgjuhëshe: Përgjigjet mund të jepen në shqip,greqisht dhe anglisht , sipas preferencës së qytetarit.
• Panel analitik : Stafi i drejtorise se te ardhurave duhet të ketë akses në një panel me të dhëna dhe analiza mbi numrin e telefonatave, përgjigjet e përpunuara dhe matjen e kënaqësisë së qytetarëve.".

III.7.3. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."
Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.7.4. Neni 21 pika 1 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" i ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj*.".

III.7.5. Në nenin 79 "*Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor*" të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*
2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:
a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
b) eficiencës së energjisë;
c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.
4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit".

III.7.6. Në nenin 44 "*Kërkesat e cilësisë*" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet se:

"*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/të barasvlershme me të ose një dokument që provon të njëjtin informacion.
5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuara nga autoriteti/enti kontraktor".

III.7.7. Në procesverbalin e argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me kriterin kualifikues të përcaktuara në pikën 2.3.5 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka argumentuar përkatësisht si më poshtë vijon:

"***Argumentimi:*** *Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".*

ISO 9001:2015 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë" – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Certifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akredites të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 27001:2017 "Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit" - është thelbesor, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standardet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Certifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akredites të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 20000-1:2011 "Sistemi për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë informative" është një standard që specifikon kërkesat për ngritjen dhe menaxhimin efektiv të një Sistemi të Menaxhimit të Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (MShT). Kërkesat përfshijnë projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e rëna dakord për shërbimit. Qëllimi i tij është të sigurojë një standard të përbashkët referimi për çdo ndërmarrje që ofron shërbime IT për klientët e brendshëm ose të jashtëm. Theksi është dhënë në rëndësinë e integrimit të procesit. Certifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akredites të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe shërbimet cloud
Duke qenë se shërbimi objekt prokurimi do të ofrohet në mjedise cloud dhe përfshin përpunimin, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave personale, Operatori Ekonomik duhet të demonstrojë se zbaton masa të avancuara për mbrojtjen e të dhënave personale (PII) në mjedise cloud, në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
Për këtë qëllim, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë njërën nga alternativat e mëposhtme:
OSE
Dokumentacion teknik dhe organizativ i cili duhet të vërtetojë zbatimin real dhe operacional të masave ekuivalente për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud.

Ky dokumentacion mund të përfshijë, pa u kufizuar në:
– politika dhe procedura të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
– përshkrim teknik të arkitekturës cloud dhe masave të sigurisë së aplikuara;
– dokumentacion që vërteton përdorimin aktiv të këtyre masave në sisteme cloud për një periudhë minimale prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.
Dokumentacioni duhet të jetë i mjaftueshëm për të provuar përmbushjen e kërkesës sipas dokumenteve të Tenderit dhe do të verifikohet nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me to.
Dokumentacioni i paraqitur:

- *duhet të jetë i mjaftueshëm për verifikim objektiv;*
- *verifikohet nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me Dokumentet e Tenderit;*
- *në rast paqartësish, AK ka të drejtë të kërkojë sqarime ose dokumente plotësuese, pa ndryshuar kriterin.*

Certifikatë ISO/IEC 42001:2023 – Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale, e vlefshme; Inteligjenca Artificiale (IA)
Duke qenë se objekti i kontratës përfshin zhvillimin, integrimin dhe përdorimin e funksionaliteteve të bazuara në Inteligjencë Artificiale, Operatori Ekonomik duhet të demonstrojë se disponon kapacitete të konsoliduara teknike dhe organizative për projektimin, implementimin dhe menaxhimin e sistemeve IA në mjedise operative reale.
Për përmbushjen e kësaj kërkese, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata te vlefshme ose dokumentacion ekuivalent qe vertetojne permbushjen e kerkesave te mesiperme:".

III.7.8. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë*

operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.".

III.7.9. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesve, mbi heqje e kërkesës për paraqitjen e certifikatës ISO/IEC 42001:2023 "*Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale*", si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin Certifikatën ISO 9001:2015 "*Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë*", Certifikatën ISO/IEC 27001 "*Standard për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit*", Certifikatën ISO/IEC 20000-1 "*Standard për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit*", Certifikatë ISO/IEC 27018:2019 "*Kod praktikash për mbrojtjen e të dhënave personale në mjedise cloud*" dhe Certifikatën ISO/IEC 42001:2023 "*Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale"*, nga ku konstaton se: Autoriteti Kontraktor në kriterin objekt ankimi ka kërkuar një numër të madh Certifikata ISO, në total 5 *(pesë*) certifikata cilësie.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik "*KREATX*" SHPK i cili pretendon se në Republikën e Shqipërisë nuk ka asnjë orahn të vlerësimit të konformitet të akreditуar pranë Drejtorisë seë Përgjithshme të Akreditimit për të lëshuar certifikatën ISO/IEC 42001:2023 "*Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale"*, çka i bën këtë kërkesë praktikisht të paplotësueshme në 100% nga operatorët vendas, Komisioni vëren se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me shkresën nr. 1329/19 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "KREATX" SHPK*" nuk është shprehur nëse ka kryer verifikime në lidhje me këtë certifikatë objekt ankimi, si edhe të argumentojë qartë vendimin e KSHA-së mbi domosdoshmërinë e këtyre certifikatave objekt ankimi në realizimin e kontratës. Komsioni vëren se ISO (*Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit*) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, joqeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie në nivel botëror dhe shoqëritë ndjekin adoptimin e standardeve të cilësisë me qëllim që të jenë të aftë dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qëndrueshëm me avantazhe reciproke. Komisioni gjykon se Autoritetet kontraktore duhet të jenë të qartë dhe konkretë në vendosjen e Çertifikatave ISO më të domosdoshme për realizimin e procedurave të prokurimit.

Gjithashtu referuar ankesës së operatorit ekonomik "*Idealdevs Corporation*" SHPK i cili pretendon ai nq vijim: "*Referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, operatori ekonomik ka detyrimin të integrojë një chatbot online që i shërben qytetarëve për informacion në kohë reale. Në këtë kontekst, kërkesa për ISO/IEC 42001:2023 rezulton joproporcionale dhe e pajustifikuar, pasi ky standard aplikohet për sisteme të inteligjencës artificiale që ndikojnë drejtpërdrejt në vendimmarrje autonome apo procese kritike, ndërkohë që në rastin konkret bëhet fjalë për një shërbim informues, i cili në*

praktikë do të bazohet në integrimin e një shërbimi të palëve të treta, si p.sh. modele LLM (ChatGPT apo të ngjashme).
Për më tepër, implementimi i një zgjidhjeje të tillë nuk përbën zhvillim të një sistemi të plotë AI nga operatori ekonomik, por integrim të një shërbimi ekzistues, çka e bën kërkesën për këtë standard të panevojshme dhe kufizuese për konkurrencën.
Kërkesa e mësipërme tejkalon testin e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë në këtë procedurë prokurimi, sepse është vendosur në kundërshtim dhe në tejkalim të natyrës, tipologjisë dhe përmasave të kësaj procedure prokurimi.", Komisioni vëren se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me shkresën nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*" për këtë pretendim të ankimuesit është shprehur si në vijim: "*Nga përmbajtja e Dokumenteve të Tenderit rezulton qarte se operatorët ekonomikë kanë mundësinë të përmbushin këtë kërkesë edhe përmes:*

1. *standardeve ekuivalente;*
2. *si dhe dokumentacionit teknik dhe organizativ, i cili provon zbatimin real dhe operacional të masave përkatëse.*

Në këto kushte, kërkesa për ISO/IEC 42001:2023 nuk përbën një kriter përjashtues, por një standard referues, i cili mund të përmbushet edhe përmes mjeteve të tjera ekuivalente, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive.
Sa i përket pretendimit se kërkesa nuk lidhet me natyrën e kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky interpretim nuk qëndron, pasi edhe në rastet kur përdorimi i komponentëve të inteligjencës artificiale është i kufizuar, kërkohet gjithsesi garantimi i përdorimit të sigurt, të kontrolluar dhe në përputhje me praktikat e mira të menaxhimit të këtyre teknologjive.
Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur me objektin e kontratës, proporcional dhe i hapur ndaj konkurrencës.", ndërkohë që për pretendimin nr. 8 të ankimuesit Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me shkresën nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*" është shprehur si në vijim: "*... Autoriteti Kontraktor thekson se komponenti i inteligjenceës artificiale i parashikuar në Termat e Referencës nuk përbën një modul të veçantë apo një sistem të pavarur, por një funksionalitet ndihmës në formën një asistenti virtual (chatbot), i cili ka për qëllim ofrimin e informacionit për përdoruesit në kohe reale. ...*", duke mos arritur që të argumentojë domosdoshmërinë e disponimit të certifikatës ISO të sipërpërmendur për të realizuar me sukses objektin e prokurimit dhe për më tepër vetë autoriteti kontraktor është kontradiktor në argumentat e parashtruara për këtë pretendim të ankimuesit, pasi nga njëra anë pretendon se kjo certifikatë është e domosdoshme për realizimin e objektit të prokurimit (*zhvillimi dhe implementimi i Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Himarë*) ndërsa nga ana tjetër shprehet se asistenti virtual *(chatbot)* është një funksionalitet ndihmës i sistemit objekt prokurimi, pra vetë sistemi në tërësi nuk do të ndërtohet bazuar mbi inteligjencën artificiale.

III.7.10. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e certifikatës ISO/IEC 42001:2023 "*Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale*", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon

të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i programit për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Himarë. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa për disponimin e certifikatës ISO/IEC 42001:2023 "*Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale*" përcaktuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.5 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Në këtë mënyrë Komisioni gjykon, se certifikata në fjalë nuk është proporcionale me objektin e prokurimit dhe nuk janë në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Komisioni thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.Në këtë kuadër Komisioni gjykon se autoriteti kontrakor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 "Kapaciteti teknik" të Shtojcës 8 "*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke hequr kërkesën që operatori ekonomik ofertues të paraqesë e certifikatën ISO/IEC 42001:2023 "*Sistemi i Menaxhimit të Inteligjencës Artificiale*".

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK qëndrojnë.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.11**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, si dhe lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.3**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Në pikën 4.4/A "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*PROCEDURA*" të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri i vlerësimit të ofertave të paraqitura, si më poshtë vijon:

A) ***Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X***
Sipas rëndësisë:

5. ***Çmimi*** ***pikët 50***
6. ***Eksperienca e ngjashme e kompanisë*** ***pikët 10***
7. ***Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit*** ***pikët 10***
8. ***Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar*** ***piket 30***

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:
Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.
Kriteri:

5. Çmimi ***[0-50] pikë***

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.
Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:
$P_{k1} = V_{mink1} \; x \; P_{maxk1}/O_{k1}$
P_{k1} *Pikët e kriterit që vlerësohet*
V_{mink1} *Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet*
P_{maxk1} *Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet*
O_{k1} *Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet*
Shënim: Oferta duhet të hartohet në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.5.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit.

6. Eksperienca e ngjashme e kompanisë ***[0 - 10 pikë]***

Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të shërbimit të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/kontratat e ngjashme të kryera përtej minimumit të kërkuar garantojnë AK që me qëndrueshmërinë në treg, eksperiencën e stafit teknik dhe të vetë organizatës të fituar si dhe kapacitetin e lartë teknik kontraktori mbikqyrës nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së punimeve

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë kontrata me vlerën më të lartë për objekte të ngjashëm përtej minimumit të percaktuar në kriterin e kualifikimit pika 2.3.1/a, Shtojca 8 dhe që janë realizuar në periudhën kohore brenda tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
*Ofertuesi me vlerën e kontratës së **objektit** të ngjashëm në vlerë absolute më të madhe do ti akordohen pikët maksimale të nën-kriterit dhe ofertuesit e tjerë të kualifikuar (minimalisht sa eshte percaktuar ne piken 2.3.1/a), Shtojca 8) do ti akordohen pikët sipas metodologjisë/formulës më poshtë:*
Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$P_{kn} = V_{maxkn} \times P_{maxkn} / O_{kn}$

P_{kn} *Pikët e kriterit që vlerësohet*
V_{maxkn} *Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e objektit të ngjashëm)*
P_{maxkn} *Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet*
O_{kn} *Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet*

Për të plotësuar këtë kërkesë ofertuesit mjaftojnë të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.1/a.

7. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit [0–10 pikë]

Përqasja teknike dhe metodologjia

Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjetjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave te Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.
Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

Elementi i vlerësimit	*Përshkrimi*	*Pikët*
Kuptimi i detyrës	*Qartësia në interpretimin e objektit të kontratës*	*0 – 3 pikë*
Organizimi i punës	*Planifikimi, fazat dhe menaxhimi i aktivitetit*	*0 – 3 pikë*
Metodat teknike	*Mjetet dhe teknikat e propozuara*	*0 – 2 pikë*
Menaxhimi i riskut	*Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve të mundshme*	*0 – 2 pikë*

8. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar [0–30 pikë]

Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

- *Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.*

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

4.1 Drejtuesi i projektit – 15 pikë

Përshkrimi	*Pikët*
Eksperiencë + 3 vite (mbi kriterin minimal)	*5 pikë*
Eksperiencë + 3–5 vite (mbi kriterin minimal)	*10 pikë*
Eksperiencë + 5 vite (mbi kriterin minimal)	*15 pikë*

4.2 Stafi teknik kryesor –15 pikë
Vlerësohet për çdo specialist sipas eksperiencës:

Përshkrimi	*Pikët*
Eksperiencë +2 vite (mbi kriterin minimal)	*2 pikë*
Eksperiencë + 2–5 vite (mbi kriterin minimal)	*3 pikë*
Eksperiencë + 5 vite (mbi kriterin minimal)	*5 pikë*

a- Kualifikim i përgjithshëm
b Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.
Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.
Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të punimeve të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/eksperiencat e ngjashme ne të cilat ka qenë angazhuar stafi kyc i propozuar nga kompania demostrojne aftesinë teknike dhe profesionale të personave qe do të angazhohen gjatë zbatimit te shërbimit të mbikqyrjes, dhë garantojnë AK që me eksperiencën e fituar të tyre kontraktori nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës se punimeve qe do te mbikqyret.
Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë eksperiencat e secilit prej stafit kyc te propozuar.

III.8.2. Në pikë 2.3.1, pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

"*2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë* ***jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur*** *të objektit që prokurohet****.***

a) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të realizuara.*
b) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të realizuara.*

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

2.3.3 Për të garantuar implementimin, realizimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit si dhe suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

*a) Minimumi **3 (tre) punonjës** ,secili me minimumi 7 (shtate) vite pervoje profesionale **ne zhvillimin e zgjidhjeve informatike**.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë të paktën një certifikim profesional për secilin punonjës, të lëshuar nga institucione të njohura ndërkombëtarisht, që vërtetojnë aftësi në zhvillim dhe programim softëare, si p.sh.:

– certifikime në zhvillim aplikacionesh, platforma softëare, ose gjuhë programimi,

– ose certifikime ekuivalente, të barasvlefshme për nga niveli dhe përmbajtja.

*b) Minimumi **1 (një) punonjës menaxher te projekteve IT**. (Minimumi 10 (dhjete) vite pervoje profesionale ne)*

Kjo kerkese permbushet permes certifikimeve profesionale te njohura nderkombetarisht ne fushen e menaxhimit te projekteve (p.sh PMP, PRINCE2, Scrum Master), ose certifikime ekuivalente.

*c) Minimumi **2 (dy) punonjës**, me profil në **administrimin dhe/ose implementimin e sistemeve të menaxhimit të bazave të të dhënave**. (Minimumi 8 (tetë) vite përvojë profesionale)*

Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale në fushën e databazave, të lëshuara nga organizata ose institucione përkatëse, ose certifikimeve ekuivalente.

*d) Minimumi **1 (një) punonjës** me profil **administrimin e sistemeve operative dhe infrastrukturës** IT. (Minimumi 8 (tetë) vite përvojë profesionale)*

Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale të njohura ndërkombëtarisht ose certifikimeve ekuivalente.

*2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht **1 (një) specialist në administrimin e databazave enterprise në mjedise cloud**, (Minimum 8 (tetë) vite përvojë profesionale në administrimin, konfigurimin, sigurimin dhe optimizimin e performancës së databazave të përdorura për sisteme kritike institucionale.)*

Specialisti duhet të ketë certifikime profesionale të vlefshme në teknologji databazash enterprise (p.sh. Oracle, MS SQL Server, PostgreSQL Enterprise ose ekuivalente) dhe të demonstrojë përvojë në auditimin e sigurisë dhe menaxhimin operacional të databazave.

*e) Minimumi **1 (një) punonjës** me profil në **përdorimin dhe/ose administrimin e platformave** cloud. (Minimumi 5 (pesë) vite përvojë profesionale)*

Certifikimi duhet të jetë i lëshuar nga ofrues të njohur ndërkombëtarisht të shërbimeve cloud (publike ose private), ose certifikim tjetër ekuivalent

*f) Minimumi **1 (një) punonjës** me profil në **analizën e biznesit dhe/ose analizën funksionale të sistemeve softëare**. (Minimumi 6 (tetë) vite përvojë profesionale)*

Kjo kërkesë vërtetohet përmes certifikimeve profesionale përkatëse ose përmes përvojës së dokumentuar në projekte të ngjashme.

*g) Minimumi **1 (një) punonjës** me profil **në testimin e sistemeve informatike**. (Minimumi 5 (pesë) vite përvojë profesionale, për realizimin e testimeve funksionale dhe teknike)*

Kjo vërtetohet përmes certifikimeve profesionale në fushën e testimit softëare ose certifikimeve ekuivalente.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit
Te gjitha certifikimet e siperpermendura duhet te jene aktive ne daten e ofertimit.
**Shënim 1: Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizma te akredituar, shqiptar ose te huaj.*
Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:
-Çertifikata për specialistët e kërkuar, te dhena nga organizma te akredituar, shqiptar ose te huaj.
-Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (çertifikimin, diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.
-Listëpagesat sipas formularit e –Sig 25 për tre muajt e fundit sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër ose te paraqiten kontrata pune me punonjes qe disponojne certifikimet e kerkuara.".

III.8.3. Në procesverbalin "*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*" të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e kriterieve kualifikuese të përcaktuara përkatësisht në pikë 2.3.1, pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 "*Kapacitetit teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit, ndërsa nuk ka argumentuar vendosjen e kritereve të vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4/A "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*PROCEDURA*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

"***Argumentimi:*** *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, si dhe specifikimet teknike. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

Në funksion të garantimit të një implementimi të suksesshëm, të qëndrueshëm dhe cilësor të kontratës, si dhe për të siguruar mirëmbajtje efektive përgjatë gjithë periudhës së parashikuar, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesa minimale për burimet njerëzore të operatorëve ekonomikë.
Këto kërkesa janë në përputhje me natyrën komplekse të projektit në fushën e teknologjisë së informacionit, i cili kërkon ekspertizë të specializuar në disa fusha të ndërlidhura (zhvillim softëare, menaxhim projekti, databaza, infrastrukturë IT, cloud, analizë biznesi dhe testim).

a) Zhvillues softëare (minimumi 3 punonjës me ≥ 7 vite eksperiencë)
Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitete të mjaftueshme teknike për zhvillimin, përshtatjen dhe integrimin e zgjidhjeve informatike.
• Numri minimal prej 3 specialistësh siguron ndarjen e punës dhe vazhdimësinë e projektit edhe në rast mungesash apo ngarkese të lartë.
• Eksperienca ≥ 7 vite garanton nivel të avancuar profesional dhe aftësi për të trajtuar sisteme komplekse.
• Kërkesa për certifikime ndërkombëtare siguron standardizim të njohurive dhe përputhje me praktikat më të mira të industrisë.
Kjo kërkesë është proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me natyrën teknike të kontratës.

b) Menaxher projekti IT (minimumi 1 me ≥ 10 vite eksperiencë)
Menaxhimi i projektit është kritik për koordinimin, respektimin e afateve dhe kontrollin e cilësisë.
• Eksperienca e gjatë (≥ 10 vite) siguron aftësi në menaxhimin e projekteve komplekse dhe shumëpalëshe.
• Certifikimet ndërkombëtare (si PMP, PRINCE2, Scrum Master) garantojnë përdorimin e metodologjive të standardizuara dhe të provuara.
Kjo kërkesë redukton rrezikun e dështimit të projektit për shkak të menaxhimit joefektiv.

c) Specialistë të databazave (minimumi 2 me ≥ 8 vite eksperiencë)
Databazat përbëjnë komponent kritik të çdo sistemi informatik, veçanërisht për sisteme institucionale.
• Numri prej 2 specialistësh siguron redundancë dhe vazhdimësi në operim.
• Eksperienca ≥ 8 vite garanton aftësi në administrimin e databazave komplekse dhe kritike.
• Certifikimet profesionale sigurojnë njohje të standardeve të industrisë dhe teknologjive të avancuara.
Kjo kërkesë është thelbësore për garantimin e integritetit, sigurisë dhe performancës së të dhënave.

d) Specialist i sistemeve operative dhe infrastrukturës IT (minimumi 1 me ≥ 8 vite eksperiencë)
Ky rol është i domosdoshëm për:
• Konfigurimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve ku do të funksionojë sistemi;
• Sigurimin e stabilitetit dhe sigurisë së infrastrukturës IT.
Eksperienca dhe certifikimet garantojnë aftësi për menaxhimin e sistemeve kritike dhe zgjidhjen e problematikave teknike..

ARGUMENTIM: *Ky profil është i domosdoshëm për të udhëhequr projektin në të gjitha fazat e tij, duke përfshirë planifikimin, koordinimin e burimeve, ndjekjen e afateve dhe menaxhimin e rreziqeve. Një menaxher projekti i çertifikuar siguron që ndërtimi i sistemit të gjobave online dhe infrastrukturës përkatëse të realizohet në mënyrë të strukturuar, efikase dhe brenda parametrave të përcaktuar të kohës dhe buxhetit.*

2.3.4 – Specialist i databazave enterprise në cloud (minimumi 1 me ≥ 8 vite eksperiencë)

Duke qenë se sistemet moderne operojnë gjithnjë e më shumë në mjedise cloud, kjo kërkesë është vendosur për të garantuar:

• Administrim profesional të databazave në mjedise të shpërndara dhe scalable;

• Siguri të lartë të të dhënave dhe përputhje me standardet moderne;

• Optimizim të performancës dhe vazhdimësi të shërbimit për sisteme kritike institucionale.

Certifikimet në teknologji enterprise (Oracle, MS SQL, PostgreSQL, etj.) sigurojnë ekspertizë të verifikueshme dhe të standardizuar.

e) Specialist në platforma cloud (minimumi 1 me ≥ 5 vite eksperiencë)

Kjo kërkesë është e domosdoshme për:

• Menaxhimin e infrastrukturës cloud (publike ose private);

• Implementimin e shërbimeve moderne dhe fleksibile;

• Sigurimin e shkallëzueshmërisë dhe vazhdimësisë së sistemeve.

Eksperienca dhe certifikimet nga ofrues të njohur ndërkombëtarisht garantojnë përdorimin korrekt të teknologjive cloud.

f) Analist biznesi / analist funksional (minimumi 1 me ≥ 6 vite eksperiencë)

Ky rol është thelbësor për:

• Përkthimin e kërkesave të institucionit në specifikime teknike;

• Sigurimin që sistemi i zhvilluar i përgjigjet realisht nevojave të përdoruesve.

Eksperienca në projekte të ngjashme siguron kuptim të proceseve dhe rrit cilësinë e zgjidhjes finale.

g) Specialist testimi (minimumi 1 me ≥ 5 vite eksperiencë)

Testimi është fazë kritike për garantimin e cilësisë dhe funksionalitetit të sistemit.

• Siguron identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve përpara implementimit;

• Redukton rrezikun e dështimeve gjatë përdorimit në praktikë.

Certifikimet në testim softëare garantojnë përdorimin e metodologjive standarde të sigurimit të cilësisë.".

III.8.4. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" ShPK autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*" ka shqyrtuar këto pretendime të ankimuesit si në vijim: "***Përgiigje mbi ankesën e pikës Nr. 11***

(Metodologjia e vlerësimit dhe kriteret për përcaktimin e ofertës fituese)

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Idealdevs Corporation mbi metodologjinë e vlerësimit të ofertave dhe kriteret për përcaktimin e ofertës fituese, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa duhet trajtuar në mënyrë të diferencuar për secilin element të ngritur, pasi një pjesë e pretendimeve nukqë, ndërsa një pjesë tjetër kërkon saktësim për efekt transparence.

Sa i përket pretendimit se metoda e përzgjedhjes "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto" është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim nuk qëndron në thelb. Nga Dokumentet e Tenderit rezulton se janë përcaktuar qartë kriteret kryesore të vlerësimit, përkatësisht çmimi, eksperienca e ngiashme, metodologjia dhe stafi teknik, si dhe pesha përkatëse e tyre në total prej 100 pikësh, në përputhje me nenin 45 të VKM nr. 285/2021 dhe ligjin nr. 162/2020.

Po ashtu, për kriterin e çmimit është përdorur formula standarde për kriteret me trend zbritës, e cila përbën praktikë të konsoliduar në procedurat e prokurimit publik. Në këtë kuptim, çdo ofertues që paraqet çmimin më të ulët përfiton pikët maksimale, ndërsa ofertat e tjera pikëzohen proporcionalisht.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se formulimi aktual mund të përmirësohet në drejtim të qartësimit të elementëve të formulës së çmimit, duke specifikuar se treguesi i ofertës për këtë kriter është vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH, me qëllim shmangien e çdo interpretimi të mundshëm.

Sa i përket referencave të përdorura në DST, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disa elementë kërkojnë harmonizim me natyrën e kontratës dhe për këtë arsye do të bëhen korrigjimet përkatëse për efekt qartësie.

Në lidhje me nënkriterin "Eksperienca e ngjashme", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është në përputhje me qëllimin për të diferencuar cilësinë e ofertave përtej minimumit kualifikues. Megjithatë, konstatohet se formulimi i tij kërkon saktësim neë drejtim të përcaktimit të treguesve dhe mënyrës së përllogaritjes së pikëve, si dhe neë dallimin midis kriterit kualifikues dhe atij vlerësues.

Sa i përket nënkriterit "Metodologjia e propozuar", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, por pranon se disa elementë të formulimit mund të krijojnë mbivendosje me kriterin e stafit teknik dhe hapësirë për interpretim.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor do të bëjë riformulimin përkatës të këtij nënkriteri, duke saktësuar elementët e vlerësimit dhe duke kufizuar diskrecionin në përputhje me parimet e transparencës dhe objektivitetit.

Në lidhje me nënkriterin "Eksperienca e stafit teknik", Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter është thelbësor për natyrën e kontratës, por konstatohet se terminologjia dhe struktura e tij kërkojnë harmonizim me kriteret kualifikuese dhe saktësim të mëtejshëm.

Tenderit, me qëllim qartësimin e plotë të këtij kriteri dhe garantimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Përfundim

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se metodologjia e përzgjedhjes së ofertës fituese është në thelb në përputhje me legjislacionin në fuqi, por pranon se disa elementë të saj kërkojnë saktësim dhe përmirësim për efekt transparence dhe qartësie.

Pëer rrjedhojë, ankesa nr. 11 pranohet pjesëerisht, duke u reflektuar pëermes modifikimeve pëerkatëse nëe Dokumentet e Tenderit, pa cëenuar thelbin e procedurëes.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se procedura eshtë zhvilluar në perputhje me legjislacionin në fugi dhe parimet e prokurimit publik.Kerkohet nga Komisioni i Prokurimit Publik rrêzimi i pretendimeve të pabazuara dhe marrja në konsiderate saktesimet e reflektuara.", duke mos i pranuar këto pretendime të ankimuesit, ndërsa lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" ShPK autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1329/19 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "KREATX" SHPK*" ka shqyrtuar këto pretendime të ankimuesit si në vijim: "***Përgjigje mbi ankesën e pikës Nr. 3***

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik Kreatx SHPK mbi metodologjinë e vlerësimit të ofertave dhe kriteret për përcaktimin e ofertës fituese, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa duhet trajtuar në mënyrë të diferencuar për secilin element të ngritur, pasi një pjesë e pretendimeve nuk qëndrojëne, ndërsa një pjesë tjetër kërkon saktësim për efekt transparence.

Sa i përket pretendimit se metoda e përzgjedhjes "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto" nuk është e qartë dhe bie ndesh me nenin 45 të RRPP, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kjo nuk qëndron në thelb. Nga DST rezulton se janë përcaktuar qartë katër kriteret kryesore të vlerësimit, përkatësisht çmimi, eksperienca e ngjashme, metodologjia dhe stafi teknik, si dhe pesha përkatëse e tyre në total prej 100 pikësh, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Po ashtu, për kriterin e çmimit është përdorur formula standarde e parashikuar në nenin 45 të RRPP për kriteret me trend zbritës, e cila është praktike e konsoliduar në procedurat e prokurimit publik.

Pretendimi se nuk kuptohet zbatimi i formulës për çmimin nuk qëndron në aspektin metodologjik, pasi "vlera më e uleët" (Vmin) dhe "treguesi i ofertes" (Okn) janë elementë standartë të formulës dhe i referohen drejtpërdrejt vlerës totale të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatorët ekonomike. Në këtë kuptim, çdo ofertues që paraqet çmimin më të ulët përfiton pikët maksimale, ndërsa ofertat e tjera pikëzohen proporcionalisht, çka është në përputhje me praktikën e ndjekur gjërësisht.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se formulimi aktual në DST mund të përmirësohet në drejtim të qartësimit eksplicit të këtyre elementëve, duke specifikuar se treguesi i ofertës për kriterin e çmimit është vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH, me qëllim shmangien e çdo interpretimi të mundshëm nga operatorët ekonomikë.

Në lidhje me referimin ndaj VKM nr. 354/2016 në shenimin poshtë formulës së cmimit, Autoriteti Kontraktor pranon se ky referim nuk është i përshtatshëm për natyrën e kësaj kontrate dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Për rrjedhojë, ky element do të korrigjohet për efekt harmonizimi të dokumentacionit.

Sa i përket nënkriterit "Eksperienca e ngjashme", Autoriteti Kontraktor vlerëson se parimi i përdorur është i drejtë dhe në përputhje me qëllimin për të identifikuar ofertën me cilësore, duke diferencuar operatorët mbi bazën e eksperiencës përtej minimumit kualifikues. Megjithatë, konstatohet se formulimi i treguesit të ofertës dhe mënyra e përllogaritjes së pikëve nuk është paraqitur me qartësi të plotë, si dhe ekziston një paqartësi midis kriterit kualifikues dhe kriterit të vlerësimit me pikë.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme të bëjë saktësimin përkatës në DST, duke përcaktuar qartë çfarë konsiderohet "eksperiencë e ngjashme" për efekt vlerësimi me pikë, mënyrën e llogaritjes së treguesit të ofertës për këtë kriter, si dallimin midis minimumit kualifikues dhe elementëve që sjellin pikë shtesë.

Në lidhje me nënkriterin "Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit", Autoriteti Kontraktor vlerëson se struktura e këtij kriteri është në përputhje me praktikat vlerësimit cilësor, por pranon se disa elementë të tij mund të krijojnë mbivendosje me kriterin e stafit teknik, veçanërisht në pjesën që lidhet me organizimin dhe përshkrimin e stafit.

Gjithashtu, disa elementë të formulimit, si "qartësia në interpretimin e objektit" apo "mjetet dhe teknikat e propozuara", mund të përmirësohen për të reflektuar më saktë natyrën e kontratës, e cila lidhet me zgjidhje teknologjike dhe jo me punë fizike.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson të arsyeshme të rishijojë këtë nënenkriter, duke shmangur mbivendosjen me kriterin e stafit teknik, riformuluar elementët e vlerësimit në mënyrë më të qartë dhe të matshme, si dhe kufizuar diskrecionin e vlerësimit në përputhje me parimin e transparencës.

Sa i përket nënkriterit "Eksperienca e stafit teknik", Autoriteti Kontraktor vlerëson se qëllimi i këtij kriteri është i drejtë dhe në përputhje me nevojën për të garantuar kapacitetet profesionale për zbatimin e kontratës. Megjithatë, konstatohet se terminologjia e përdorur në DST nuk është plotësisht e harmonizuar me kriteret kualifikuese, duke krijuar paqartësi për operatorët ekonomikë.

Në veçanti, përdorimi i termit "drejtues projekti" në vend të "menaxher projekti", mungesa e një perkufizimi të qartë për "stafin teknik kryesor", si dhe mungesa e ndarjes së qartë të pikëzimit midis eksperiencës së përgithshme dhe asaj specifike, janë elementë që kërkojnë saktësim.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor do të bëjë përmirësimet përkatëse në DST, me qëllim qartësimin e plotë të këtij kriteri dhe garantimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në peërfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se metodologjia e përzgjedhes së ofertës fituese është në thelb në përputhje me legjislacionin në fuqi, por pranon se disa elementë të saj kërkojnë saktësim dhe përmirësim për efekt transparence dhe qartësie. Për rrjedhojë, ankesa merret piesërisht në konsideratë, duke u reflektuar përmes modifikimeve përkatëse në dokumentet e tenderit, pa cënuar thelbin e procedurës.", duke mos i pranuar këto pretendime të ankimuesit.

III.8.5. Në Nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar parashikohet se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.".

Ndërsa në Nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.8.6. Në Nenin 21 *"Autoriteti ose enti kontraktor*" të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*
Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.".

III.8.7. Në Nenin 77 "*Kërkesat për kualifikim*", pika 4, të ligjit nr.162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*.".

III.8.8. Në nenin 87 të ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar parashikohet se:

"*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*
2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kritere të tilla mund të përfshijnë:
a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;
b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose
c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:
a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose
b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.
4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.
5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.".

III.8.9. Në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet se:

"*5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.".

III.8.10. Në nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar parashikohet se:

"*1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*
2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të

LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Në rastin kur, oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____Pikët e kriterit që vlerësohet Vmink1 Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

Pk1= Ok1 x Pmaxk1 /Vmax k1

Vmaxk1_____Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

Pmaxk1 _____Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik.

Formula e llogaritjes është: Oferta më e mirë = X + Y

Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)

Pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit;

ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;

iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kritereve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për propozimin ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)
Pe = 100 x Çu / Ç (çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik).".

III.8.11. Nga shqyrtimi i Shtojcës 8 "*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*të dokumentave të tenderit dhe konkretisht i kriteret kualifikuese të përcaktuara përkësisht në pikën 2.3.1, pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 "*Kapaciteti teknik*" të këtyre dokumentave, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues që të kualifikohen duhet që lidhur me përvojën e mëparshme të dëshmojnë që kanë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit në vlerën 40% të vlerës së përllogaritur të fondit limit të procedurës së prokurimit, ku në fazën e ofertimit për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të dorëzojnë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të realizuara në rastin e shërbimeve të ngjashme të realizuara me ente publike, ndërkohë që në rastin e realizimit të shërbimeve të ngjashme të realizuara me subjekte private duhet dorëzojnë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të realizuara, ndërsa lidhur me kapacitetin teknik duhet që të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre **3 (tre) punonjës me aftësi profesionale për "*zhvillimin e zgjidhjeve informatike*"**, **1 (një) punonjës me aftësi profesionale për "*menaxher te projekteve IT*", 2 (dy) punonjës me aftësi profesionale për "*me profil në administrimin dhe/ose implementimin e sistemeve të menaxhimit të bazave të të dhënave*"**, **1 (një) punonjës me aftësi profesinale për "*me profil administrimin e sistemeve operative dhe infrastrukturës IT*"**, **1 (një) punonjës me aftësi profesionale për "*specialist në administrimin e databazave enterprise në mjedise cloud*"**, **1 (një) punonjës me aftësi profesionale për "*me profil në përdorimin dhe/ose administrimin e platformave cloud*"**, **1 (një) punonjës me aftësi profesinale për "*me profil në analizën e biznesit dhe/ose analizën funksionale të sistemeve softëare*"** dhe 1 (një) punonjës me aftësi profesionale për "*me profil në testimin e sistemeve informatike*", ku në fazën e ofertimit për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Shtojcën 9 "*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*" pjesë e dokumentave të tenderit, ndërkohë që ofertuesi i kualifikuar i pari përpara shpalljes së njoftimit të fituesit paraprak duhet të paraqesë certifikatat përkatëse.
Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 4.4/A "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*PROCEDURA*" të dokumentave të tenderit ka përcaktuar kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, duke përcaktuar si kriter vlerësimi metodën "*Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto*", duke përcaktuar 4 (katër) kritere vlerësimi dhe konkretisht kriterin e vlerësimit "*Çmimi*", kriterin e vlerësimit "*Eksperienca e ngjashme e kompanisë*", kriterin e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t" dhe kriterin e vlerësimit "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*".

Për më tëpër, lidhur me këto kritere vlerësimi, Komisioni konstaton si më poshtë vijon:
- Për kriterin e vlerësimi "*Çmimi*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se pikët maksimale për këtë kriter vlerësimi do të jenë 50, ku pikët maksimale do ti marrë operatori ekonomik ofertues i kualifikuar i cili ka dorëzuar ofertën ekonomike me vlerë më të ulët, ndërsa operatorët e tjerë ofertues të kualifikuar do të marrin më pak pikë sipas formulës së publikuar në raport me vlerën e ofertës ekonomike të operatorit ekonomik të kualifikuar i pari, sikurse përcaktohet në nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
- Për kriterin e vlerësimit "*Eksperienca e ngjashme e kompanisë*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se pikët maksimale për këtë kriter vlerësimit do të jenë nga 0 (zero) deri në 10 (dhjetë) pikë, ku pikët maksimale do ti marrë ai operator ekonomik ofertues i kualifikuar, i cili fillimisht përmbush kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 *"Kapaciteti teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*të dokumentave të tenderit, si dhe që ka realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit shërbime të ngjashme në vlerë më të madhe në krahasim me shërbimet e ngjashme të realizuara nga operatorët e tjerë ofertues të kualifikuar, ndërsa operatorët e tjerë ofertues të kualifikuar do të marrin më pak pikë sipas formulës së publikuar në raport me vlerën e shërbimeve të ngjashme të operatorit ekonomik që ka realizuar shërbime të ngjashme në vlerën më të madhe, sikurse përcaktohet në nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
- Për kriterin e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se pikët maksimale për këtë kriter vlerësimi do të jenë nga 0 (zero) deri në 10 (dhjetë) pikë, por këtë kriter vlerësimi autoriteti kontraktor e ka ndarë në disa nënkritere dhe konkretisht, nënkriteri "*Përqasja teknike dhe metodologjia*", nënkriteri "*Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit*", nënkriteri "*Organizimi dhe Stafi*", nënkriteri "*Kuptimi i detyrës*", nënkriteri "*Organizimi i punës*", nënkriteri "*Metodat teknike*" dhe nënkriteri "*Menaxhimi i riskut*".
1. Për nënkriterin "*Përqasja teknike dhe metodologjia*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si në vijim: "*Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).*", duke mos përcaktuar pikët me të cilat duhet të vlerësohet ky nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar formulën nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
2 .Për nënkriterin "*Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si në vijim: "*Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjetjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret.*

Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave te Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull", duke mos përcaktuar pikët me të cilat duhet të vlerësohet ky nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar formulën nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

3. Për nënkriterin "*Organizimi dhe Stafi*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si në vijim: "*Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ*", duke mos përcaktuar pikët me të cilat duhet të vlerësohet ky nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar formulën nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

4. Për nënkriterin e vlerësimit "*Kuptimi i detyrës*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky nëkriter do të vlerësohet nga 0 (zero) deri në 3 (tre) pikë, por nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si dhe nuk ka përcaktuar formulën përkatëse me të cilën do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të kusalifikuar sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

5. Për nënkriterin e vlerësimit "*Organizimi i punës*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky nëkriter do të vlerësohet nga 0 (zero) deri në 3 (tre) pikë, por nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si dhe nuk ka përcaktuar formulën përkatëse me të cilën do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të kusalifikuar sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

6. Për nënkriterin e vlerësimit "*Metodat teknike*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky nëkriter do të vlerësohet nga 0 (zero) deri në 2 (dy) pikë, por nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si dhe nuk ka përcaktuar formulën përkatëse me të cilën do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të kusalifikuar sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

7. Për nënkriterin e vlerësimit "*Menaxhimi i riskut*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky nëkriter do të vlerësohet nga 0 (zero) deri në 2 (dy) pikë, por nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit, si dhe nuk ka përcaktuar formulën përkatëse me të cilën do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të kusalifikuar sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

- Për kriterin e vlerësimit "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se pikët maksimale për këtë kriter vlerësimi do të jenë nga 0 (zero) deri në 30 (tridhjetë) pikë, por këtë kriter vlerësimi autoriteti kontraktor e ka ndarë në disa nënkritere dhe konkretisht, nënkriteri "*Organizimi dhe Stafi*", nënkriteri "*Drejtuesi i projektit*", nënkriteri "*Stafi teknik kryesor*", nënkriteri "*Kualifikim i përgjithshëm*" dhe nënkriteri "*Eksperienca në fushën përkatëse*".

1. Për nënkriterin "*Organizimi dhe Stafi*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si në vijim: "*Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ*", duke mos përcaktuar

pikët me të cilat duhet të vlerësohet ky nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar formulën nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

2. Për nënkriterin e vlerësimit "*Drejtuesi i projektit*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky nënkriter do të vlerësohet me 15 (pesëmbëdhjetë) pikë, ku drejtuesi i projektit me ekperiencë punë mbi 3 (tre) vite mbi kriterin minimal do të vlerësohet me 5 (pesë) pikë, ku drejtuesi i projektit me eksperiencë pune nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) vite pune mbi kriterin minimal do të vlerësohet me 10 (dhjetë) pikë, ku drejtuesi i projektit me eksperiecë pune mbi 5 (pesë) vite pune mni kriterin minimal do të vlerësohet me 15 (pesëmbëdhjetë) pikë, por nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit, si dhe nuk ka përcaktuar formulën përkatëse me të cilën do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të kusalifikuar sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

3. Për nënkriterin e vlerësimit "*Stafi teknik kryesor'*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky nënkriter do të vlerësohet me 15 (pesëmbëdhjetë) pikë, ku stafi kryesor me ekperiencë punë mbi 2 (dy) vite mbi kriterin minimal do të vlerësohet me 2 (dy) pikë, ku stafi kryesor me eksperiencë pune nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) vite pune mbi kriterin minimal do të vlerësohet me 3 (tre) pikë, ku stafi kryesor me eksperiecë pune mbi 5 (pesë) vite pune mbi kriterin minimal do të vlerësohet me 5 (pesë) pikë, por nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit, si dhe nuk ka përcaktuar formulën përkatëse me të cilën do të vlerësohen operatorët ekonomikë ofertues të kusalifikuar sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

4. Për nënkriterin "*Kualifikim i përgjithshëm*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si në vijim: "*Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës*", duke mos përcaktuar pikët me të cilat duhet të vlerësohet ky nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar formulën nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

5. Për nënkriterin "*Eksperienca në fushën përkatëse*" autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit si në vijim: "*Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor*", duke mos përcaktuar pikët me të cilat duhet të vlerësohet ky nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar formulën sipas përcaktimeve të nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

III.8.12.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK si në vijim: "*Për këto arsye, kërkojmë përfundimisht që KSHA dhe KPP të ndërhyjnë për të ndryshuar metodologjinë e vlerësimit, duke e orientuar atë drejt kriterit "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim*", Komisioni gjykon se nuk qëndron, pasi referuar parashikimeve të nenin 87 të ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar dhe parashikimeve të nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar,

metodologjia e vlerësimit "*Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto*" është një metodologji e parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik dhe se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të zgjedhë njërën ga metodat e vlerësimit të përcaktuara në dispozitat e sipërpërmendura.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK nuk qëndrojnë.

III.8.12.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK si në vijim: "*Nga sa më sipër, edhe pse AK ka përdorur formulën e përcaktuar në nenin 45 të RRPP, Kreatx SHPK vëren se nuk ka shpjeguar mënyrën sesi do të zbatohet në praktikë kjo formulë dhe cilat do të jenë elementët e vlerësueshëm praktikisht për çmimin, kur në fakt ofertuesit do të depozitojnë një ofertë ekonomike me një çmim të vetëm. ... Formula e përdorur për të përcaktuar peshën me pikë të çmimit të ofertave të OE nuk është e qartë sesi do të zbatohet në praktikë, pasi nuk kuptohet sesi do të vlerësohet/përcaktohet "vlera më e ulët të kriterit që vlerësohet" dhe "treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet". ... Gjithashtu, AK ka gabuar në raport me llojin e prokurimit dhe legjislacionin e zbatueshëm edhe sa i takon shënimit të vendosur poshtë formulës së pikëzimit të çmimit. Në këtë shënim, AK shprehet se, oferta duhet të hartohet në përputhje me VKM nr.354, datë 11.05.2016, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit, por ky akt nënligjor nuk parashikon rregulla të zbatueshme për mallrat dhe shërbimet. Akti nënligjor përcakton rregulla të zbatueshme për përllogaritjen e vlerës së mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të punëve publike ndërtimore dhe jo për kontratën objekt prokurimi publik. Pra, edhe në këtë drejtim, AK ka gabuar për hartimin e DST, duke vepruar ndesh me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi. Në këtë mënyrë, është i nevojshëm modifikimi i DST. ... Pikëzimi për nënkriterin e përvojës së ngjashme me formulën e mësipërme nuk është gjithashtu i qartë për ofertuesit. ... Të gjitha paqartësitë më lart për vlerësimin e përvojës së ngjashme, sjellin konfuzion për OE dhe e bëjnë prokurimin publik jotransparent, në kundërshtim me sa përcakton LPP. Për pasojë, nevojitet modifikimi i DST nga AK lidhur me kriteret dhe nënkriteret e përcaktimit të ofertës fituese. ... Pra, në një DST, AK nuk mund të pikëzojë dy herë të njëjtin kapacitet të OE ofertues në dy nënkritere të ndryshme, një herë tek pjesa e personelit dhe një herë tek pjesa e metodologjisë së shërbimit. Kjo situatë sjell konfuzion për ofertuesit e interesuar, për sa kohë që pikëzimi për të njëjtën gjë është i ndryshëm. Prandaj, DST janë të paqarta. Në këtë drejtim, pjesa e vlerësimit me pikë të stafit të OE ofertues duhet të grupohet e gjitha tek nënkriteri i katërt dhe jo të ndahet në dy nënkriteret nr.3 dhe nr.4. Po kështu, elementët e formulës së vlerësimit për metodologjinë e shërbimit janë të paqarta dhe i lejojnë hapësirë të pakufizuar vlerësimi diskrecional AK që t`a shtrijë pikëzimin për secilin OE ofertues sipas dëshirës së tij.*
Elementi "Qartësia në interpretimin e objektit të kontratës", që vlerësohet me tre pikë, nuk kuptohet së për çfarë bën fjalë, ndërkohë që objekti i kontratës dhe specifikimeve teknike është i tejet qartë sepse prokurimi synon krijimin/blerjen e një sistemi për menaxhimin financiar të Bashkisë Himarë. Për rrjedhojë, ky element duhet të hiqet nga vlerësimi me pikë në metodologjinë e shërbimit, pasi është i pakuptimtë.

Elementi "Mjetet dhe teknikat e propozuara" gjithashtu është konceptuar në mënyrë të pasaktë nga AK, pasi në këtë kontratë prokurimi nuk përdoren mjete pune, por vetëm teknologji dhe zgjidhje softëareike. Për rrjedhojë, edhe ky element i vlerësueshëm me pikë duhet të ndryshohet nga AK në DST. ... Në lidhje me nënkriterin nr.4 të stafit teknik të propozuar, Kreatx SHPK çmon se mënyra sesi është formuluar ky nënkriter është totalisht i paqartë për disa arsye:

1. Nuk kuptohet sesi do të shpërdahet pikëzimi nga AK për stafin, në raport me përvojën e përgjithshme dhe përvojën në fushën e posaçme. Pra, sa pikë do të vlerësohet përvoja e përgjithshme dhe me sa pikë do të vlerësohet ajo në fushën e posaçme ?

2. Nuk kuptohet se cila është përvoja në fushën e posaçme. AK duhet t`a kishte specifikuar në DST se cila është përvoja në fushën e posaçme, duke qartësuar kështu OE ofertues.

3. AK vlerëson deri në 15 pikë drejtuesin e projektit, por se çfarë përfshin termi "drejtuesi i projektit" është i paqartë dhe nuk identifikohet askund në DST. Theksojmë se, në shtojcën nr.9, pika 2.3.3 të DST, AK ka kërkuar që OE ofertues të disponojnë menaxher projektit dhe jo drejtues projekti. Për rrjedhojë, AK duhet të modifikojë DST duke zëvendësuar tek nënkriteri i 4 termin "drejtuesi i projektit" me menaxherin e projektit.

4. AK vlerëson deri në 15 pikë stafin kryesor teknik, por se çfarë përfshin togfjalëshi "staf kryesor teknik" nuk është i qartë, pasi nuk identifikohet askund në DST. Theksojmë se, në shtojcën nr.9, pika 2.3.3 të DST, AK ka kërkuar që OE ofertues të disponojnë të paktën 10 punonjës dhe 11 persona si personel të certifikuar. Për pasojë, edhe togfjalëshi "staf kryesor teknik" duhet të përcaktohet saktë nga AK mbi bazën e personelit të certifikuar sipas kritereve kualifikuese të shënuara në pikën 2.3.3 të shtojcës nr.9 të DST. AK duhet të specifikojë në DST se cili konsiderohet stafi kryesor teknik mes 11 personave të certifikuar që u kërkon OE ofertues si kriter kualifikues. Kjo gjë siguron transparencën e prokurimit publik, paraqitjen e ofertave ekonomike në përputhje me DST.

5. Në të gjithë argumentimin e dhënë për personelin që duhet të ketë OE ofertues për efekt të vlerësimit me pikë, AK i referohet termave si punime për punë publike dhe mbikëqyrje të tyre, duke u bazuar tek kontratat e punëve publike, ndryshe nga rasti objekt prokurimi që lidhet me prokurimin e mallrave dhe shërbimeve. Pra, duket qartë se AK ka proceduar me DST nga një procedurë e mëparshme prokurimi për punë publike. Për rrjedhojë, AK duhet të modifikojë DST dhe t`i qartësojë ato në raport me shërbimet që kërkon nga OE. ... AK nuk ka përcaktuar qartë as pikët që do të ketë çdo kriter dhe as mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 45 të RRPP. AK, nuk i është referuar as Udhërrëfyesit të APP "Mbi përdorimin nga autoritetet kontraktore të kriterit të vlerëismit Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto", që gjendet i publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Për pasojë, modifikimet e DST duhet të bëhen nga AK jo vetëm për efekt të qartësimit të OE ofertues, por edhe për efekt të zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra nga APP.", Komisioni konstaton se për kriteret e vlerësimit "Çmimi" dhe "Eksperienca e ngjashme e kompanisë" autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit, si dhe formulën përkatëse sipas përcaktimeve të nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

Lidhur me kriteret e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t" dhe "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*" Komisioni konstaton se:

1. Për kriterin e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t", nënkriteret e vlerësimit "*Përqasja teknike dhe metodologjia*", "*Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit*" konstatohet se këto nënëkritere vlerësimi nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, pasi metodologjia e vlerësimit të këtyre nënëkritereve i referohet një lloji tjetër procedure prokurimi dhe konkretisht llojit të procedurës së prokurimit "Shërbim" dhe jo llojit të procedurës së prokurimit object ankimi "Mallra".

2. Për kriterin e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t", nënkriteret e vlerësimit "*Organizimi dhe Stafi*", Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar pikët me të cilët do të vlerësohet ky nënëkriter dhe për më tepër ky nënkriter është i dubluar, pasi konstatohet se është i përcaktuar në kriterin tjetër të vlerësimit dhe konkretisht në kriterin e vlerësimit "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*".

3. Për kriterin e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t", nënkriteret e vlerësimit "*Kuptimi i detyrës*", "*Organizimi i punës*", "*Metodat teknike*" dhe "*Menaxhimi i riskut*", Komisioni konstaon se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar vendosjen e këtyre nënkritereve të vlerësimit në raport me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit dhe për më tepër nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit, si dhe formulën përkatëse (*me trend rritës ose zbritës*) sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

4. Për kriterin e vlerësimit "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*", nënkriteri i vlerësimit "*Organizimi dhe Stafi*", Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit të këtij nënkriteri, pork y nënëkriter i referohet një lloji tjetër procedure prokurimi dhe konkretisht llojit të procedurës së prokurimit "Shërbim" dhe jo llojit të procedurës së prokurimit object ankimi "Mallra" dhe për më tepër nuk ka përcaktuar pikët me të cilat duhet të vlerësohet ky nënkriter, si dhe nuk ka përcaktuar formulën sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar..

5. Për kriterin e vlerësimit "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*", nënkriteret e vlerësimit "*Drejtuesi i projektit*" dhe "*Stafi teknik kryesor"* nuk i referohen stafit teknik të përcaktuar në kriteret kualifikuese të pikës 2.3.3 dhe pikës 2.3.4 "*Kapaciteti teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT* të dokumentave të tenderit, nuk ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit dhe formulën përkatëse për vlerësimin me pikë të këtyre nënëkritereve sipas përcaktimeve sipas përcaktimeve të nenit 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

6. Për kriterin e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t", nënkriteret e vlerësimit "*Kualifikim i përgjithshëm*" dhe "*Eksperienca në fushën përkatëse*" autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar pikët me të cilat duhet të vlerësohen këto nënkritere vlerësimi, si dhe nuk ka përcaktuar

formulën sipas përcaktimeve të nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se pretendimet e ankimuesit lidhur me kriteret e vlerësimit "*Çmimi*" dhe "*Eksperienca e ngjashme e kompanisë*" nuk qëndrojnë, pasi për këto kritere vlerësimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar metodologjinë e vlerësimit, si dhe formulën përkatëse sipas përcaktimeve të nenin 45 "*Kriteret për shpalljen e ofertës fituese*" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, ndërsa lidhur me pretendimet e ankimuesit për kriteret e vlerësimit, "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t" dhe "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*", Komisioni gjykon se këto pretendime qëndrojnë, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e pikës 4.4/A "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*PROCEDURA*" të dokumentave të tenderit, duke modifikuar kriterret e vlerësimit "*Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimi*t" dhe "*Eksperienca e stafit teknik të propozuar*" sipas pretendimeve të mësipërme të operatorit ekonomik annkimues "*KREATX*" SHPK.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK qëndrojnë pjesërisht.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.1**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,,

III.9.1. Në Seksionin 2 "*Objekti i kontratës*" pika 2.2 "*Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): *Paketa softëare dhe sisteme informacioni* ***48000000-8***

III.9.2. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 457, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit*" parashikohet:

FJALORI I PËRBASHKËT I PROKURIMIT
LISTA E KODEVE CPV

Shpjegime dhe përshkrime: Fjalori i Përbashkët i Prokurimit është i bazuar në një strukturë bazë, që përfshin kode deri në nëntë shifra, të shoqëruara me një formulim që përshkruan mallrat, punët ose shërbimet, të cilat janë objekt i një procedure prokurimi. Në çdo rast, për zhvillimin e një procedure prokurimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të përzgjedhin detyrimisht në sistemin e prokurimit elektronik një prej kodeve të përcaktuara që i korrespondon objektit konkret të prokurimit. Kodi numerik përbëhet nga 9 shifra, të ndara si më poshtë: - dy shifrat e para identifikojnë ndarjet

(XX000000-Y); - tri shifrat e para identifikojnë grupet (XXX00000-Y); - katër shifrat e para identifikojnë klasat (XXXX0000-Y); - pesë shifrat e para identifikojnë kategoritë (XXXXX000-Y). Secila prej tri shifrave të fundit ofron një shkallë më të madhe saktësie brenda secilës kategori. Shifra e nëntë shërben për të verifikuar shifrat e mëparshme

KODI CPV EMËRTIMI I KODIT CPV

48000000-8 Paketa softëare dhe sisteme informacioni

III.9.3. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."
Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.9.4. Neni 21 pika 1 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" i ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj*.".

III.9.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit dhe konkretisht i pikës 2.2 "*Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)*" të Seksionit 2 "*Objekti i kontratës*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka publikuar kodin CPV të objektit të procedurës së prokurimit objekt ankimi si dhe emërtimin si në vijim: "*Paketa softëare dhe sisteme informacioni*", ku referuar listës së kodeve CPV të publikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 457, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit*".

Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues, i cili shprehet si në vijim:

"*... Mosparaqitja e informacionit përkatës në dokumentacionin e procedurës krijon kushte që operatorët ekonomikë (OE) të kufizohen ose të përjashtohen në mënyrë të pajustifikuar nga pjesëmarrja, duke ngritur një dyshim të arsyeshëm se Autoriteti Kontraktor ka ndërmarre veprime që sjellin kufizim artificial të konkurrencës, në kundërshtim me parimet themelore të barazisë, transparencës dhe mosdiskriminimit në prokurimet publike.*

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor ka cënuar të drejtat e OE-ve për informim të plotë dhe të saktë, duke mos ofruar qartësi të mjaftueshme mbi kërkesat e procedurës. Mungesa e publikimit të kodit përkatës dhe e elementëve të tjerë thelbësore kufizon mundësinë e OE-ve për të vlerësuar dhe ushtruar të drejtën e tyre për pjesemarrje në përputhje me objektin e aktivitetit të tyre.

Në të njëjtën kohë, kjo mungesë transparence prek edhe interesin e publikut dhe të individeve të tjerë ëte interesuar për të marrë informacion mbi procedurat e prokurimit, duke cënuar standardet ligjore të publikimit të saktë dhe të plotë të informacionit sipas legjislacionit në fuqi.

Sa më lart kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor:

Kërkesa 1.1

Përcaktimin e kodeve FPP të saktë relevant me këtë procedurë prokurimi, sipas parashikimeve ligjore.

Kërkesa 1.2

KPP të detyrojë AK mbi këtë të fundit pasi kjo ngushtësisht kufizon operatorët ekonomikë pjesëmarres dhe dëmton konkurecën.", Komisioni gjykon se këto pretendime të ankimuesit nuk qëndrojnë, pasi në pikën 2.2 "*Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)*" të Seksionit 2 "*Objekti i kontratës*" të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar kodin CPV "*48000000-8 Paketa softëare dhe sisteme informacioni*", kod i cili është i parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 457, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit*" dhe përshkruan objektin e prokurimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, i cili është zhvillimi, instalimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore te Bashkise Himarë, ku ky system në vetvete është një paketë softëerike dhe për më tepër Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk argumenton se si përcaktimi i këtij kodi kufizon konkurëncën dhe krijon paqartësi të mjaftueshme mbi kërkesat e procedures, ndërkohë që kjo procedurë prokurimi është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) dhe secili operator ekonomik i interesuar mund të njihet me dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit dhe mund të dorëzojë ofertë në mënyrë elektronike në këtë system.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK nuk qëndrojnë.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.1** dhe në kërkesën **nr. 2**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6524, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1133/2026 prot., datë 14.04.2026, si dhe lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.8**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6521, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1132/2026 prot., datë 14.04.2026,Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.10.1. Në Seksionin 2 "*Objekti i kontratës*" pika 2.3 "*Lloji*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

2.*3 Lloji i "Kontratës Publike për furnizim"*

Blerje	*Marrje me qira*	*Blerje me këste*	*Një kombinim i tyre*
X	□	□	□

III.10.2. Në Seksionin 2 "*Objekti i kontratës*" pika 2.11 "*Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja ***në muaj 6 (gjashtë) ose ditë _____ ditë***

Ose

Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

III.10.3. Në Seksionin 4 "*Procedura*" pika 4.2 "*Është përdorur njoftimi paraprak/periodik i informacionit*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

4.2. Është përdorur njoftimi paraprak/periodik i informacionit:

Po	□	***Jo***	***X***

Nëse Po, numri i referencës është _____

III.10.3. Në Shtojcën 7 "*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës

Artikulli	***Përshkrimi***	***Shuma***	***Destinacioni***	***Periudha e dorëzimit***

III.10.4. Në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi. autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Objektivi kryesor *është implementimi i një sistemi informatik të sigurt, i cili* ***duhet të*** *automatizojë ciklin e plotë të administrimit të taksave dhe tarifave vendore. Rezultati i dëshiruar është një platformë e matshme që rrit efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave si me poshte:*

...

Operatori Ekonomik OE duhet të realizojë ecurinë e punës sipas fazave të mëposhtme:

1. ***Analiza dhe Migrimi i të Dhënave:*** *OE* ***duhet të*** *kryejë analizën e bazës ekzistuese të të dhënave dhe të realizojë migrimin e tyre drejt mjedisit te databazes pa humbje informacioni.*
2. ***Zhvillimi i Moduleve Funksionale:*** *OE* ***duhet të*** *zhvillojë të gjitha modulet e kërkuara Referencat, Subjektet, Detyrimet, Likujdimet, Raportet dhe Importet.*
3. ***Integrimi me Platformat e Ndërveprimit:*** *Sistemi* ***duhet të*** *integrohet me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit përmes ESB-së, si dhe me sistemet e AKSHI-t, Sistemi qendror i Tatimeve, QKB dhe bankave te nivelit te dyte etj.*
4. ***Testimi dhe Trajnimi:*** *Kryerja e testimit të pranimit (UAT) dhe trajnimi i stafit te drejtorive perkatese.*
5. ***Mirembajtja***

   Mirëmbajtja do të fokusohet në:

- *Përditësimin e sigurisë së serverëve Cloud.*
- *Monitorimin 24/7 të performancës së API-ve për ndërveprimin me institucionet e tjera*

*Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit **duhet të** jetë për një periudhë 1-vjeçare (12 muaj). Mirëmbajtja do të përfshijë:*

- *Monitorimin ditor të performancës së sistemit dhe logeve;*
- *Verifikimin e proceseve të backup-it dhe rikthimin testues të të dhënave;*
- *Azhornimet e sigurisë, bazën e të dhënave dhe aplikacionin;*
- *Rivendosjen e shërbimeve në rast ndërprerjeje apo dështimi;*
- *Konsolidimin e indekse-ve dhe statistikave për optimizim të performancës.*

AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

*Periudha e zbatimit të kontratës **duhet të** jetë gjithsej 18 muaj nga data e nënshkrimit. Afati i implementimit të sistemit **duhet të** realizohet brenda 6 muajve të parë, ndjekur nga 12 muaj shërbim mirëmbajtjeje.*

III.10.5. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.10.6. Në nenin 5 "*Kontratat e përziera*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Kontratat, që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë lloje prokurimi për punë, shërbime ose furnizime, jepen në përputhje me dispozitat e zbatueshme, sipas llojit të prokurimit që karakterizon objektin kryesor të kontratës në fjalë.
2. Në rastin e kontratave të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet e parashikuara në kreun XII të këtij ligji dhe nga shërbime të tjera, ose kontrata të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet dhe pjesërisht nga furnizimet, objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse.

III.10.7. Në nenin 6 "*Prokurim i përzier që mbulon disa veprimtari*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Për kontratat publike që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë veprimtari, prokurimi i të cilave rregullohet në regjime të ndryshme, kur pjesë të ndryshme të saj janë objektivisht të ndashme, autoritetet ose entet kontraktore mund të zgjedhin të japin disa kontrata të ndara për secilën prej tyre ose të japin një kontratë të vetme, kur për arsye objektive, është i pamundur prokurimi në kontrata të ndara. Në çdo rast, zgjedhja midis prokurimit të një kontrate të vetme dhe prokurimit të disa kontratave të ndara nuk duhet të bëhet me qëllimin për ta përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të këtij ligji.*
2. Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të ndara, vendimi për rregullat që zbatohen për secilën prej tyre merret mbi bazën e karakteristikave të veprimtarisë së veçantë përkatëse.
3. Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për dhënien e kontratës do të zbatohen rregullat e mëposhtme:
a) në rastin e kontratave, të cilat kanë si objekt prokurimin që mbulohet nga sektori klasik dhe prokurimin për kryerjen e një veprimtarie sektoriale, rregullat e zbatueshme përcaktohen sipas dispozitave që rregullojnë sektorin klasik;
b) në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe ligjit të koncesioneve, kontrata e vetme jepet në përputhje me këtë ligj, nëse vlera e parashikuar e pjesës së kontratës që mbulohet nga ky ligj, e llogaritur në përputhje me parashikimet e këtij ligji, është e barabartë ose më e madhe se kufiri i lartë monetar; c) në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. 4. Kur është e pamundur që pjesë të ndryshme të një kontrate publike të përzier të ndahen, kontrata e vetme do të jepet në bazë të rregullave të zbatueshme për objektin kryesor të saj.
5. Për kontratat e përziera, për të cilat është e pamundur të ndahen dhe është e pamundur të përcaktohet se cila veprimtari është objekti kryesor, rregullat e zbatueshme përcaktohen si më poshtë:

a) në rastin e kontratave, të cilat kanë si objekt prokurimin që mbulohet nga sektori klasik dhe prokurimin për kryerjen e një veprimtarie sektoriale, rregullat e zbatueshme përcaktohen sipas dispozitave që rregullojnë sektorin klasik;
b) në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve të sektorit klasik dhe të koncesioneve, kontrata e vetme jepet në përputhje me këtë ligj, nëse vlera e parashikuar e pjesës së kontratës, e cila përbën një kontratë që mbulohet nga ky ligj, e llogaritur në përputhje me parashikimet e këtij ligji, është e barabartë ose më e madhe se kufiri i lartë monetar;
c) në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve të veprimtarive sektoriale dhe të koncesioneve, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e parashikuara për prokurimet në veprimtaritë sektoriale sipas këtij ligji;
ç) në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.".

III.10.8. Neni 21 pika 1 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" i ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*".

III.10.8. Në nenin 2, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet se:

"*2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:*
a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar, nëse është rasti;
c) argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike/termat e referencës të përcaktuara në procedurën e prokurimit;
ç) vlerën dhe mënyrën e përllogaritjes së vlerës, në përputhje me parashikimet e LPP-së dhe parashikimet në këto rregulla;
d) të gjitha kërkesat për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe modifikimet e bëra në këto dokumente, nëse është rasti;
dh) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta;
e) emrin dhe adresën e ofertuesit, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, kur ka një të tillë, si dhe vlerën e kontratës; ë) arsyet e kualifikimit dhe të skualifikimit të ofertuesve ose të kandidatëve; f) procesin e hedhjes së shortit, nëse ka pasur; g) arsyet e anulimit, sipas nenit 98, të LPP-së;

gj) argumentet për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 76, pikat 3, shkronja "f", 4 dhe 5, të LPP-së;
h) argumentet për rastin kur një ofertë është kualifikuar për shkaqe të parashikuara në pikën 6, të nenit 76, të LPP-së;
i) ankesat dhe vendimmarrjes lidhur me to;
j) administrimin dhe verifikimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, në formë shkresore, përpara nënshkrimit të kontratës ose përpara nënshkrimit të marrëveshjes kuadër nga organi qendror blerës;
k) raport përmbledhës të ecurisë së procedurës, sipas parashikimeve në LPP;
l) planin e zbatimit të kontratës sipas parashikimeve të LPP-së;
ll) Raportin për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve në LPP.".

III.10.9. Në nenin 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet se:

"*Njoftimet që publikohen në procedurat e prokurimit publik janë, si më poshtë vijon:*
a) njoftimi paraprak i informacionit;
b) njoftimi periodik i informacionit;
c) njoftimi mbi praninë e një sistemi kualifikimi;
ç) njoftimi i kontratës/i konkursit të projektimit;
d) njoftimi vullnetar i transparencës për procedurën me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
dh) njoftimi mbi ndryshimet dhe informacionet shtesë në një procedurë;
e) njoftimi i fituesit; ë) njoftimi i procedurës së anuluar;
f) njoftimi i lidhjes së kontratës;
g) njoftimi i ndryshimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj.".

III.10.10.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK të parashtruar në kërkesën nr. 1 përsa i përket llojit të procedurës së prokurimit të përzgjedhur nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni konstaton se kontrata që prokurohet është një kontratë e përzierë, pais referuar Shtojcës 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit objekti i prokurimit është blereja dhe instalimi i një sistemi informatik për nevojat e autoritetit kontraktor, si dhe mirëmbajtja e këtij sistemi për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore pas instalimit, por nga shqyrtimi i procesverbalit të argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike të publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar përzgjedhjen e lllojit të kontratës të cilën e ka klasifikuar të llojuit "Mallra", duke patur parasysh përcaktimet e nenit 5 dhe nenit 6 të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar.
Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të argumentuar përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit sipas parashikimeve ligjore, duke

argumentuar se cili nga komponenetët e objektit të prokurimit ka vlerën më të madhe gjatë procedsit të përllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK qëndrojnë pjesërisht.

III.10.10.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK të parashtruar në kërkesën nr. 2, lidhur me njoftimin paraprak të procedurës së prokurimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në Seksionin 4 "*Procedura*" pika 4.2 "*Është përdorur njoftimi paraprak/periodik i informacionit*" të dokumentave të tenderit ka njoftuar operatorët ekonomik ofertues së për këtë procedurë prokurimi nuk është përdorur njoftim paraprak ose njoftim periodik lidhur me publikimin e kësaj procedure prokurimi, duke zbatuar përcaktimet e nenit 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë, pasi për këtë procedurë prokurimi autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë ofertues se autoriteti kontraktor nuk është përdorur njoftim paraprak ose njoftim periodik lidhur me publikimin e kësaj procedure prokurimi.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*KREATX*" SHPK nuk qëndrojnë.

III.10.10.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK të parashtruar në kërkesën nr. 8, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstaton se nga shqyrtimi i Shtojcës 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar afatin 6 (gjashtë) mujor për zhvillimin dhe implementimin e sistemit informatik objekt prokurimi dhe afatin 12 (dymbëdhjetë) mujor të shërbimit të mirëmbajtjes së këtij sistemi pas instalimit, ndërkohë që në Seksionin 2 "*Objekti i kontratës*" pika 2.11 "*Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës*" dhe në Shtojcën 7 "*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar vetëm afatin 6 (gjashtë) mujor për zhvillimin dhe implementimin e sistemit informatik, duke mos përcaktuar afatin 12 (dymbëdhjetë) mujor të shërbimit të mirëmbajtjes së këtij sistemi.
Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se pretendimi i mësipër i ankimuesit qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e dokumentave të tenderit duke përcaktuar në Seksionin 2 "*Objekti i kontratës*" pika 2.11 "*Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës*" dhe në Shtojcën 7 "*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*" të dokumentave të tenderit edhe afatin 12 (dymbëdhjetë) mujor të shërbimit të mirëmbajtjes së këtij sistemi.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *Smart ICT Services*" SHPK qëndrojnë.

III.11. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.6** dhe kërkesën **nr.10**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër

ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK, të parashtruara në kërkesat **nr.1, nr. 2, nr. 3, nr, 4 dhe nr.5**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6521, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1132/2026 prot., datë 14.04.2026, si dhe lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesat **nr.7, nr. 8, nr. 9, nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 13, nr. 14, nr. 15, nr. 16 dhe nr. 17** të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.11.1. Në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit objekt ankimi. autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimetteknike të produktit objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

MODULI I. Modernizimi i Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore te Bashkise Himare nepermjet Arkitekturës Ëeb-Cloud.

Objektivi kryesor *është implementimi i një sistemi informatik të sigurt, i cili* ***duhet të*** *automatizojë ciklin e plotë të administrimit të taksave dhe tarifave vendore. Rezultati i dëshiruar është një platformë e matshme që rrit efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave si me poshte:*

Arkitektura e sistemit

Sistemi duhet të ofrohet si një shërbim i bazuar në Ëeb dhe Cloud (SaaS ose ekuivalent funksional), duke mundësuar akses të centralizuar dhe menaxhim të unifikuar të funksionaliteteve dhe të dhënave.

Ndërfaqja e përdoruesit

Sistemi duhet të ofrojë një ndërfaqe Ëeb moderne, të aksesueshme përmes shfletuesve standard të përdorimit të gjerë, me përshtatje automatike për pajisje desktop, tabletë dhe mobile, pa kërkuar instalim të softuerëve shtesë në pajisjet e përdoruesve.

Baza e të dhënave

Sistemi duhet të mbështetet në një sistem menaxhimi baze të dhënash të nivelit "enterprise" ose ekuivalent,te certifikuar per perdorim ne mjedise Cloud, i aftë të përballojë volum të lartë të të dhënave dhe ngarkesa intensive pune, duke garantuar integritetin, sigurinë ,mekanizma auditimi dhe disponueshmeri te larte te të dhënave.

Siguria e aksesit

Aksesimi i sistemit duhet të realizohet përmes mekanizmave të sigurt të komunikimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit dhe politikat përkatëse të sigurisë.

Disponueshmëria e shërbimit

Operatori Ekonomik duhet të garantojë një nivel të lartë disponueshmërie të sistemit, i cili përcaktohet, matet dhe monitorohet përmes Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (SLA).

Sistemi duhet të ofrohet si shërbim softëare i hostuar në mjedis Cloud, i aksesueshëm përmes shfletuesit ëeb, pa kërkesë për instalim apo konfigurim lokal në pajisjet fundore.

Transmetimi i të dhënave duhet të realizohet përmes protokolleve të sigurta HTTPS/TLS, duke garantuar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave gjatë komunikimit.

Rezultatet konkrete qe duhet të arrihen :

- ***Aksesueshmëria:*** *Sistemi duhet të jetë plotësisht funksional përmes çdo shfletuesi Ëeb, pa pasur nevojë për instalime lokale.*
- ***Disponueshmëria e Lartë:*** *Arritja e nivelit* ***99.9% Uptime****, i vërtetuar përmes raporteve mujore të SLA-së. "Disponueshmëria 99.9% llogaritet mbi bazë mujore, duke përjashtuar ndërprerjet e planifikuara të mirëmbajtjes të njoftuara paraprakisht."shtoje*
- ***Integrimi i Shpejtë:*** *Lidhja në kohë reale me sisteme te tjera si e-Albania, QKB, platforma qendrore e Tatimeve dhe bankat përmes API-ve Cloud, duke mundësuar arkëtime të menjëhershme.*
- ***Sovraniteti i të Dhënave:*** *Sigurimi që të gjitha të dhënat fiskale të Bashkisë Himarë hostohen dhe ruhen në mjedise të sigurta dhe të audituara.*

Operatori Ekonomik OE duhet të realizojë ecurinë e punës sipas fazave të mëposhtme:

6. ***Analiza dhe Migrimi i të Dhënave:*** *OE* ***duhet të*** *kryejë analizën e bazës ekzistuese të të dhënave dhe të realizojë migrimin e tyre drejt mjedisit te databazes pa humbje informacioni.*
7. ***Zhvillimi i Moduleve Funksionale:*** *OE* ***duhet të*** *zhvillojë të gjitha modulet e kërkuara Referencat, Subjektet, Detyrimet, Likujdimet, Raportet dhe Importet.*
8. ***Integrimi me Platformat e Ndërveprimit:*** *Sistemi* ***duhet të*** *integrohet me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit përmes ESB-së, si dhe me sistemet e AKSHI-t, Sistemi qendror i Tatimeve, QKB dhe bankave te nivelit te dyte etj.*
9. ***Testimi dhe Trajnimi:*** *Kryerja e testimit të pranimit (UAT) dhe trajnimi i stafit te drejtorive perkatese.*
10. ***Mirembajtja***

    Mirëmbajtja do të fokusohet në:

- *Përditësimin e sigurisë së serverëve Cloud.*
- *Monitorimin 24/7 të performancës së API-ve për ndërveprimin me institucionet e tjera*

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit ***duhet të*** *jetë për një periudhë 1-vjeçare (12 muaj).*

Mirëmbajtja do të përfshijë:

- *Monitorimin ditor të performancës së sistemit dhe logeve;*
- *Verifikimin e proceseve të backup-it dhe rikthimin testues të të dhënave;*
- *Azhornimet e sigurisë, bazën e të dhënave dhe aplikacionin;*

- *Rivendosjen e shërbimeve në rast ndërprerjeje apo dështimi;*
- *Konsolidimin e indekse-ve dhe statistikave për optimizim të performancës.*

Siguria e sistemit

*Sistemi i ofruar nga OE **duhet të** garantojë nivelet e sigurisë sipas tabelës së mëposhtme, duke u bazuar në rregulloren e Bazave të të Dhënave Shtetërore*

Disponueshmëria	*Integriteti*	*Konfidencialiteti*	*Niveli i Sigurisë*
☐ D0	*☐ I0*	*☐ K0*	
☐ D1	*☐ I1*	*☐ K1*	*☐ U*
☒ D2	*☒ I2*	*☒ K2*	*☒ M*
☐ D3	*☐ I3*		*☐ L*

Niveli i sigurisë është i mesëm (M) pasi disponueshmëria dhe integriteti i të dhënave tatimore kërkojnë nivelin D2 dhe I2 për të garantuar shërbim të pandërprerë për qytetarët. Operatori Ekonomik duhet të zbatoje rregulloret e sigurisë të miratuara nga AKCESK ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

- *Sistemi **duhet të** ndërveprojë me institucionet dhe platformat e mëposhtme:*
  - ***AKSHI :** Për shkëmbimin e të dhënave me regjistrat shtetërorë.*
  - ***Sistemi i Tatimeve dhe (QKR):** Për marrjen e të dhënave të bizneseve në nivel NIPT-i.*
  - ***Subjekte Financiare:** Për importin automatik të arkëtimeve ditore dhe rakordimin e faturave nepermjet komunikimeve API te pagesave nepermjet marreveshjes 3 paleshe.*
  - ***e-Albania:** Për dërgimin e njoftimeve tatimore dhe dokumenteve të detyrimit te qytetarët dhe bizneset.*

AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

*Periudha e zbatimit të kontratës **duhet të** jetë gjithsej 18 muaj nga data e nënshkrimit. Afati i implementimit të sistemit **duhet të** realizohet brenda 6 muajve të parë, ndjekur nga 12 muaj shërbim mirëmbajtjeje.*

SPECIFIKIMET TEKNIKE

*Operatori Ekonomik (OE) **duhet të** ofrojë një zgjidhje teknologjike të bazuar në arkitekturën **Ëeb-based**, e cila operon në mjedis **Cloud** (Public, Private ose Government Cloud).*

1.1. Arkitektura e kerkuar

- ***Aksesueshmëria:** Sistemi **duhet të** jetë i aksesueshëm përmes shfletuesve standardë te perdorimit te gjere pa kërkuar instalimin e asnjë softëare-i shtesë në pajisjet e përdoruesve (Zero-Footprint),duke garantuar funksionim te vazhdueshem ne kushte normale operimi.*

- ***Hosting në Cloud:*** *Infrastruktura* ***duhet të*** *jetë e hostuar në një mjedis Cloud që garanton disponueshmëri të lartë.*
- ***Përditësimet Qendrore:*** *Çdo modifikim i tarifave apo përditësim i softëare-it* ***duhet të*** *aplikohet në sistemin qendror, duke u reflektuar menjëherë te të gjithë përdoruesit.*

1.2. Specifikime Teknike për Teknologjinë Ëeb-Cloud

Fusha Teknike	***Specifikimi i Kërkuar***
Ndërfaqja (Frontend)	*E bazuar në teknologji moderne Ëeb, shfletues standarte me dizajn te pershtatshmem (**Responsive**)*
Siguria e Transmetimit	*Çdo komunikim midis klientit dhe Cloud* ***duhet të*** *jetë i enkriptuar përmes standardeve nderkombetare (**HTTPS me SSL/TLS) ose ekuivalente***
Autentikimi	*Mbështetje për* ***Multi-Factor Authentication (MFA)*** *dhe integrim me sistemet e identifikimit shtetëror (SSO) .*
Skalueshmëria	*Infrastruktura Cloud* ***duhet të*** *lejojë rritjen e kapaciteteve përpunuese automatikisht gjatë periudhave të ngarkuara.*
API-First Design	*Sistemi* ***duhet të*** *ofrojë API të dokumentuara mirë për ndërveprim te shpejtë me institucione te tjera .*

Tabela e Specifikimeve Funksionale (KF)

Kodi	***Emertimi i sherbimit***	***Pershkrimi Teknik i Funksionalitetit***
KF1	***Ndertimi I sistemit***	
SF-1.1	***Administrimi i Sistemit dhe Regjistrimi i referencave***	*Programi i taksave duhet te mundesoje regjistrimin e te dhenave referenciale baze per funksionimin dhe administrimin e sistemit, si meposhte:* • *Regjistrimi i perdoruesve te sistemit.* • *Regjistrimi i roleve dhe te drejtave te perdoruesve* • *Percaktimi i listes se subjekteve per inspektor* • *Regjistrimi i struktures administrative(Organigrama)/Personeli* • *Regjistrimi i Adresave, Rruget dhe Zonat* • *Regjistrimi i arkave dhebankat* • *Regjistrimi i tipeve te parametrave opsionale qe mund te kete nje biznes/prone/familjar, si psh:* - *Reklama* - *Zenia e hapesires publike etj* • *Tipet e dokumentave qe duhen ne nje proces*

		specifik, si psh: - *Ekstrakti i QKR-se* - *Akt-Marreveshje* - *Certifikate pronesie etj* • *Regjistrimi i normave te interesit per llogaritjen e kamat vonesave sipas publikimit te DPT-se.* • *Regjistrimi i llojeve te aktivitetit dhe lidhja me grupin e detyrimeve*
SF- 1.2	***Integrimi i legjislacionit***	• *Integrimi i VKB-ve dhe i legjislacionit perkates tatimor per drejtorine e te ardhurave, konsiston ne;* • *Up-date te te gjitha ndryshimeve ligjore ne fushen e legjislacionit fiskal ose te lidhura me te.* • *Up-date i te gjitha VKM-ve qe lidhen me fushen e administrimit tatimor ne nivel lokal* • *Azhornimi i paketes fiskale ose ndryshimeve te saj* • *Vendime te Keshillit Bashkiak qe lidhen me taksat apo tarifat e ndryshme*
SF- 1.3	***Regjistrimi i i bizneseve***	• *Regjistrimi i individit/personit fizik/personit juridik, te dhenat kryesore te subjektit si:* - *Emri, atesia, mbiemri (individe) ** - *Emertimi (person fizik/ person juridik) ** - *Forma juridike ** - *NID/NIPT ** - *Datelindja (individe)* - *Qyteti ** - *Rruga ** - *Adresa* - *Zona* - *Telefon/Cel* - *Email* - *Adresa e njoftimit (adrese ku subjekti mund te njoftohet)* - *Te dhena shtese si (numri i dosjes, numer kontrate etj)* • *Regjistrimi i njesive te biznesit (adreses qendrore apo sekondare), te dhenat kryesore te njesise:*

		- *Numri serial-nipt (numer identifikues per njesite e biznesit) ** - *Forma Juridike ** - *Nipti ** - *Data e regjistrimit (drejtoria e te ardhurave) ** - *Data e licensimit (nga qkb) ** - *Rruga ** - *Adresa ** - *Drejtoria Operacionale(drejtoria e te ardhurave) ** - *Njesia Administrative ** - *Lloji i biznesit (opsional) ** - *Zona ** - *Lloji i aktivitetit ** - *Xhiro* - *Gjuha e tabeles (shqip, gjuhe te huaj, etj te jete referenciale)* - *Komentet (ne forme liste, ku te ruhen te gjitha veprimet dhe shenimet mbi kete njesi)* - *Aktet e konstatimit qe mbajne inspektoret ne terren* • *Administratori, te dhenat e administratorit/administratoreve* - *Emri* - *Atesia* - *Mbiemri* - *NID* - *Datelindja* - *Roli (administrator, ortak, pronar, bashkepronar)* • *Dokumentat, lista dokumentash ku te paracaktohet per cdo proces:* - *Emertimi* - *Numri i dokumentit* - *Data e protokollit* • *Njesi qendrore/sekondare (kjo te plotesohet automatikisht gjate regjistrimit)* *Regjistrimi i parametrave opsionale te*

		biznesit/prones/familjarit qe identifikohen nga inspektoret ose vete-deklarohen nga subjekti: • *Regjistrimi i parametrave ne nivel te njesise se biznesit/prones/familjarit:* - *Lloji i parametrit (reklame, zenie e hapesires publike)* - *Viti* - *Njesia matese (siperfaqe, dhome, etj)* - *Vlera per njesine (numerike)* - *Kategoria (sipas paketes fiskale)* - *Komente te ndryshme* - *Dokument i regjistrimit/ndryshimit/anullimit*
SF- 1.4	***Regjistrimi i pronave***	• *Regjistrimi i pronarit:* - *Emri, atesia, mbiemri (individe) ** - *NID ** - *Datelindja ** - *Qyteti ** - *Rruga ** - *Adresa* - *Zona* - *Telefon/Cel* - *Email* - *Adresa e njoftimit (adrese ku subjekti mund te njoftohet)* - *Te dhena shtese si (numri i dosjes, numer kontrate etj)* • *Regjistrimi i pronave, te dhenat mbi pronen:* - *Numri i pasurise ** - *Zona kadastrale ** - *Data e regjistrimit (ne drejt.ardhurave) ** - *Data e fillimit (data kur do nisin detyrimet) ** - *Rruga ** - *Adresa ** - *Njesia Administrative ** - *Forma e pronesise ** - *Zona ** - *Lloji i pasurise **

		- *Siperfaqja bruto ** - *Aktet e konstatimit qe mbahen gjate verifikimeve ne terren nga inspektoret.* - *Pronarin/pronaret, te dhenat kryesore:* *- Emri* *- Atesia* *- Mbiemri* *- NID* *- Datelindja* *- Roli (pronar, bashkepronar)* - *Pjeset e prones:* *- Data fillim* *- Data perfundim* *- Siperfaqja* *- Kategoria e prones (sipas paketes fiskale)*
SF- 1.5	***Regjistrimi i familjareve***	• *Regjistrimi i kryefamiljarit ;* - *Emri, atesia, mbiemri (individe) ** - *NID ** - *Datelindja (individe)* - *Qyteti ** - *Rruga ** - *Adresa* - *Zona* - *Telefon/Cel* - *Email* - *Adresa e njoftimit (adrese ku subjekti mund te njoftohet)* - *Te dhena shtese si (numri i dosjes, numer kontrate etj)* • *Regjistrimi per kryefamiljarin:* - *Data e regjistrimit (ne drejt.ardhurave) ** - *Data e fillimit të detyrimeve ** - *Rruga ** - *Adresa ** - *Njesia Administrative ** - *Kategoria e kryefamiljarit ** - *Zona ** - *Siperfaqja **

SF 2	***Funksionet e llogaritjeve dhe gjenerimit te detyrimeve***	
SF- 2.1	***Gjenerimi dhe llogaritja e detyrimeve***	*Per cdo subjekt/pronar/prone qe regjistrohet me sukses, duhet qe sistemi te gjeneroje automatikisht detyrimet per periudhen aktuale tatimore duke u bazuar tek percaktimet ligjore,paketa fiskale miratuar nga Keshilli Bashkiak dhe fizionomia e biznesit. Sistemi duhet te llogarise automatikisht:* • *Taksat* - *Sistemi duhet te marre parasysh te gjitha komponentet e biznesit si: lloji i aktivitet, lloji i biznesit, njesia administrative, zona, xhiro etj* - *Kategoria e biznesit, per te percaktuar grupin e taksave.* • *Tarifat* - *Sistemi duhet te marre parasysh te gjitha komponentet e biznesit si: lloji i aktivitet, lloji i biznesit, njesia administrative, zona, xhiro etj* - *Kategoria e biznesit, per te percaktuar grupin e tarifave.* • *Gjobat* - *Per te gjithe detyrimet apo grup detyrimet te konfirmuara nga specialisti, te cilat kane tejkaluar afatin duke u mbeshtetur ne legjislacionin tatimor dhe duke perllogaritur ditet* *Jo me shume se 365 dite* • *Kamatëvonesat* - *Lindin ne momentin e arketimit dhe do llogariten automatikisht bazuar në dite vonesat , shumen dhe interesat e publikuara nga DPT* *Komponentet baze qe duhet te permbaje detyrimi jane:* • *ID (unik)* • *Njesia e biznesit* • *Viti* • *Afati* • *Kodi detyrim (kodunik shtatë shifror)*

		• *Numri i llogarise* • *Shuma e detyrimit* • *Shuma e likujduar* • *Data e likujdimit* • *Komente te ndryshme* *Integrimi i tepricave debitore per vitet e kaluara.* • *Formati i skedarit:* - *NIPTI* - *Njesia e biznesit/prona ku po ngarkohet detyrimi* - *Viti* - *Afati (opsional)* - *Kodi detyrim (kodunik)* - *Numri i llogarise* - *Shuma e detyrimit* - *Shuma e likujduar* - *Numri i kestit/kesteve*
SF 3	***Publikimi/Njoftimet***	
SF- 3.1	***Njoftimi i Detyrimeve***	*Pas konfirmimit dhe aprovimit te detyrimeve, duhet te shfaqen dhe printohen :* • *Njoftim detyrimi* • *Njoftim vleresimi* • *Noftim rivleresimi tatimor* • *Njoftim per subjektet e reja* • *Vertetim likujdimi* • *Njoftim dhe kerkese per te paguar* • *Urdher bllokimi i llogarive bankare* • *Urdher ekzekutimi* • *Njoftim vendosje barre siguruese* • *Njoftim vendosje barre hipotekore*
SF 4	***Pagesat***	
SF- 4.1	***Arketime/Urdherpagesa***	*Shkarkimi i pagesave duhet te kryhet ne 3 forma, duke perdorur arketimin, urdherxhirim nga banka dhe pagesat online* *Mandat i pageses duhet te permbaje:* • *Subjekti (duke u kerkuar me kod, nipt/nid ose emertim)*

		• *Banka/Arka/Subjekt financiar (emertimi i bankes, i arkes ose i pales se trete)* • *Data e pageses* • *Numri rendor* • *Shuma totale* • *Teprice* • *Detyrimet e paguara, te dhenat:* - *Id e detyrimit* - *Emertimi i detyrimit* - *Viti, afati* - *Njesia e biznesit/prona* - *Shuma e paguar* - *Teprice* - *Debia e ngelur*
SF 5	***Raportimet***	
SF- 5.1	***Raportimi Analitik***	• *Raport i pergjithshem mbi subjektet/pronat* • *Raporti i pergjithshem per debitoret* • *Raporti i pergjithshem per kreditoret* • *Raport i pergjithshem mbi adresat/njesite e biznesit* • *Raport i subjekteve te pezulluara* • *Raport i pergjithshem per personat* • *Ditari i Arkes/Bankes* • *Ditari i pagesave te subjekteve* • *Raport i pergjithshem mbi parametrat* • *Detyrimet sipas njesive* • *Historiku i subjekteve* • *Historiku i veprimeve te perdoruesit* • *Statistika i detyrimeve* • *Statistika i subjekteve* • *Marreveshjet e borxhit*
SF 6	***Funksionalitet te tjera***	
SF- 6.1	***Funksionalitetet te tjera***	• *Baze te dhenash per pagesat qe replikon me bazen e sistemit te taksave [Pagesa Online]* • *Baze te dhenash per auditimit ku ruhen te gjitha veprimet/log-et te sistemit baze.* • *Nderfaqe per aprovimin e pagesave nga palet e treta (subjektet financiare)*

		• *API per dergimin e mesazheve [AKSHI]* • *API per dergimin e dokumentave [AKSHI]* • *API per njoftim detyrimi te subjektit/individit [AKSHI]* • *API per vertetim likujdimi [AKSHI]* • *API per marrjen e informacionit nga gjendja civile RGJC* • *API per marrjen e informacionit per subjektet nga DPT* • *API per printimin e njoftim detyrimi* • *Aplikacion per fushaten e printim/njoftim qe gjeneron ne seri skedare pdf per njoftimet* • *Aplikacion per fushaten e njoftimit nepermjet mesazheve ne e-albania [AKSHI]*

12. Sistemi duhet te kete edhe nje asistent Virtual.

Ky propozim kerkon ekzistencen e një Agjenti të avancuar të Inteligjencës Artificiale (AI), i projektuar për të mbështetur Bashkinë e Himarës në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët – me zë dhe me shkrim, optimizimin e proceseve administrative dhe trajtimin e kërkesave si përmes telefonatave (me zë), ashtu edhe përmes sistemit të email/ëhatsapp.

Objektivat:

• T'u ofrojë qytetarëve përgjigje të shpejta dhe të sakta për pyetjet më të shpeshta.

• T'u ofrojë subjekteve apo individeve përgjigje për pyetje që lidhen me sistemin e taksave apo tarifave qe aplikohen.Aktet ligjore e nenligjore qe lidhen me to.

• Të informojë në mënyrë të detajuar qytetarët dhe subjektet mbi detyrimet tyre tatimore .

• Të reduktojë ngarkesën e punës për punonjësit e bashkisë, duke liruar kohë për aktivitete me vlerë më të lartë.

-Karakteristikat kryesore qe kerkohen per Agjentin AI

• Ndërveprim me zë: Qytetarët mund të telefonojnë bashkinë dhe të marrin përgjigje në kohë reale, natyrale dhe të ngjashme me komunikimin njerëzor nga Agjenti AI.

• Agjenti AI duhet te njihet me çdo përditësim të ligjeve,VKM-ve ,VKB-ve,urdherave te ndryshem etj dhe ua komunikon ato me detaje qytetarëve kur adresojnë pyetje ne keto drejtime.

• Mbështetje me email: Kategorizim dhe përgjigje automatike të email-eve.

• Mbështetje shumëgjuhëshe: Përgjigjet mund të jepen në shqip,greqisht dhe anglisht , sipas preferencës së qytetarit.

• Panel analitik : Stafi i drejtorise se te ardhurave duhet të ketë akses në një panel me të dhëna dhe analiza mbi numrin e telefonatave, përgjigjet e përpunuara dhe matjen e kënaqësisë së qytetarëve.

PORTALI : E-TAKSA HIMARE

Portali mendohet te jetë një platformë elektronike e dedikuar për individet dhe subjektet juridike, krijuar për të ofruar transparencë dhe lehtësi në aksesimin e të gjitha ***detyrimeve financiare lokale****, si taksat, tarifat apo debitë e prapambetura ndaj bashkisë Himarë.*

Portali duhet të jetë i lidhur me sistemin e drejtorise se te ardhurave nga ku merren informacionet ne lidhje me faturat, debitë,kreditë etj

Aksesimi per individet

Për këtë, një përdorues, nëpërmjet kompjuterit, telefonit apo tabletit, duhet të krijojë një profil dhe me tej te mund te gjeneroje detyrimet e tija .

Aksesimi për subjektet (bizneset)

Subjektet juridike (si kompani, organizata etj.) duhet të hyjnë në portal duke përdorur ***NIPT-in e tyre*** *dhe ne hapin e dyte mund te verifikojne situaten financiare,detyrimet e prapambetura, ato te reja etj. Gjenerim dhe printim fature per bisneset/indivitet.*

Moduli II Menaxhimit Financiar

Moduli i ***Menaxhimit Financiar*** *është komponenti qendror që transformon platformën nga një sistem mbledhjeje të ardhurash në një sistem të plotë menaxhimi financiar për Bashkinë. Ky modul integron automatikisht të ardhurat e gjeneruara nga modulet ekzistuese ("Faturat" dhe "Arka") me shpenzimet operative, duke ofruar kontabilitet me regjistrim të dyfishtë , menaxhim të buxhetit dhe raporte financiare në kohë reale.*

Funksionalitetet e Modulit të Financës

1. Plani i Llogarive

Moduli do të mundësojë konfigurimin e plotë të planit kontabël të Bashkisë.

- ***Struktura:*** *Përdoruesi do të mund të krijojë llogari të organizuara në nivele hierarkike (Klasa, Grupi, Llogaria sintetike, Llogaria analitike).*
- ***Qendrat e Kostos:*** *Mundësia për të lidhur llogaritë me qendra specifike kostoje (p.sh., Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Punëve Publike).*

2. Regjistrimet në Ditar

Sistemi do të menaxhojë regjistrimet financiare në dy mënyra:

1. ***Regjistrim Automatik:*** *Çdo veprim i kryer në modulin "Faturat" (krijimi i faturës) ose "Arka" (arkëtimi ditor) do të gjenerojë automatikisht fletë-hyrjen kontabël përkatëse në ditar.*
2. ***Regjistrim Manual:*** *Ekonomistët mund të shtojnë veprime manuale për rregullime ose transaksione jo të automatizuara.*

3. Mbyllja e Periudhës

- *Funksionalitet për mbylljen e muajit ose vitit fiskal, duke bllokuar modifikimet në periudhat e mbyllura dhe duke transferuar tepricat në vitin pasardhës.*

Moduli i Shpenzimeve dhe Furnitorëve

Ky modul shërben për regjistrimin dhe menaxhimin e detyrimeve që Bashkia ka ndaj palëve të treta (furnitorëve, kontraktorëve, etj.), duke siguruar kontroll mbi paratë që dalin nga institucioni.

1. Regjistri i Furnitorëve

Një bazë të dhënash për menaxhimin e kontraktorëve.

- ***Shtimi i Furnitorit:*** *Përdoruesi klikon "Shto Furnitor" dhe plotëson fushat: Emri, NIPT, Adresa, IBAN, Tipi i shërbimit.*
- ***Historiku:*** *Çdo furnitor do të ketë një kartelë ku shfaqen të gjitha faturat dhe pagesat e kryera ndaj tij.*

2. Regjistrimi i Faturave të Blerjes (Shpenzimeve)

Hapat për regjistrimin e një shpenzimi:

1. *Përdoruesi zgjedh furnitorin.*
2. *Plotëson të dhënat e faturës (Nr. Fature, Data, Vlera Totale).*
3. *Zgjedh zërin e buxhetit ose llogarinë e shpenzimit ku do të alokohet kjo kosto.*
4. *Ngarkon faturën fizike të skanuar në seksionin e dokumenteve.*

3. Urdhër-Pagesat

- *Gjenerimi i urdhër-pagesave për thesarin ose bankën bazuar në faturat e miratuara të blerjes.*
- *Statuset e Urdhër-Pagesës: Në pritje, E Miratuar, E Refuzuar, E Paguar.*

Moduli i Buxhetit

Moduli "Buxheti" është instrumenti kryesor për planifikimin financiar dhe kontrollin e shpenzimeve në raport me të ardhurat e parashikuara nga taksat.

Funksionalitetet e Modulit të Buxhetit

1. Planifikimi Buxhetor

- *Përdoruesit mund të përcaktojnë limitet vjetore për çdo llogari shpenzimi dhe të ardhure.*
- *Mundësia për të shpërndarë buxhetin sipas muajve ose tremujorëve.*

2. Monitorimi (Buxheti vs. Faktiku)

- *Sistemi ofron një tabelë krahasuese në kohë reale:*
  - ***Buxheti i Planifikuar***
  - ***Realizimi Faktik*** *(bazuar në regjistrimet në GL)*
  - ***Diferenca (Mbetja)***
  - ***Përqindja e Realizimit (%)***
- ***Alarmi i Tejkalimit:*** *Nëse një përdorues tenton të regjistrojë një shpenzim që tejkalon fondin e mbetur, sistemi shfaq një njoftim paralajmërues.*

Moduli i Aseteve

Moduli i Aseteve menaxhon inventarin e pasurive të qëndrueshme të Bashkisë dhe llogaritjen automatike të amortizimit të tyre.

1. Regjistri i Aseteve

Lista e plotë e aseteve (ndërtesa, makineri, pajisje IT, automjete).

Kolonat e shfaqura në listë:

- ***Kodi i Asetit:*** *Numri unik i inventarit (barkod).*
- ***Emërtimi:*** *Përshkrimi i asetit.*
- ***Data e Blerjes:*** *Data e hyrjes në Bashki.*
- ***Vlera Fillestare:*** *Kostoja e blerjes.*
- ***Norma e Amortizimit:*** *Përqindja e zhvlerësimit vjetor.*
- ***Vlera e Mbetur:*** *Vlera aktuale kontabël.*

2. Llogaritja e Amortizimit

- *Sistemi ekzekuton automatikisht amortizimin në fund të periudhës (mujore/vjetore).*
- *Gjeneron automatikisht regjistrimin kontabël (Shpenzim Amortizimi / Fond Amortizimi) pa ndërhyrjen e përdoruesit.*

Raportet Financiare

Krahas modulit ekzistues të "Raporteve" që fokusohet te të ardhurat, ky seksion shton raportet e kontabilitetit të plotë.

1. Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Raport që krahason të ardhurat totale (nga Taksat e Subjekteve dhe Familjarëve) me shpenzimet operative për të nxjerrë rezultatin financiar (Suficit/Deficit).

2. Bilanci i Gjendjes

- *Paraqitja e Aseteve, Detyrimeve dhe Kapitalit të Bashkisë në një datë të caktuar.*

3. Paneli Financiar

Një pamje vizuale e thjeshtuar në Panelin Qendror që përfshin:

- ***Likuiditeti:*** *Totali i parave në llogari bankare dhe arkë.*
- ***Shpenzimet sipas Kategorive:*** *Grafik që tregon ku po shkojnë fondet (Rroga, Investime, Mirëmbajtje).*

Top Furnitorët: *Lista e furnitorëve ndaj të cilëve ka detyrime më të larta*

III.11.2. Në procesverbalin e argumentimit të kritereve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronik (SPE) AUTORITETI KONTRAKTOR nuk ka argumentuar specifikimet teknike të objektit të prokurimit të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.11.3. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*Qëllim i këtij ligji është:*
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."
Ndërkohë në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.11.4. Neni 21 pika 1 "*Autoriteti ose enti kontraktor*" i ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj*.".

III.11.5. Neni 36 "*Specifikimet teknike*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:
"*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*
2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".
4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".
5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.
7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.".

III.11.6. Neni 75 "*Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit*" të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

"*1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.*
2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.
3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.".

III.11.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar 17 kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të

shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj" në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në 18 përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 "*Për prokurimin publik*" KE, parashikohet se: "Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim" Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet "Specifikime teknike" janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe

metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë." Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cështja C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. 19 Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese." Gjithashtu, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" është përafruar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar". Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur

interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një 18 vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson se, fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhues vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në të cilin parashikohet se: "në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj". Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtar me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t'i përmbahet stricto-sensu vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik. Gjithashtu, Komisioni thekson, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që 20 garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Kështu, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike nuk mund të niset vetëm nga procedura analoge të zhvilluara më parë nga po i njëjti autoritet kontraktor ose nga autoritete të tjera kontraktore homologe, ose eprore, por në përputhje me parashikimet e ligjit.

III.11.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të

ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar se: “2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.”. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, 21 standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.11.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat, janë

konfuze dhe të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshura të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit.

III.11.10.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.6** dhe kërkesën **nr.10**, të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6513, datë 10.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1128/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni gjykon se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues janë paqartësi mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe hartimit të ofertës ekonomike. Autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*", protokolluar me tonën me nr. 1128/1 prot, datë 19.05.2026, ka dhënë sqarime për këto kërkesa të ankimuesit, por KPP gjykon se këto sqarime nuk janë shteruese, pasi autoriteti kontraktor nuk ka shpjeguar qartësisht dhe konkretisht, sepse nuk ka dhënë informacion dhe specifika të detajuara përsa i përket formës (Ecxel, Sofëtare ose tjetër) në të cilën autoriteti kontraktor i disponon të dhënat që do migrohen në sistemin e ri, nuk ka specifikuar sasinë e këtyre të dhënave si dhe të dhënat e tjera si: "Madhësia në MB, numri i taksapaguesve që ndihmon në llogaritjen e ofertës ekonomike dhe teknike në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike, nuk ka sqaruar në mënyrë të detajuar qëllimin dhe shtrirjen e modulit financiar, duke përcaktuar nëse ky modul do të jetë pjesë e një sistemi të integruar financiar për të gjithë Bashkinë apo një modul i kufizuar vetëm për taksat dhe tarifat vendore, si dhe nuk ka specifikuar qartë të gjitha funksionalitetet dhe modulet që duhet të përfshihen, në mënyrë që operatorët ekonomikë të mund të paraqesin oferta të sakta dhe të krahasueshme, në mënyrë që oferuesit të qartësohen lidhur me hartimin e ofertës teknike dhe ekonomike. Për pasojë, KPP gjykon se autoriteti kontraktor përvecse të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese për të gjitha paqartësitë e tij, duhet të marrë masa që të publikojë edhe specifikimet teknike në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP. Sqarimet dhe specifikime duhet tu bëhen me dije edhe ofertuesve të interesuar për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" SHPK qëndron

III.11.10.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK, të parashtruara në në kërkesat **nr.1, nr. 2, nr. 3, nr, 4 dhe nr.5**, të parashtruara në formularin e ankesës

me numër ankimi elektronik A/2026/6521, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1132/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni gjykon se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues janë paqartësi mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe hartimit të ofertës ekonomike. Autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1329/18 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK*", ka dhënë sqarime për këto kërkesa të ankimuesit, por KPP gjykon se këto sqarime nuk janë shteruese, pasi autoriteti kontraktor nuk ka shpjeguar qartësisht dhe konkretisht, sepse nuk ka dhënë sqarime lidhur me elementët teknikë thelbësorë të procesit të "Analizimit dhe Migrimit të të Dhënave", nuk ka dhënë sqarime lidhur me elementët teknikë që lidhen me realizimin e integrimit të sistemit të ri me platformat dhe sistemet e tjera ndërinstitucionale, nuk ka përcaktuar karakteristikat, parametrat dhe të dhënat teknike për raportimet dhe funksionalitet analitike, nuk ka përcaktuar karakteristikat, parametrat dhe të dhënat teknike për bazën e të dhënave për pagesat që replikon me sistemin e taksave dhe për aplikacionin e fushatave të printimit/njoftimit, si dhe nuk ka përcaktuar karakteristikat, parametrat dhe të dhënat teknike lidhur me numrin e përdoruesve, nivelet e aksesit dhe volumet e subjekteve që do të përpunojë sistemi, në mënyrë që oferuesit të qartësohen lidhur me hartimin e ofertës teknike dhe ekonomike.
Për pasojë, KPP gjykon se autoriteti kontraktor përvecse të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese për të gjitha paqartësitë e tij, duhet të marrë masa që të publikojë edhe specifikimet teknike në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP. Sqarimet dhe specifikime duhet tu bëhen me dije edhe ofertuesve të interesuar për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" SHPK qëndron

III.11.10.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.7,** të parashtruar në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni konstaton se objekti i pretendimit të ankimuesit lidhet me kërkesën për ndryshimin e specifikimit teknik përsa i përket arkitekturës së sistemit objekt prokurimi, duke lejuar operatorët ekonomik që të sistemi i ri që do të ofrojnë të jetë i ndërtuar në arkitekturën "On-premise" dhe jo vetëm në arkitekturën "Cloud" të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të dokumentave të tenderit, duke pretenduar se arkitektura e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përbeën kufizim të konkurëncës dhe është në kundërshtim me përcaktimet e neneit 36 të LPP-së.
Lidhur me këto pretendime të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1329/20 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik*

"DATA LOG" SHPK" ka argumentuar si në vijim: "*Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik mbi kufizimin e zgjidhjes vetëm në arkitekture Cloud, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky pretendim është i pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik. Në specifikimet teknike nuk është vendosur një kërkesë për favorizim të një teknologjie të caktuar, por është përcaktuar një arkitekture funksionale dhe operacionale, e cila është e domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës.*

Në mënyrë konkrete, sistemi kërkohet të:

- *Jetë i aksesueshëm përmes shfletuesve standarde, pa instalim në pajisjet e përdoruesve (zero footprint);*
- *Ofrojë menaxhim të centralizuar dhe përditësime në kohë reale për të gjithë përdoruesit;*
- *Garantojë disponueshmëri të lartë dhe shkallëzueshmëri dinamike;*
- *Funksionojë në mënyrê të unifikuar për të gjithë përdoruesit e institucionit.*

Këto kërkesa janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e sistemit financiar institucional dhe me nevojën për efikasitet operacional, siguri dhe administrim të centralizuar.

Për një sistem financiar institucional me përdorim të shpërndarë, arkitektura e centralizuar është kusht thelbësor për garantimin e integritetit të të dhënave, kontrollit operacional dhe menaxhimit të unifikuar të proceseve.

Zgjidhjet e tipit On-Premise nuk përmbushin në mënyrë të barasvlefshme këto kërkesa, pasi:

- *Kërkojnë instalim dhe mirëmbajtje lokale;*
- *Nuk garantojnë përditësime të menjëhershme dhe të unifikuara;*
- *Nuk sigurojnë në të njëjtin nivel shkallëzueshmëri dhe disponueshmëri;*
- *Rrisin kompleksitetin operacional dhe riskun teknik.*

Për rrjedhojë, kërkesa për arkitekture Cloud nuk përbën kufizim të konkurrencës, por një përcaktim teknik të domosdoshëm për përmbushjen e objektit të kontratës.

Në përputhje me nenin 36 dhe nenin 3 të ligjit nr. 162/2020, specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë proporcionale dhe në funksion të interesit publik, pa synuar favorizimin apo përjashtimin e operatoreve ekonomikë.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron dhe ankesa duhet të rrëzohet.", duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht përzgjedhjen e arkitekturës mbi të cilën do të ndërtohet sistemi i ri object prokurimi.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me arkitekturën e sistemit nuk qëndron, pasi nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se si ky përcaktim kufizon pjesmarrjen e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK nuk qëndron.

III.11.10.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën kërkesat nr. 8, nr. 9, nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 13, nr. 14, nr. 15 dhe nr. 16 të parashtruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe

me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni gjykon se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues janë paqartësi mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe hartimit të ofertës ekonomike. Autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1329/20 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "DATA LOG" SHPK*", ka dhënë sqarime për këto kërkesa të ankimuesit, por KPP gjykon se këto sqarime nuk janë shteruese, pasi autoriteti kontraktor nuk ka shpjeguar qartësisht dhe konkretisht, sepse përcaktuar numrin e përdoruesve për secilin modul të sistemit (*Moduli i Taksave, Moduli Financiar, Moduli i Shpenzimeve dhe Furnitorëve, Moduli i Buxhetit, Moduli i Aseteve*); nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike dhe funksionale të Modulit të Financës (General Ledger), duke përfshire minimalisht: "Listën e funksionaliteteve të detyrueshme (menaxhim plan kontabël, journal entries, rakordim bankar, mbyllje periudhe, raportim finanaciar ose ekuivalent), parametrat e përformances dhe disponueshmerise, si dhe kriteret e pranimit (UAT)"; nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike dhe funksionale të Modulit të Shpenzimeve dhe Furnitoreve (Payables), duke përfshirë minimalisht: "Listën e funksionaliteteve të detyrueshme (regjistrim fature, menaxhim furnitor, urdhërblerje, kalkulim TVSH, urdhrëpagese), mënyrën e integrimit me Modulin Financiar dhe sistemet e tjera, si dhe kriteret e pranimit."; nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike dhe funksionale të Modulit të Buxhetit (Budget), duke përfshirë minimalisht: "Listën e funksionaliteteve (hartim buxheti sipas klasifikimit ekonomik/organik, ndryshime buxhetore, monitorizim ekzekutimi, raportim realizimi), përputhshmërinë me legjislacionin e buxhetimit vendor, si dhe mënyrën e integrimit me modulin financiar"; nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike dhe funksionale të Modulit të të Ardhurave (Receivables), duke përfshirë minimalisht: listën e funksionaliteteve (gjenerim faturash tatimore, ndjekje detyrimesh, rakordim pagesash, integrimi me modulin e taksave dhe e-Albania), parametrat e performancës dhe kriteret e pranimit"; nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike dhe funksionale të Modulit të Aseteve (Fixed Assets), duke përfshire minimalisht: "Listën e funksionaliteteve (regjistrim/klasifikim, amortizim, inventar, transferta/skartim, raportim), përputhshmërinë me legjislacionin e kontabilitetit publik, si dhe kriteret e pranimit."; nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike dhe funksionale të Modulit të Raporteve Financiare (Financial Reports), duke përfshire minimalisht: "Listën e raporteve të detyrueshme ligjore, formatat e kërkuara, mundësinë e raporteve të personalizuara, eksporti në formate standard (Excel, PDF, XML), si dhe kërkesat e sigurisë se aksesit."; nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike për secilin integrim me Platformat Qeveritare (ESB/AKSHI, Sistemi Qendror i Tatimeve, QKB, bankat e nivelit të dytë), duke specifikuar minimalisht: protokollet teknike (REST/SOAP/ËbServices), formatet e të dhënave, frekuencën e sinkronizimit, SLA-në e integrimit, mënyrën e trajtimit të gabimeve dhe kërkesat e testimit të integrimit."; nuk ka përcaktuar kërkesat e detyrueshme teknike për integrimin me subjektet financiare përmes API të pageseës, duke specifikuar minimalisht: "Standardet API të kërkuara, formatin e mesazheve, mekanizmin e rakordimit automatik, frekuencën e importit të arketimeve, përpunimin e gabimeve, kërkesat e sigurisë së transaksioneve financiare dhe kërkesat ligjore që dalin nga marrëveshja tre palëshe.", në mënyrë që oferuesit të qartësohen lidhur me hartimin e ofertës teknike dhe ekonomike.

Për pasojë, KPP gjykon se autoriteti kontraktor përvecse të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese për të gjitha paqartësitë e tij, duhet të marrë masa që të publikojë edhe specifikimet teknike në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP. Sqarimet dhe specifikime duhet tu bëhen me dije edhe ofertuesve të interesuar për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK qëndrojnë.

III.11.10.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK, të parashtruara në kërkesën **nr.17,** të parashtruar në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6531, datë 13.04.2026 dhe me numër protokolli nr. 1134/2026 prot., datë 14.04.2026, Komisioni konstaton se objekti i pretendimit të ankimuesit lidhet me kërkesën për heqjen e komponenetit "Asisten Virtual Ai" të sistemit objekt prokurimi, duke pretenduar si në vijim: "***Specifikimet Teknike (Shtojca 6)*** *parashikojne ne piken 12 kerkesen per "Asistent Virtual" te bazuar ne Inteligjencen Artificiale (AI), me karakteristika te avancuara: nderveprim me ze ne kohe reale, mbeshtetje me email dhe ËhatsApp, pergjigje shumegjuheshe (shqip, greqisht, anglisht), njohje dhe perdeitesim automatik i legjislacionit (ligje, VKM, VKB, urdhera) dhe panel analitik per stafin.* ***Megjithate, AK nuk ka percaktuar asnje specifikim teknik, funksional apo parameter te matshem per kete komponent, dhe nuk ka percaktuar nese zgjidhja AI duhet te ndertohet dhe te operohet ne infrastrukture lokale te Bashkise (On-Premise) apo te ofrohet si sherbim i hostuar ne platforma te jashtme (AI-as-a-Service / Cloud API)****. Keto mangesi konstituojne shkelje te renda te legjislacionit te prokurimit publik, te detajuara me poshte.*

Shkelja e Nenit 36, pika 1 dhe 3/a te LPP nr. 162/2020 *– Mungesa e specifikimeve te qarta dhe parametrave te matshem. Neni 36, pika 1 kerkon qe "ne specifikimet teknike percaktohen qarte karakteristikat e sherbimit qe do te prokurohet". Neni 36, pika 3/a kerkon qe "parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin mundesi ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates".* ***Asistenti Virtual AI me nderveprim me ze, shumegjuhesh, integrim ËhatsApp/email dhe panel analitik eshte teknologjikisht kompleks dhe me kosto te ndryshme tehellesisht ne varesi te parametrave****:* ***pa specifikuar vellimin e thirrjeve*** *(nr. thirrjeve/dite), saktesine minimale te njohjes se zerit (%), kohen e pergjigjes (ms), disponueshmerine (uptime %), gjuhet konkrete dhe dialektet, volumet e email-eve, formatin e paneli analitik, si dhe nese AI ndertohet On-Premise ose ofrohet si sherbim Cloud, oferetuesit detyrohen te bejne supozime teresisht te ndryshme dhe oferta te pakrahasueshme financiarisht, duke bere te pamundur vleresimin e drejte te ofertave.*

Shkelja e Nenit 36, pika 4 te LPP nr. 162/2020 *– Munges a e alternatives "ose ekuivalente" dhe favorizim i teknologjive te caktuara. Neni 36, pika 4 ndalon percaktimin e specifikimet teknike ne menyre qe favorizojne ofertues te caktuar, dhe kerkon qe çdo reference ndaj nje teknologjie specifike te*

shoqerohet me frazen "ose ekuivalente". ***Kerkesa per "Agjent te avancuar AI" me nderveprim me ze ne kohe reale dhe integrim ËhatsApp imponon implicitly teknologji specifike LLM/NLP te nivelit tearte (Large Language Model, Speech-to-Text, Text-to-Speech) te disponueshme vetem tek ofrues te caktuar te zgjidhjeve AI, pa lenë hapesire per zgjidhje alternative funksionalisht ekuivalente (p.sh. sisteme rule-based + NLP, chatbot me floë te strukturuar etj.) dhe pa specifikuar nese teknologjia AI duhet te zbatohet On-Premise ose si sherbim i jashtem (API), çka perben favorizim de facto te operesuesve me liqenca te avancuara AI***.

Shkelja kritike e Nenit 36, pika 2 te LPP *– Mosspecifikimi i arkitektures se zbatimit (On-Premise kundrejt Cloud/API). Neni 36, pika 2 kerkon qe specifikimet teknike "duhet te mundesojne trajtim te barate per te gjithe kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur".* ***Zgjidhja AI mund te zbatohet ne menyre teresisht te ndryshme nga pikepamja teknike dhe financiare: (a) On-Premise – modeli AI instalohet ne serveret lokale te Bashkise, me kosto te larte fillestare por kosto te ulet operimi; (b) Cloud/API – perdoret API-ja e ofruesve te jashtem AI (p.sh. OpenAI, Google, Microsoft Azure AI), me kosto mujore/vjetore sipas volumit; (c) Zgjidhje hibride – kombinim i te dy modeleve. Kostot e ketyre tre skenareve ndryshojne me dhjetera here ne varesi te zgjedhjes. Pa percaktimin e kesaj arkitekture, ofertuesit do te ofrojne modele teresisht te ndryshme dhe te pakrahasueshme, duke bere te pamundur vleresimin teknik dhe financiar te ofertave ne baza te drejta. Kjo cenon drejtpersedrejti parimin e konkurrences se hapur dhe trajtimit te barate***.

Shkelja e Nenit 3, pika 1 te LPP *– Joproporcionalitet i komponentes AI ne raport me objektin kryesor te kontrates. Neni 3, pika 1 kerkon proporcionalitet ne kerkesat teknike me objektin e kontrates. Objekti i prokurimit eshte "Blerje sistem menaxhimi financiar" me CPV 48000000-8 (paketa softëare). Asistenti Virtual AI me nderveprim me ze ne kohe reale, pergjigje shumegjuheshe, integrim ËhatsApp dhe njohje automatike te legjislacionit ne kohe reale eshte funksionalisht i percaktuar si produkt i veçante teknologjik, i palidhur drejtpersedrejti me funksionalitetet e thelbit te sistemit te menaxhimit financiar (General Ledger, Payables, Budget, Receivables, Fixed Assets).* ***Perfshirja e kesaj komponente AI te avancuar ne kete procedure si detyre teknike minimale, pa justifikim te qarte te nevojes institucionale dhe pa vleresim kosto te veçante, perben kerkese joproporcionale me objektin dhe vleren e kontrates, ne shkelje te Nenit 3, pika 1.***

Shkelja e Nenit 2, shkronja b) te LPP *– Rrezik per mireperdorimin e fondeve publike.* ***Pa parametra te matshem (nr. thirrjeve/dite, SLA per kergjigje, saktesia minimale e njohjes se zerit, volumet e email-eve, gjuhet, kostoja e liqenzimit API te AI-t) dhe pa percaktimin e arkitektures se zbatimit (On-Premise kundrejt Cloud/API), eshte e pamundur te vleresohet kostoja reale e kesaj komponente. Kjo krijon rrezik te larte qe sistemi i ofruar te mos permbushe nevojat reale te institucionit ose qe kostoja e zgjidhjes AI te mos reflektohet ne oferte, duke rrezikuar mireperdorimin e fondeve publike ne shkelje te Nenit 2, shkronja b) te LPP***.

Shkelja e Nenit 41, pika 1 dhe Nenit 2, pika 2/c te VKM nr. 285/2021 – Mosargumentimi i kerkeses ne procesverbal. Neni 41, pika 1 kerkon qe AK te percaktoje qarte ne termat e references natyren, objektin, qellimin dhe specifikimet teknike te sherbimit.

Neni 2, pika 2/c *kerkon dokumentimin e argumentimit te specifikimeve teknike ne procesverbal. Procesverbali i AK nuk permban asnje argument teknik ose ekonomik per perfshirjen e Asistentit Virtual AI ne objektin e kontrates:* ***nuk justifikohet nevoja institucionale, nuk jepet asnje analize tregu, nuk percaktohet arkitektura e zbatimit, nuk vleresohet kosto e veçante dhe nuk ofrohet asnje vleresim i proporcionalitetit te kesaj komponente me objektin kryesor te prokurimit****.*

Komponenta e Asistentit Virtual AI (pika 12 e Specifikimeve Teknike):

- shkel Nenin 36, pikat 1 dhe 3/a te LPP – nuk percakton parametra te matshem teknike dhe funksionale;

- shkel Nenin 36, pika 4 te LPP – favorizon teknologji specifike AI pa ofru ar alternativen "ose ekuivalente";

- shkel Nenin 36, pika 2 te LPP – nuk percakton arkitekturen e zbatimit (On-Premise / Cloud / hibrid), duke e bere te pamundur krahasimin e ofertave dhe cenuar konkurrencen e hapur;

- shkel Nenin 3, pika 1 te LPP – kerkesa eshte joproporcionale me objektin kryesor te kontrates ("sistem menaxhimi financiar");

- shkel Nenin 2, shkronja b) te LPP – rrezikon mireperdorimin e fondeve publike per shkak te mungeses se kerkesave te matshme dhe te kostimit te veçante;

- shkel Nenin 41, pika 1 dhe Nenin 2, pika 2/c te VKM nr. 285/2021 – procesverbali i AK nuk permban asnje argumentim teknik ose ekonomik per perfshirjen e kesaj komponente.

Kerkese 17.1

Kerkohet qe KPP <u>te detyroje</u> AK qe, ne lidhje me piken 12 "<u>Asistent Virtual AI</u>" te Specifikimeve Teknike <u>te hege</u> komponentin "Asistent Virtual AI" nga objekti i kontrates, <u>duke e ndare ne nje procedure te veçante prokurimi me CPV te sakte dhe specifikime te plota, pasi keto jane kategori teresisht te ndryshme nga sistemi i menaxhimit financiar</u>.".

Lidhur me këto pretendime të ankimuesit autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1329/20 prot, datë 12.05.2026 "*Procesverbal për shqyrtimin e ankesës së paraqitur në KPP nga operatori ekonomik "DATA LOG" SHPK*" ka argumentuar si në vijim: "*<u>Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik mbi komponentin "Asistent Virtual me Inteligiencë Artificiale (AI)"; Autoriteti Kontraktor vlerëson se ankesa është e pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik.</u>*

<u>Pretendimi se specifikimet teknike nuk përmbajnë elementë të mjaftueshëm nuk qëndron.</u>

<u>Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit rezulton se komponenti Al është përshkruar qartë në aspektin funksional, duke përfshirë ndërveprimin me përdoruesit përmes zërit dhe kanaleve të komunikimit, mbështetjen shumëgjuhëshe, trajtimin e kërkesave që lidhen me detyrimet financiare, përditësimin me legjislacionin në fuqi, si dhe disponueshmërinë e një paneli analitik për monitorim. Këto elementë përmbushin kërkesat e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, i cili kërkon përcaktimin e karakteristikave funksionale të shërbimit dhe jo detyrimisht specifikimin e teknologjiëse apo algoritmit të përdorur.</u>

<u>Sa i përket pretendimit për mungesë parametrash të matshëm, theksohet se legjislacioni i prokurimit publik nuk kërkon detyrimisht përcaktimin e treguesve numerikë të detajuar për sisteme softëare dhe veçanërisht për komponentë të inteligiencës artificiale në këtë fazë të procedurës. Parametrat e tillë</u>

përbëjnë element të ofertës teknike dhe shërbejnë si faktor konkurrues ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke mundësuar zgjedhjen e zgjidhjes më të përshtatshme.
Në lidhje me mungesën e përcaktimit të arkitekturës së zbatimit (Cloud, On-Premise apo hibride), Autoriteti Kontraktor ka vepruar në përputhje me parimin e neutralitetit teknologjik.
Mospërcaktimi i një arkitekture të detyrueshme synon të shmangë kufizimin e konkurrencës dhe favorizimin e teknologjive të caktuara, në përputhje me nenin 36, pika 4 të ligjit nr. 162/2020.
Pretendimi për mungesë argumentimi nuk qëndron, pasi komponenti Al është i lidhur dreitpërdrejt me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, automatizimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit të administratës, duke qënë në përputhje me objektin e kontratës dhe parimin e mirëpërdorimit të fondeve publike.
Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi se komponenti Al është joproporcional me objektin e prokurimit. Ky komponent nuk përbën një sistem të veçuar, por një element funksional të integruar në sistemin e menaxhimit financiar, i cili mundëson komunikimin dhe ndërveprimin efektiv me përdoruesit e sistemit.
Kërkesa për heqjen e këtij komponenti dhe zhvillimin e një procedure të veçantë për të përbën ndërhyrje të pajustifikuar në diskrecionin e Autoritetit Kontraktor për përcaktimin e nevojave dhe strukturës së zgjidhjes teknologjike, pa u mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore.
Megjithate, me qëllim rritjen e qartësisë dhe transparencës së dokumenteve të tenderit, Autoriteti Kontraktor do teë reflektojë një saktësim të mëtejshëm në specifikimet teknike, duke peërcaktuar më qartë kërkesat minimale funksionale dhe operacionale për këtë komponent, pa ndryshuar natyrën dhe objektin e kontratës.
Në përfundim, konstatohet se specifikimet teknike për komponentin "Asistent Virtual Al" janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk kufizojnë konkurrencën dhe janë proporcionalisht të lidhura me objektin e kontratës. ***Për sa me sipër, kërkohet rrëzimi i plotë i Ankesës nr. 17 si e pabazuar***.", duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht përzgjedhjen e komponentit "*Asisten Virtual Ai*" të sistemit objekt prokurimi.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me komponenetin "*Asisten Virtual Ai*" të sistemit objekt prokurimnuk qëndron, pasi nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se si ky përcaktim kufizon pjesmarrjen e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*DATA LOG*" SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021"*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*Idealdevs Corporation* ShPK për procedurën e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*KREATX"* ShPK për procedurën e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë..

3. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*DATA LOG"* ShPK për procedurën e prokurimit "*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë..

4. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "*Idealdevs Corporation*" ShPK për procedurën e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

5. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "*Smart ICT Services*" ShPK për procedurën e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

6. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "*KREATX*" ShPK për procedurën e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

7. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "*DATA LOG*" ShPK për procedurën e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*" me numër reference Nr. *REF-80745-04-01-2026*, me objekt: "*Blerje sistem menaxhimi financiar*", me fond limit 25,000,000 (*njëzetë e pesë milion lekë*) pa TVSH , ose 260,960 EUR (*dyqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë*) Euro pa TVSH (*me kursin e datës 01.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro = 95.8 leke*), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 04.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

8. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

9. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

10. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "*Idealdevs Corporation*" ShPK.

11. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "*Smart ICT Services*" ShPK.

12. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "*KREATX*" ShPK.

13. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "*DATA LOG*" ShPK.

14. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

15. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.06.29
04:09:30

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2026/06/29 14:20:20 +02'00'
e6adaf71e99245a8a8ec1ef6f3b2d98e20260629142019
16020

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)